



*DASMA
NE
SHQIPERI*

ABAZ DOJAKA

358
066

ABAZ DOJAKA

DASMA NË SHQIPËRI



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

HYRJE

Martesa është një nga ngjarjet më të rëndësishme të jetës së njeriut; ajo është baza e krijimit të familjes. Martesa dhe familja, si institucione që lidhen ngushtë me jetën shoqërore, kanë karakter historik. Në procesin e zhvillimit të shoqërisë ato pësojnë ndryshime. Kalimi nga një formacion ekonomik-shoqëror në një tjetër ka sjellë ndryshime në marrëdhëniet martesore e familjare. Por, siç dihet, ndryshimet e jetës shoqërore nuk pasqyrohen menjëherë në familje dhe në martesë, prandaj shpeshherë ndeshen mbeturina që u takojnë periudhave të kaluara, madje edhe shoqërisë së lashtë.

Për t'u njohur me zakonet e popullit tonë, në këtë botim do të bëjmë fjalë për martesën në Shqipëri në periudhën nga gjysma e dytë e shek. XIX e deri në ditët e sotme.

Nga gjysma e dytë e shekullit XIX e deri në prag të Çlirimit, në Shqipëri ekzistonin lloje të ndryshme familjesh: fshatare, feudale, borgjeze, mikroborgjeze, punëtore. Ato mbartnin një varg mbeturinash patriarkale, me një pabarazi të theksuar midis pjesëtarëve të tyre, veçanërisht në mes burrit e gruas.

Familja fshatare zinte vendin e parë. Ajo ndikonte shumë edhe në llojet e tjera të familjeve.

Fshati shqiptar, deri në prag të Çlirimit, karakterizohej nga një kompleks i tërë kontradiktash ekonomike dhe shoqërore. Fondi kryesor i tokave ishte në duart e pronarëve çifligarë dhe të borgjezisë agrare. Masën kryesore të fshatarësisë e përbënin fshatarët e vegjël dhe ato të zonave malore. Pësia e prodhimit të tyre bujqësor, për shkak të tokave të pakta që zotëronin, ishte shumë e vogël.

Pjesa më e madhe e popullsisë së zonave malore të vendit tonë si banorët e Malësisë së Madhe, të Dukagjinit, të Malësisë së Gjakovës, të Pukës, të Dibrës, të Matit, të Malësisë së Krujës, të Malësisë së Tiranës, të Çermenikës, të Shpatit, të Mokrës, të Oparit, të Labërisë etj. kanë qenë në kushte më të prapambetura se popullsia e pjesës tjetër të Shqipërisë.

Banorët e këtyre krahinave malore mbetën pronarë të lirë. Atje, prona private mbi tokën, si mjete kryesor i prodhimit, ishte stabilizuar prej mjaft shekujsh. Ajo, me të gjithë tiparet e saj kryesore, siç janë shitja, blerja, ishte saksionuar në mënyrë të theksuar edhe në të drejtën zakonore.

Përpara Çlirimit në vendin tonë, sidomos në zonat e thella malore ekzistonin akoma mbeturina të marrëdhënieve patriarkale e fisnore, siç ishin për shembull kujtimi i fisit dhe kujria e fisit, trashëgimia, rendi dhe organizimi shoqëror etj. Gjithashtu, në disa zona të Veriut, si në Kelmend, u ruajt për një kohë të gjatë prona e përbashkët e fisit apo e vëllazërisë. Ekonomia e tyre blegtorale kërkonte shfrytëzimin e përbashkët të kullotave verore dhe dimërore. Për këtë arsye, ndarja e territorit të përgjithshëm të fisit, me ndonjë përjashtim të vogël, nuk ekzistonte. Por edhe në krahinat e tjera malore, ndonëse territori i fisit ishte ndarë midis pjesëve përbërëse të tij, (vëllazërive, barqeve dhe familjeve)

mbetën jashtë ndarjes toka, të cilat mund t'i shfrytëzonte i gjithë kolektivi. Të tilla ishin pylli, kullotat e maleve të larta në bjeshkë, tokat e degraduara etj.

Mbeturinat më të theksuara të marrëdhënieve patriarkale e fisnore shfaqeshin në vetë karakterin patriarkal të familjes, në normat e martesës.

Një vend të rëndësishëm në popullsinë e fshatit zinin fshatarët e vegjël. Edhe pse pronarë të tokave që punonin, ata ishin aq të varfër sa që nuk mund të siguronin jetesën pa shitur pjesërisht fuqinë e tyre të punës brenda ose jashtë vendit. Nga radhët e tyre doli pjesa më e madhe e kurbetlinjve, të cilët, duke qëndruar për një kohë të gjatë në kurbet dhe duke rënë në kontakt me qytetërimin e vendeve të huaja, si dhe me idetë demokratike të përhapura atje, ndikuan në shpejtimin e zhvillimit ideologjik dhe politik të familjeve dhe të bashkëfshatarëve të tyre. Ata, gjithashtu, u bënë një faktor i vazhdueshëm ndërlidhjeje midis qytetit dhe fshatit. Kjo bie më tepër në sy në krahinat e Shqipërisë Jugore dhe Juglindore.

Në vendin tonë ekzistonte edhe familja fshatare e bujqve çifçi.

Pronësia çifligare nuk ishte e shtrirë njësoj në të gjitha krahinat e vendit. Ishte më e theksuar sidomos në viset e ulëta: Lushnjë, Fier, Kavajë, Vlorë, Mallakastër, Delvinë etj. dhe në luginat e brendshme: Korçë, Kolonjë, Lugina e Shkumbinit, Lugina e Osunit, Kosovë etj., ku ndodhej pjesa më e madhe e tokave të punueshme.

Por shtrirja e madhe e pronësisë çifligare, që vihet re në gjysmën e dytë të shekullit XIX deri në Shpalljen e Pavarësisë, me zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste në fshat dhe nën ndikimin e ekonomisë monetare, në vitet '20 dhe '30, vjen duke u pakësuar. Si pasojë e pakësimit të pronës çifligare u zvogëlua edhe numri i familjeve të çifçinjve. Në prag të Çlirimit të vendit ato zinin 18,6% të numrit të përgjithshëm të fshatarësisë.

Familja fshatare, që i përgjigjej kësaj strukture shoqërore, pavarësisht nga ndryshimet që viheshin re në kategoritë e ndryshme të fshatarëve, paraqiste një varg mbeturinash patriarkale.

Në përgjithësi, në çdo familje të fshatit tonë i zoti i shtëpisë gëzonte një pushtet të pakufizuar, jo vetëm mbi pasurinë e shtëpisë, por edhe mbi pjesëtarët e familjes. Ai kishte të drejtë të shiste e të blinte, të shkëmbente e të falte, të mbante qesen e familjes. Gjithashtu, pushteti i tij në familje shtrihej në çdo aspekt të jetës së saj.

I tërë ky pushtet i të zotit të shtëpisë buronte nga pronësia mbi gjithë pasurinë e familjes. Pozita e pronarit absolut shprehej edhe me termin «zot i shtëpisë», ndërsa nënshtrimi i pjesëtarëve shprehej në termin «robt e shtëpisë».

Të gjitha përpjekjet e të zotit të shtëpisë synonin forcimin e pozitës ekonomike dhe shoqërore të shtëpisë së tij, shtimin e pasurisë dhe sigurimin e sa më shumë kraheve të punës. Krahët e punës ruheshin duke mos lejuar ndarjen e familjes dhe shtoheshin me anë të martesave. Kur kishte raste që ndonjë grua nuk lindte fëmijë apo lindte vetëm vajza, atëhere, me ndërhyrjen e të zotit të shtëpisë, merrej një grua e dytë dhe nganjëherë dhe e tretë.

Në kuadrin e kësaj familjeje anëtarët e saj zinin një pozitë nënshtruese. Por pozitën më të ulët e zinte gruaja.

Gratë nuk kishin asnjë të drejtë. Ato ishin të shtypura dhe të shfrytëzuara. Rol të madh reaktionar ka luajtur edhe feja, e cila ka mbështetur pa rezerva dhe ka thelluar pabarazinë shoqërore, juridike dhe politike të gruas.

Para Çlirimit masat e gjera të grave, në mënyrë të veçantë ato të fshatit, ishin plotësisht nën ndikimin e fesë, të priftit e të hoxhës, të cilët brez pas brezi i kishin

tmerruar me frikën e zotit, me idenë e mëkatit, i kishin kthyer në skllave të bindura e të përunjura në familje e në shoqëri.

Padyshim, shkaqet më të thella të sundimit të burrit ndaj gruas nuk janë faktorët biologjikë ose psiqikë, siç pretendojnë teoritë e ndryshme borgjeze, por faktorët shoqërorë e ekonomikë. «Pabarazia e të drejtave midis tyre, (burrit e gruas A. D.), — thotë Engelsi, — që e kemi trashëguar nga marrëdhëniet shoqërore të mëparshme... nuk është shkaku, por rezultati i skllavërimit ekonomik të gruas. Familja e veçantë e sotme është bazuar në skllavërinë shtëpiake të gruas, të hapët ose të maskuar, dhe shoqëria e sotme është një masë e përbërë fund e krye nga familje të veçanta, që janë molekulat e saj. Burri sot në shumicën e rasteve duhet të fitojë, të ushqejë familjen... Ai në familje është borgjezi, gruaja përfaqëson proletariatin».¹

Edhe familja fshatare shqiptare ishte në të njëjtat pozita. Burri, i zoti i shtëpisë kishte një pozitë sunduese mbi ekonominë e familjes. Ai gëzonte të drejtën e trashëgimit të fëmijëve dhe të pronës, kurse gruaja që nuk kishte një bazë të tillë ekonomike, ishte e detyruar t'i nënshtrohej atij. Ky nënshttrim në disa zona arriti deri në atë shkallë, sa edhe gruaja vetë të kthehej në formë malli dhe të bëhej pronë private e burrit.

Megjithatë roli i gruas shqiptare nuk ka qenë i vogël në jetën e familjes, në forcimin e saj, në ruajtjen e traditave dhe të virtyeteve të popullit tonë. Kështu, në disa krahina gratë punonin krahas burrave në punët e bujqësisë e të blegtorisë dhe në sektorë të tjerë. Po kështu, kontributi i saj në përparimin shoqëror, pasqyrohet në krijimtarinë popullore. Në shumë këngë folklorike fli-

¹ F. Engels — Origjina e families, e pronës private dhe e shtetit. Tiranë, 1970, f. 104-105.

tet me respekt për gruan në punë e në familje, për marrëdhëniet e saj me burrin për detyrat e përbashkëta, vazhdimësinë familjare, besnikërinë bashkëshortore.

Në kushtet e strukturës shoqërore-ekonomike të viteve fshatare të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve martesore e familjare, ishin krijuar zakone e norma që, në përgjithësi, përcaktoheshin nga marrëdhëniet patriarkale feudale dhe borgjeze, që sundonin në atë kohë në fshatin shqiptar. Ato shprehnin botëkuptimin mbi familjen dhe mbi pozitën e nënshtruar të gruas, e cila duhet t'i nënshtrohej plotësisht burrit. Por, duhet thënë se në kategoritë e ndryshme të popullsisë fshatare, madje edhe brenda kategorive të veçanta, viheshin re ndryshime.

Në Shqipëri, në gjysmën e dytë të shekullit XIX deri në prag të Çlirimit, klasën sunduese të vendit e bënë shtresat e pasura: bejlerët, çifligarët dhe borgjezia tregtare. Këto klasa ishin të interesuara që të forconin pozitën e tyre me rrugë të ndryshme, një nga të cilat ka qenë edhe lidhja e krushqive. Në zonat fshatare klasa feudale i lidhte martesat duke zgjedhur «oxhakun e madh», duke ndjekur krushqitë tradicionale, në themel të të cilave ishte ruajtja dhe shtimi i pasurisë.

Në disa qytete të vendit, sidomos në Korçë, në Shkodër, në Elbasan, në Gjirokastrë etj., martesat ishin karakter të theksuar klasor. Shtresat borgjeze të këtyre qyteteve, duke u nisur nga interesa pasurore, përpiqeshin t'i gjenin djalin apo vajzën një bashkëshort të përshtatshëm me pajë dhe prikë të majme, pavarësisht nga mosha, kultura, pamja apo sjellja e tyre. Në martesat të tilla me llogari, nuk mund të kishte dashuri bashkëshortore. Të rinjtë, duke qenë nën peshën e autoritetit të prindërve, nuk pyeteshin fare dhe martesat ishin direkt një marrëveshje që bënin prindërit në mes tyre.

Edhe në familjet mikroborgjeze të qytetit të përfaqësuara nga masat zejtare dhe të tregtarëve të vegjël, mar-

tesa varej nga dëshira e prindërve, duke u marrë nga njëherë edhe pëlqimi i të rinjve.

Në vendin tonë, veçanërisht në çerekun e dytë të shek. XX deri në prag të Çlirimit, shfaqet edhe një familje e re, familja punëtoare, e cila, megjithëse në embrion, filloi të luajë një rol të rëndësishëm në krijimin dhe në forcimin e familjes me tipare të reja. Punëtorët, duke qenë të zhveshur nga çdo lloj prone, nuk kishin ndonjë pushtet të privilegjuar në familje. Pozita e gruas dhe e fëmijëve ishte në baza më të drejta, megjithëse duhet thënë se edhe këtu, për shkak të forcës së zakonit, ekzistonte njëfarë brutaliteti në sjelljen e burrave ndaj grave.

Edhe martesat nuk kishte ato tipare të martesave të klasave dhe të shtresave të tjera të popullsisë. Në përgjithësi, martesat nuk lidhej sipas interesit ekonomik, por në bazë të saj viheshin interesat klasore, lidhjet midis familjeve punëtoare me interesa të përbashkëta. Nuk mungonin, këto shumë të rralla, edhe martesat me dashuri. Sigurisht këto familje të reja, që thyen traditat e martesave të vjetra, ndesheshin në pengesa të mëdha të ndikuara nga pikëpamjet regresive të kohës, nga feja dhe nga institucionet fetare, nga opinioni i keq shoqëror dhe nga vetë qeveritë antipopullore që tërthorazi mbysnin që në lindje çdo gjë të re dhe përparimtare.

*

*

*

Pas Çlirimit dhe vendosjes së pushtetit popullor, vendit dhe popullit tonë iu hap një etapë e re në zhvillimin ekonomik e shoqëror. Që në vitet e para Partia mori masat të shpejta me karakter demokratik dhe socialist, si në qytet ashtu dhe në fshat, që çuan në ndryshime të strukturës social-klasore të popullit tonë.

Struktura social-klasore e fshatarësisë ndryshoi pas kooperimit të plotë të bujqësisë, që ishte një nga fitoret më të rëndësishme historike të revolucionit socialist në frontin ekonomik-shoqëror, që çoi në krijimin e marrëdhënieve të reja socialiste në fshat, duke i hapur rrugën zhvillimit të shpejtë të forcave prodhuese dhe ndryshimeve rrënjësore në jetën shoqërore kulturore të fshatit. Tani shumicën e fshatarësisë sonë e përbënte fshatarësia kooperativiste.

Përveç fshatarësisë kooperativiste, gjatë periudhës së transformimit socialist të fshatit, u rrit dhe numri i punëtorëve të sektorit shtetëror të bujqësisë, të cilët me punën e tyre u bënë shembull në edukimin dhe në përparimin e fshatit tonë socialist.

Theksojmë se numri i punëtorëve me banim në fshat është rritur. Kjo ka bërë që pesha specifike e punëtorëve me banim në fshat të vijë duke u rritur.

Kjo shpërndarje e punëtorëve ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e përbërjes social-klasore të familjes në fshat.

Në fshat, një vend jo të vogël luan edhe shtresa e inteligjencies, e cila nga viti në vit ka ardhur duke u rritur.

Ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit, shënoi kalimin në etapën e re, në atë të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Gjatë kësaj periudhe (1960-1970) numri i punëtorëve u rrit afërsisht dy herë më shumë nga sa ishte në vitin 1960.

Edhe pse në vendin tonë pjesa më e madhe e popullsisë banon në territorin e fshatit, vendi ynë ecën me vendosmëri në rrugën e shndërrimit nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrialo-bujqësor. Për këtë dëshmojnë jo vetëm shtimi i shpejtë i prodhimit industrial dhe pesha specifike që zë prodhimi industrial ndaj atij bujqësor, por edhe prirjet e zhvillimit e të rritjes të numrit të punëtorëve industrialë e të degëve të tjera, të

cilët shtohen si në qytet ashtu edhe në fshat. Kjo bën që pesha specifike e tyre në strukturën socialklasore të shoqërisë sonë të rritet. Kështu në dhjetë vjetët e fundit (1969-1979), pesha specifike e klasës punëtore në strukturën e shoqërisë u rrit 7 për qind (nga 35 për qind që zinte në vitin 1969 në 42 për qind në vitin 1979), duke përmirësuar më tej strukturën e shoqërisë në favor të klasës punëtore.

Klasa punëtore, si klasë relativisht e re, përbërjen e saj shoqërore e ka heterogjene. Në analizën shkencore marksiste-leniniste që i ka bërë këtij problemi, shoku Enver Hoxha thekson: «Një pjesë e vogël e klasës sonë punëtore është me origjinë punëtore ose zanatçi i vogël, që ka njohur shtypjen e borgjezisë dhe të shfrytëzuesve. Pjesa tjetër dërrmuese e saj është me origjinë fshatare dhe qytetare e varfër, që edhe kjo ka njohur shtypjen dhe shfrytëzimin kapitalisto-çifligar... Ky formacion i klasës në zhvillim, ka sjellë me vete në gjirin e saj edhe shumë mbeturina e pikëpamje mikroborgjeze, të cilat e dëmtojnë në atë kohezion, atë ndërgjegje dhe disiplinë të klasës që ne duam të krijojmë».¹

Është fakt se një pjesë e klasës punëtore, sidomos ajo që vjen nga shtresat mikroborgjeze të fshatit e të qytetit, ruan ose mbart e kultivon në mënyrë të pavetëdijshme koncepte që janë të huaja për ideologjinë tonë socialiste. Këto shfaqje negative vihen re sidomos në marrëdhëniet martesore e familjare.

Prandaj u duhet bërë një luftë e madhe të gjitha mbeturinave dhe «njollave» të shoqërisë së vjetër.

Lëvizjet që shpërthyen në të gjithë vendin pas Kongresit V të PPSH dhe pas thirrjes që bëri shoku Enver Hoxha më 6 shkurt 1967 për mbrojtjen e të drejtave të grave e të vajzave, synonin jo vetëm zhdukjen e mbeturinave fetare dhe të zakoneve prapanike por edhe kri-

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime (1967-1968), f. 399.

jimin e lidhjeve të reja martesore, forcimin e mëtejshëm të familjes socialiste.

Ndryshimet që kanë ndodhur gjatë viteve të pushtetit popullor në marrëdhëniet familjare e martesore janë ndryshime të mëdha cilësore që nuk kanë të krahastuar me të kaluarën, por duhet pranuar se procesi i shndërrimit socialist të martesës e familjes është ende në një fazë tranzitore që nga dita në ditë vjen duke u forcuar gjithnjë e më shumë.

MBETURINA TË FORMAVE TË VJETRA TË MARTESËS

Martesa dhe familja, në shkallët e ndryshme të zhvillimit ekonomik e shoqëror të njerëzimit, kanë marrë forma të ndryshme. Duke iu drejtuar historisë së zhvillimit të martesës, ajo, sipas Engelsit, ka kaluar në tri forma të ndryshme, që u përgjigjen tri shkallëve të zhvillimit të shoqërisë: periudhës së egërsisë — martesa me grupe; periudhës së barbarisë — martesa me çifte dhe periudhës së qytetërimit — martesa monogame. (martesa e një burri vetëm me një grua).

Dy format e para, martesa me grupe dhe martesa me çifte, janë tashmë, forma të kapërcyera prej kohësh, gati nga të gjithë popujt. Megjithatë, mbeturina që të kujtojnë këto lloje martesash ndeshen në shumë popuj. Edhe në zakonet e martesës së popullit tonë, për gjysmën e dytë të shekullit XIX deri në Çlirim, janë shfaqur mbeturina të tilla, të cilat kanë qenë të kufizuara në disa krahina dhe zona të veçanta.

Ruajtja e normave të ekzogamisë

Ekzogamia, si një nga tiparet thelbësore të organizimit të fisit, ka qenë një normë universale, një zakon i pamohueshëm për të gjithë popujt. Sipas F. Engelsit,

ekzogamia lindi së bashku me lindjen e rendit gjinor. Dhe, siç dihet, gjinia në fillim u shfaq si gjini e nënës dhe së bashku me të lindi dhe ajo fazë e zhvillimit të shoqërisë gjinore, matriarkati.

Në gjininë matriarkale afria shkonte sipas vijës amtare, pra edhe martesë e burrave brenda gjinisë ishte absolutisht e ndaluar. Megjithatë, mund të kishte vend për martesë me të afërm nga ana e babait.

Me zëvendësimin e matriarkatit nga patriarkati ndryshoi edhe afria, e cila tani llogaritej jo sipas vijës amtare, por sipas atësisë. Tani ekzogamia u bë patriarkale, pra martesë brenda fisit të babait ishte e ndaluar. Në anë tjetër, bëheshin martesë me kushërinj nga ana e nënës.

Por, më vonë, me shkatërrimin e rendit të komunitetit primitiv u bënë ndryshime në familje dhe në martesë. Bashkë me lindjen e pronës private dhe ndarjen e shoqërisë në klasa antagonistë, ndryshoi edhe karakteri i lidhjeve martesore. Ekzogamia nisi të prishet, sidomos në shtresat e pasura. Sipas Engelsit, të pasurit, duke mos dashur që pasuria e një trashëgimtareje, me martesën e saj, t'i kalonte të shoqit (pra një fisi tjetër), e bënë të ligjshme që një vajzë të merrte burrë brenda gjinisë së vet për të ruajtur pasurinë e vet në dobi të gjinisë.

Megjithatë, për shkak të traditës, në përgjithësi, parimi i ekzogamisë shfaqej akoma dhe në fisin atëror. Në disa popuj normat e ekzogamisë u ruajtën deri vonë.

Kur flitet për ekzogaminë, kuptohet ekzogamia e fisit apo e grupit fisnor. Por, në gjysmën e dytë të shekullit XIX deri në prag të Çlirimit, në përdorimin e termi fis, nuk do të kuptohet organizimi shoqëror në bazë fisesh (që i përket shoqërisë së lashtë dhe që ka qenë kapërcyer me kohë nga populli ynë), por do të merret kuptimi popullor i tij. Këtu do të përdoret edhe termi gjini.

Fisi në gjuhën shqipe ka kuptimin e një grupi të afërmish në vijën mashkullore. Në Shqipërinë e Veriut dhe në Labëri me këtë fjalë kuptohet një grup i madh njerëzish që rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe që ndjekin një ekzogami të rreptë në mes tyre. Kurse në viset e tjera

të Shqipërisë ky grup është më i vogël, nuk i kalon të dhjetë brezat.

Gjinia është shtëpia e fisi i gruas së martuar. Gjinia përfshin gruan, prindërit e saj dhe të parët e tyre sa të mbahen mend.

Fisi, vëllazëria dhe familja dallohen nga dy parime bazë: parimi ekonomik apo prodhues dhe parimi ideologjik. Parimi ekonomik dallohet nga zotërimi i përbashkët i mjeteve kryesore të prodhimit, mënyra e nxjerrjes së ushqimit dhe e të mirave të tjera materiale. Me parim ideologjik kuptohen marrëdhëniet e njerëzve me njëri-tjetrin, ku hyjnë ekzogamia, gjakmarrja, ndihma reciproke. Në përgjithësi, bashkimi i fiseve shqiptare ka pasur më tepër karakter ideologjik, pasi në këtë kohë, me përhapjen e pronës private, funksioni ekonomik ishte prishur. Të gjitha familjet fshatare, në pjesën më të madhe, zotëronin ekonomi të vogla individuale.

Ruajtja e normave të ekzogamisë në popullin tonë ka qenë më e theksuar në zonat malore të vendit, në ato zona ku zhvillimi ekonomik e shoqëror kishte mbetur më prapa dhe ruhej në një shkallë të konsiderueshme ekonomia natyrore, që favorizonte mënyrën e vjetër të jetesës.

Përkundrazi, shumica e banorëve të qyteteve dhe të zonave përreth tyre, si edhe banorët e fshatrave fushore e kodrinore e kishin kapërcyer me kohë këtë normë.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shek. XX në pjesën më të madhe fiset shqiptare të Veriut, të Verilindjes dhe një pjesë e fiseve të Jugut kanë qenë ekzogame. Një provë e padyshimtë, që tregon se sa e gjallë dhe e fortë ka qenë martesja jashtë fiseve në Shqipërinë e Veriut në shekullin XIX, është se lidhja e fisit dhe zakonet e martesës kanë qenë më të forta se feja, së cilës i përkisnin anëtarët e fisit. Kaq e rreptë ka qenë ekzogamia në këto fise saqë, kur konstatoheshin martesja brenda fisit, «fajtorët» ndiqeshin dhe në pjesën më të madhe edhe vriteshin. Prandaj, për të mos «përlyer» fisin, çdo anëtar i tij duhej të dinte patjetër përmendsh sojin e vet. Brezave pasardhës nga një stërgjysh i përbashkët, u ndalohej martesja me njëri-tjetrin.

Ekzogamia zbatohet më rreptë në Shqipërinë e Veriut dhe të Verilindjes, në Malësinë e Shkodrës, ku përveç Shkrelit, Hotit, Kastratit, Koplikut, Rranzave, përfshihej edhe Gruda, Triepshi e Kuçi; në Malësinë e Gjakovës, duke përfshirë Nikajin, Merturin, Krasniqen, Gashin, Bytycin etj.; në Malësinë e Pejës, duke përfshirë Plavën, Gucinë, Rugovën etj.; në Malësinë e Lezhës, në tre bajrakët e Ohrit Selitë, Kthellë, Pishkash; në Mirditë (Orosh, Spaç, Kushnen); në Malin e Zi, (Pukë), Iballë, Kalimash e Lumë si dhe në gjithë Rrafshin e Dukagjinit në Kosovë.

Në krahinat që përmendëm vepronte Kanuni i Lekë Dukagjinit, norma të veçanta të të cilit ndalonin martesat në gjak e në gjini.

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, për lidhje martesë konsiderohej pengesë në qoftë se familja e djalit dhe e vajzës ishin gjak e gjini.¹ Brezi i gjakut rrjedh prej vijës së babait dhe quhet «lisi i gjakut», ndërsa brezi i gjinisë rrjedh prej vijës së nënës dhe quhet «lisi tamblit». Dhëndri dhe nusja, po t'i përkisnin të njëjtit fis, edhe në «katërqind breza të jenë nuk mund të lidhin krushqi». Ky rregull ishte më i theksuar për «lisin e gjakut», njerëzit e të cilit quheshin vëlla e fis. Vëlla e fis konsideroheshin të gjithë ata persona, të parët e të cilëve herët a vonë ishin ndarë nga e njëjta vater, kështu që brezi i gjakut shkonte në pambarim. Kaq e theksuar ka qenë ekzogamia në këto krahina, saqë edhe banorë fisesh të ndryshme që vetëm ruanin kujtimin e një të pari të përbashkët, nuk lidhnin martesë në mes tyre. Kështu, p.sh., të tre bajrakët e Mirditës (Orosh, Spaç, Kushnen), që pretendonin të ishin të një fisi me Shalën dhe Shoshin, jo vetëm që nuk martoheshin midis tyre, por as edhe me këto dy fise. Madje më parë, edhe me Merturin dhe Berishën nuk lidhnin krushqi, pse edhe këto, gjoja, janë me një baba të përbashkët, Murr Dedin. Këto fise bënë krushqi me fise të tjera. Shala e Shoshi jepnin e merrnin kryesisht me Nikajin, me

¹ Shtjefën Gjeçovi. Kanuni i Lekë Dukagjinit (KLD). Shkodër, 1933, f. 12.

Bogën, me Hotin, me Kastratin. Kastrati bënte krushqi me Hotin. Tre bajraktarët e Mirditës lidheshin me Kthellën, me Dibrin, me Fanin.

Edhe në zonat e tjera, ku vepronte Kanuni i Lekë Dukagjinit, martesë brenda fisit ndalohej rreptësisht. Në Lumë, përpara se të «zihej nusja», shihej nëse ajo ishte fis, qoftë edhe shumë i largët me familjen ose me ndonjë prej fisit të djalit. Po të vërtetohej kjo, nusja nuk «zihej». Edhe në Kosovë, ndjenja e përkatësisë së një fisi pengonte lidhjen e martesës. Kuptohet se me kohë këto pengesa të rrepta u zbutën në fiset e Rrafshit, madje edhe në malësitë, por përkatësia ndaj së njëjtës vëllazëri ruhet edhe sot si pengesë për lidhjet martesore.

Dukuria e ekzogamisë është pasqyruar edhe në folklorin tonë. Kjo është më e theksuar sidomos në ciklin e kreshnikëve, që përfaqëson shoqërinë patriarkale të Shqipërisë së Veriut. Kështu, p.sh., Halili, vëllai i vogël i Mujit kreshnik është kundër martesës së tij në krahinën e Jutbinës:

*Kah kam vlla e kah kam motër,
deksha para n'u martofsha!
Se gjithë gratë e krahinës ku janë,
se gjithë vashat e Jutbinës ku janë,
bash si motra qi po m'duken¹.*

Nga çereku i parë i shekullit XX, megjithëse ekzogamia vepronte në disa zona, rigoroziteti i saj ishte zbutur në mënyrë të ndjeshme. Kjo vihet re më shumë në qytete ku shtresat e pasura, bejlerë e agallarë, për të mos u dalë pasuria jashtë fisit, martoheshin brenda rrethit të tyre të ngushtë, madje edhe brenda fafesisit me kushërinj jo të largët. Por, edhe në disa zona të tjera, ku vepronte e drejta zakonore, nisën të bëheshin martesë brenda fisit,

¹ Folklori shqiptar II, Epika legjendare (EL), Tiranë, 1966, v. 73,



87701

39418

por kur i kalonte të shtatë brezat. Bile edhe në Dukagjin, në këtë trevë me tradita të forta fisnore, në vitet '30 u bë e mundur martesë ndërmjet banorëve të Thethit dhe të Shalës. Megjithatë kishte edhe krahinë që nuk mund ta thyenin konceptin e ekzogamisë. Nga një bisedë me disa pleq të Mirditës mësuam se një herë ishin mbledhur në kuvend tre bajrakët (Oroshi, Spaçi e Kushneni) për të parë mundësinë e martesës në mes tyre, pasi ishin larguar mjaft nga njëri-tjetri. Kur sapo ata ishin shtruar në bisedë, kaloi aty pranë një grua nga Spaçi. Ajo ngadalësoi hapin dhe duke buzëqeshur i përshëndeti: «Kuvend i mbarrë, vllazën!»! Menjëherë burrat e kuvendit u çuan në këmbë dhe i dhanë fund bisedës duke thënë: «Ajo na quejti vllazën. Si mund të marrim na motrat për gra?».

Dhe kështu, ekzogamia vazhdoi deri vonë në këtë krahinë.

Në krahinat e Shqipërisë së Mesme që përfshihen midis lumit të Matit dhe të Shkumbinit, d.m.th. në krahinën e Kurbinit, (në malësitë e Krujës e të Tiranës), në krahinën e Matit, të Dibrës, të Martaneshit, të Çermenikës etj. ekzogamia nuk vepronte njësoj. Në këto krahinë vepronte Kanuni i Skënderbeut.

Por duhet thënë se normat e Kanunit të Skënderbeut nuk qëndruan aq gjatë sa ato të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Duke pësuar një evolucion më të madh që i shpinte drejt shfuqizimit, shumë norma të Kanunit të Skënderbeut humbën, sepse ishin në kundërshtim me marrëdhëniet e reja në prodhim. Përveç kësaj, marrëdhëniet feudale në ish-principatën e Skënderbeut u zhvilluan më hovshëm se sa atje ku vepronte Kanuni i Lekë Dukagjinit. Gjithashtu, në krahinat ku vepronte Kanuni i Skënderbeut pjesa më e madhe e popullsisë u islamizua dhe kanuni pësoi njëfarë ndikimi nga e drejta islame.

Sipas Kanunit të Skënderbeut nuk lejohej lidhja e martesës midis dy të rinjve, familjet e të cilëve ishin në gjak e gjini. Kanuni i Bendës (siç u quajt në disa krahinë Kanuni i Skënderbeut), ndalonte krushqitë midis dy familjeve që kishin farefisni në mes tyre deri në 100 breza nga ana e babait, si edhe në shtatë breza nga ana e nënës.

Edhe në disa krahina të Matit ekzogamia ishte ruajtur deri në prag të Çlirimit. Nuk bëhej martesë brenda fisit sado larg që të ishin brezat. Më vonë ky rregull u thye: martesat filluan të bëhen brenda grupeve të fshatrave, mjaft që të rinjtë të ishin shtatë breza larg njëri-tjetrit.

Në Shqipërinë e Jugut dhe në Shqipërinë Juglindore ekzogamia paraqitej ndryshe. Më të forta normat e saj shfaqeshin në Labëri dhe në krahinat e saj (Kurvelesh, Mesaplik, Bregdet, Dukat, Lopës, Rrëzomë, Rrëza e Delvinës, Tepelenë dhe Kardhiq). Në këto zona vepronte Kanuni i Labërisë, që në popull njihej me emrin e Papa Zhulit. (Në gjysmën e parë të shekullit XIX, në disa zona si Kardhiq, Rrëzoma, Kurveleshi i Sipërm, Kanuni i Labërisë u quajt Shartet e Idriz Sulit. Në Labëri, deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX, ekzogamia, me ndonjë përjashtim, ruhej e fortë. «Dëshmia më e mirë për forcën e lidhjeve të fisit në shekullin e kaluar në Labëri, ka qenë ndalimi i martesave në mes të anëtarëve të tij. Ky parim ishte i sanksionuar prej zakonit dhe kush guxonte ta prekte fyente rëndë fisin dhe urrehej nga të gjithë».¹

Duke filluar nga shekulli XX u vunë si kufi 6 breza, si nga babai, ashtu edhe nga nëna. Popullsia e Labërisë thotë: «Fejesa brenda «çete» (fisi -A. D.) ishte turp i madh. Brenda «çete» jemi motër e vëlla».

Në krahinat e tjera të Jugut ekzogamia nuk zbatohej me kaq rreptësi. Megjithatë, në disa zona të izoluar, larg qendrave të mëdha dhe qyteteve, martesat brenda fisit nuk lejohej. Por këtu, duhet vënë në dukje se koncepti për fisin është mjaft i kufizuar. Sipas tyre fis apo gjak janë të gjithë ata persona që rrjedhin nga një baba i përbashkët, por nuk janë në gjendje të numërojnë më shumë se 6-7 breza. Për ta, këta 6-7 breza quhen fis. Prandaj edhe pohimi se nuk lejohej martesat brenda fisit i referohet këtij kuptimi të ngushtë që kanë ata për fisin. Kështu, p.sh., mund të përmendim krahinën e Myzeqesë, të

1 G. Hahn. Albanesische Studien, Jena, 1854, f. 354.

Skraparit, të Mokrës, të Bregdetit, të Çamërisë, të Devollit etj.

Në popullin tonë, përveç fisit të një gjaku, njihej edhe fisi fiktiv kolektiv, i cili lindte gjatë adoptimit apo mbështetjes së një fisi të vogël te një fis më i madh. Kjo ka ndodhur sidomos pas pushtimeve osmane, kur te ne u bënë shumë lëvizje fisesh. Në këtë rast, vendosja e një fisi në një territor të caktuar, nuk përjashtonte mundësinë që në vendin e ri të gjente banorë vendas që i përkisnin një fisi tjetër. Në fillim të dy fiset bashkëjetonin me njëri-tjetrin si dy fise të ndryshme dhe martesat në mes tyre lejohej. Në shumicën e rasteve, kur një fis ishte më i vogël se tjetri, për t'u bërë ballë pushtuesve dhe presionit të fiseve të tjera, adoptohej nga fisi më i fuqishëm duke u bërë «vëlla» me të dhe njihte kështu si të parë të tij plakun e atij fisi.

Përveç fisit fiktiv kolektiv, dallohet edhe fisi fiktiv individual, që përftohet nga vëllazëria dhe kumbaritë e ndryshme. Këto lidhje sollën me vete ekzogaminë e familjeve dhe të vëllazërive të atyre personave, të cilët përfundonin midis tyre bërjen vëllamë ose hynin në marrëdhënie kumbarie.

Por edhe kjo lloj ndalese nuk ka pasur të njëjtën shtrirje tek të gjithë shqiptarët. Më e theksuar ka qenë te popullsia e zonave malore në ato vise ku vepronte e drejta zakonore.

Sipas kanunit të Lekë Dukagjinit vëllamëria që bëhet duke pirë gjak e ndalon krushqinë ndërmjet të vëllazëruarve, «shpisë së tyre e zjarmit të tyre»¹. D.m.th, në mes dy familjeve dhe vëllazërisë së tyre nuk mund të lidhej krushqi.

1 Kanuni i Lekë Dukagjinit — faqe 12.

Edhe sipas Kanunit të Skënderbeut vëllamët me gjak të pirë mbahen dhe quhen si të ishin vëllezër prej një babi dhe një nëne dhe nuk shkëmbenin bija në mes tyre¹.

Në viset malore kjo normë njihej nga të gjithë, ndërsa në krahinat e Jugut e të Juglindjes, vëllazëria si pengesë për lidhje krushqie paraqitej e ndryshme. Në zona të tilla si në Bregdet, në Sopik, në Devoll etj., vëllazëria nuk merrej parasysh; ndërsa në Skrapar, në Myzeqe, në Labëri, në disa zona të Pogradecit etj., martesë në mes dy familjeve të vëllazëruara nuk lejohej. Sigurisht edhe këtu pengesa nuk shkonte në pambarim, por deri në 3-4 breza.

Shtrirje të ndryshme ka pasur edhe ndalesa e martesave midis familjeve që kishin kumbari me njëra-tjetrën. Kumbaria është lidhje që përftohet nga dëshmia në martesë, marrja e flokëve, për të krishterët edhe mbajtja e fëmijëve në pagëzim. Në përgjithësi, ata që lidhnin kumbari dhe pasardhësit e tyre bëheshin «shtëpi» me njëri-tjetrin dhe nderoheshin si të ishin të një gjaku brez pas brezi. Si të tillë edhe krushqia u ndalohej. «Shka asht gjaku e gjinia për kah krushqia, ashtu edhe kumbaria»,² thuhet në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Norma të veçanta, sipas llojit të kumbarisë, ndalonin lidhjet martesore. «Kumbaria e kunorës e ndalon krushqin për robt e shpis së kumbarëve e të shpis së dhandrit»³; «Kumbaria e flokëve e ndalon krushqin brez pas brezi ndërmjet shpis, vllaznis e zjarrmit të kumbarës e të ndrikullës»⁴; «Kumbaria e pagëzimit e ndalon krushqin brez pas brezit jo veç ndër të pagëzuemin, prindën e të pagëzuemit e ndër ata, që e peshojnë në derë të kishës, por edhe ndër sa rob të ketë shpia e njanës e tjetrës lagje e të zjarrmit të tyne mbarë».⁵

1 Kanuni i Skënderbeut — Arkivi etnografik (AE) 44/3, f. 15.

2 KLD F. 72.

3 Po aty.

4 Po aty.

5 Po aty.

Edhe sipas kanunit të Skënderbeut, ndalohej krushqia në mes të familjeve të lidhura me kumbari dhe pasardhësve të tyre. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për krahinat ku vepronte Kanuni i Labërisë dhe për zonat e tjera. Por në këto vende ky fenomen paraqitet më i zbutur. Bile në disa raste ndalesa për martesë ishte vetëm ndërmjet dy familjeve që ishin lidhur drejtpërdrejt me kumbari dhe jo fisit të tyre, ose në mes dy fëmijëve të pagëzuar në të njëjtin ujë etj.

* * *

Materiali i parashtruar tregon se ekzogamia te një pjesë e shqiptarëve ka vepruar deri në gjysmën e parë të shekullit tonë. Dhe kjo ka qenë sanksionuar edhe në të drejtën zakonore të popullit shqiptar. Por po të nisemi nga fakti se burimi i së drejtës zakonore të shqiptarëve duhet kërkuar në origjinën dhe në zhvillimin e tyre shoqëror e ekonomik gjatë shumë shekujve dhe se gjatë kërkohën edhe ndikime të huaja e sidomos të së drejtës kanonike dhe të shariatit, do të shohim se problemi i martesës në gjak e në gjini nuk ka qenë gjithmonë kështu, veçanërisht për lidhjet e krushqisë brenda gjinisë.

Siç mësojmë nga burimet e shkruara mesjetare, martesë brenda gjinisë në mesjetë e më vonë ishte e zakonshme. Bile, në fundin e shekullit XII kaq e shpeshtë ka qenë martesë në gjini sa që në vitin 1199 u mbajt koncili kishtar i Tivarit, i cili me urdhër kërkonte të ndalonte lidhjen martesore deri në të shtatin brez. Duke iu referuar akteve të këtij koncili mësojmë: «Kisha e shenjtë romake ka vendosur që asnjë i krishterë të mos guxojë të lidhë martesë gjer në të shtatin brez, gjë kjo që kemi marrë vesh se në fakt është praktikuar nga shumë veta në viset e Dalmacisë e të Dioklesës. Ky është një faj tepër i rëndë dhe i denjë për t'u dënuar nga gjyqi hyjnor. Fakti se nje-

rëz, të cilët s'kanë frikë perëndinë, nuk druhen të lidhin martesë kundër kushtetutës së etërve të shenjtë me farefis në të katërtin e në të pestin brez edhe më poshtë. Për këtë arsye, me këtë dekret po vendosim që kushdo që vendos të vërë kurorë, sidomos në të katërtin brez ose më poshtë, në qoftë se nuk do të vërë në vend urdhrin e kishës dhe s'do të shmanget nga bashkimi i përlyer i farefisnisë së vet, të mbetet i mallkuar dhe i veçuar nga të gjitha sakramentet e kishës për aq kohë gjersa të ndahet nga lidhja e shëmtuar dhe të veprojë sipas urdhrin të kishës»¹.

Nga shekulli XV e këtej, siç na dëshmojnë të dhënat dokumentare, martesë brenda gjinisë lejohej. Në një letër që i shkruan Ndreu II, ipeshkvi i Arbërit, papës Eugjeni në vitin 1443, i kërkon atij ndihmën për shumë mëkate të bëra nga besimtarët dhe kërkon «të mundet me i rregullue martesat e bame në të shumtën në mënyrë të palejueshme». Dhe papa i përgjigjet Ndreut dhe i jep pushtet. «Për dy vjetët e ardhshëm që të zgjidhte ku të ishte e nevojshme, të rregullonte martesat e bame në të tretin e në të katërtin brez»².

Edhe në shekujt e mëvonshëm bëheshin martesë brenda gjinisë. Në shekullin XVII, p.sh., ky fenomen shfaqej shumë i rreptë, «[-Fajoseshin-] për martesë në shkallë të ndalueme»³, i shkruan Marin Bici, arqipeshkvi i Tivarit, papa Palit V. Dhe më poshtë po ky relator, duke iu drejtuar besimtarëve thotë: «Me çuditje shumë të madhe e me keqardhje ju kemi gjetë, nëse jo të gjithë, por së paku shumicën tuaj, të lidhur me martesë në shkallë të ndalueme prej kishës së shenjtë tue përfshi edhe shkallën e 4-të, dhe pak ia keni kujdesin që të ndreqeni nga ky shrrë-

1 Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. 2, shek. VIII-XV Tiranë 1962 f. 29. (Aktet e koncilit kishtar të Tivarit 1199).

2 Farlati, D. *Illyricum Sacrum VII/197-198, Venetiae, Jacopo Coleti, 1817.*

3 Relazione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII, Tiranë, 1963, Vëll. I, f. 195.

gullim kaq dëmtues e skandaloz»¹. Kaq shumë martesë me të afërm bëheshin në këtë kohë, saqë një ipeshkëv i Shkodrës, megjithëse, siç pohon vetë në relacion «kam shkatërrue... 300 martesë të bame e të celebrueme prej priftënve të këqinj (kundër urdhnit) të Kishës së Shenjtë, në gradë të parë të afrisë e në të dytën e në të tretën»², ankohet përsëri se ka shumë martesë në shkallë të afërme.

Edhe në krahinat e tjera ndodhnin martesë në të afërm. Marin Bici pohon se në famullinë e Samrishtit ka gjetur martesë të bëra në shkallë të ndaluara, madje edhe në shkallën e parë të farefnisë, ndërsa në famullinë e Shënkollit të Pulaj ka gjetur tri martesë të tilla³. Sekretari i ipeshkëvit të Lezhës, në relacionin e tij, vë në dukje se ka pasur burra që «kishin marrë për grua kushërirën ose mbesën»⁴. Ndërsa një tjetër shkruan më 1632 se ka pasur burra që martoheshin me kushërira⁵.

Megjithëse të dhënat e mësipërme nuk tregojnë afrinë e të martuarve, nëse janë të një gjaku apo të një gjinie, mendojmë se afria në këto raste është nga vija e nënës. Jemi të këtij mendimi, sepse kisha katolike ka quajtur mëkat si martesën brenda gjakut ashtu dhe brenda gjinisë, sigurisht, kur shkelej kufiri i brezave sipas së Drejtës Kanonike. Në anën tjetër, po në të dhënat e relatorëve të shekullit XVII gjejmë pohime që martesë në vijën e babait ka qenë e ndaluar. Duke iu referuar relacionit të Frang Bardhit, mbi krahinën e Pukës, dhënë më 1637, marrim vesh se secili prej fshatrave të Pukës «asht prej një race (fisi) dhe rrjedh prej një trugu dhe kryeprindi, kështu që janë në gradën e katërt dhe në të pestën të farefnisë. Dhe kanë zakon që, edhe po të jenë më të 20-tën gradë,

1 Relcaione mhi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shek. XVII, vëll. 1, f. 197.

2 Po aty, f. 329.

3 Po aty, f. 223.

4 Po aty, f. 387.

5 Po aty, f. 429.

ato si edhe të gjithë në Shqipni, mjaft të jenë të një mbiemri dhe të një race, kurrë nuk bashkohen me martesë... , sepse e ruajnë familjen dhe farefisninë»¹.

Për sa i përket të dhënave të relatorëve të shekullit XVII, duhet vënë në dukje se kisha katolike quan lidhje afrie edhe kunatinë. Pra, relatorët në shkrimet e tyre kanë përfshirë si të afërt edhe rastet e tilla. Por, pavarësisht nga kjo, martesë në gjini në këtë kohë ka qenë diçka e zakonshme. Madje martesë me kushëri të nënës lejohej deri në fund të shekullit XIX dhe për disa zona të Veriut edhe në fillim të shekullit tonë. Të dhënat tona dhe të etnografëve të tjerë tregojnë se martesë në gjini nuk merrej parasysh. «Vajzat i martojmë shumë larg — thonë në Dukagjin, — në fise ku kanë motra, halla, teze etj., të afërme». Si rrjedhim i kësaj, fiset që bëjnë krushqi pa ndërprerje, janë në realitet shpeshherë të lidhur shumë ngushtë nga ana e gruas.

Normat e ekzogamisë të shqiptarët, siç e pamë, paraqiten të ndryshme. Në zonat malore të Shqipërisë ekzogamia ruhej, por edhe këtu, në disa nga këto krahina, normat e saj filluan të prishen, ndërsa në disa zona të tjera vazhduan të ruhen të gjalla edhe pas Çlirimit.

Poligamia

Familja mbizotëruese në vendin tonë ka qenë familja monogame. Pavarësisht nga raste të veçanta që mund të jenë ndeshur në krahina të ndryshme, ku një burrë mund të kishte dy dhe shumë rrallë tri gra, raste të cilat ndesheshin në shtresat e pasura të shoqërisë, në bejlerë dhe në agallarë, në popullin tonë martesë ka qenë monogame.

Por edhe në shtresat e pasura poligamia nuk ka qenë një fenomen i përgjithshëm. Ajo, si ndikim i pushtuesit osman, ishte një poligami orientale, e kufizuar në një grup të vogël të pasurish, bejlerë e agallarë.

1 Po aty, Vëll. 2, f. 87.

Është krejt ndryshe martesë e një burri me grua të dytë dhe nganjëherë edhe të tretë, që e bënte për të pasur fëmijë, kryesisht djem. Sipas konceptit që mbizotëronte në popullin tonë në të kaluarën, detyra kryesore e gruas ishte të lindte sa më shumë fëmijë. Dhe meqenëse te ne fuqia mbrojtëse dhe ndikimi i familjes mbështeteshin në numrin e meshkujve, ishte e natyrshme dëshira për të pasur sa më shumë djem. Një grua që nuk lindte, apo lindte vetëm vajza, ishte e dënuar të pranonte gruan e dytë të burrit të saj ose të pranonte ndarjen. Pra në popullin tonë njihej poligamia e kufizuar për të lindur djem dhe kjo ishte e përhapur në shumë krahina pavarësisht nga feja e popullsia që banonte në to.

E drejta jonë zakonore e ndalonte poligaminë, duke e quajtur gruan e mbajtur mbi kurorë «kundër fejet e kanujet»¹. Kjo padyshim ka hyrë në Kanunin e Lekë Dukagjinit nën ndikimin dhe me angazhimin e drejtpërdrejtë të kishës katolike.

Në të vërtetë e drejta jonë zakonore, në një të kaluar e ka njohur martesën me grua të dytë për të lindur djem. Vetë Shtjefën Gjeçovi që në vitin 1913 ka botuar një artikull, në të cilin veç të tjerash, tregon edhe mënyrat e martesës sipas së drejtës zakonore që janë të njëjta me ato që përmenden në kodifikimin e tij, në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Por në këtë artikull Gjeçovi në një shënim thotë se në një studim tjetër të tij «Ndër doke darzmash», «kan m'u shtjellue ma çiltas e ma gjatë edhe mënyrat e martesave»². Në këtë punim të pabotuar thuhet

1 KLD. f. 10.

2 Arkivi Qendror Historik (AQH). Fondi Shtjefën Gjeçovi në «Kanun të Maleve». Gomsiqe 1910-1911 (dorëshkrim origjinal). Në këtë studim thuhet ndër të tjera «Shkaf a shqiptar nuk martohet për mirakanne (qejf), qëllim i martesës s'ti asht me pas fmii porse diel dhe jo cuca. Kur gruaja bë cuca, burri i saj merr grue më grue jo për tjetër, jo për mirakanne po me pas djelm. Shqiptari e qet mas shpine dashnimit e të mallit (madhit — A. D.) zot për me pas djelm.»

se poligamia e kufizuar, domethënë për lindjen e djemve, ishte zakon panshqiptar.

Edhe nga gjurmimet tona në terren, të bëra në krahina të ndryshme të Shqipërisë, nga materiali i mbledhur në Kosovë dhe nga krahina e Çamërisë, del qartë dhe në mënyrë të padyshimtë se kjo trajtë e poligamisë së kufizuar për të lindur djem zbatohet gjatë periudhës së marrë në studim deri në vitin 1928 dhe 1929 me hyrjen në fuqi, përkatësisht të kodit penal dhe të kodit civil shqiptar.

Martesa me grua të dytë praktikohet më shumë në krahinat malore me zhvillim të ulët ekonomik e shoqëror, aty ku vepronte e drejta zakonore. Por, edhe në këto krahina, kjo formë martesë ishte e kufizuar, sepse populli një gjë të tillë e përbuzte. Është tjetër gjë dëshira për të pasur fëmijë dhe tjetër martesë me grua të dytë. Në këtë rast për të marrë gruan e dytë duhej të ndahej e para; kjo ndodhte më shumë në zonat e Shqipërisë së Jugut, në popullsinë myslimane dhe ortodokse. Ndërsa në viset e Shqipërisë së Veriut, veçanërisht në elementin e besimit katolik, nuk ishin të rralla rastet kur një burrë bashkëjetonte me dy gra dhe këtë e bënte sepse feja katolike nuk e lejonte në asnjë mënyrë shkurorëzimin. Dhe me gjithë ndërhyrjet e kishës dhe me ndëshkimet e rrepta që ajo merrte nuk u arrit të mënjanoheshin, ndonëse duhet pranuar se ato po bëheshin gjithnjë e më të rralla.

Mund të mendohet se poligamia e kufizuar, për të cilën folëm më lart, është shfaqur dhe përhapur në vendin tonë pas pushtimit osman, nën ndikimin e shariatit, që në kundërshtim me fenë e krishterë e lejonte poligaminë. Por materialet e shumta e kundërshtojnë këtë mendim.

Së pari, instituti i martesës poligame është shumë i vjetër dhe universal, është siç thotë Engelsi, mbeturinë e shkallës së lartë të barbarisë me të cilën midis martesës me çifte dhe monogamisë futet sundimi i burrave mbi skllavet dhe poligamia.

Së dyti, që kjo dukuri ekzistonte qëmoti në vendin tonë, na e tregojnë edhe relacionet e gjysmës së parë të

shek. XVII, atëherë kur islamizimi nuk kishte marrë përhapje të mëdha, si dhe dokumentet e mëvonshme që bëjnë fjalë për këtë problem.¹ Kaq e përhapur ka qenë bigamia në zonat katolike të vendit sa kisha mallkonte besimtarët që mbanin dy gra. «Kioft mallkuem ai, chi të mban dy gra» thuhet në një dokument të vitit 1744.² Deri në fund të shek. XIX ndeshen prova të ekzistencës së poligamisë. Kështu, p.sh., në dokumentet e vitit 1893 kryepeshkopi i Shkodrës i ishte drejtuar sergjerdës, duke kërkuar nga ai që të burgosë disa malësorë që jetonin në poligami, që rrëmbenin gra etj. Dhe ky burgim përdorej si masë administrative për të hequr dorë fajtorët nga poligamia ose për të liruar gratë e rrëmbyera. Sergjerda zbatonte masën e burgimit dhe, më vonë, po sipas kërkesës së kryepeshkopit i lironte fajtorët e penduar³.

Gjithashtu, autorët e huaj të shek. XIX pohojnë se zakoni i poligamisë së kufizuar ishte përhapur jo vetëm në krahina që banoreshin nga myslimanë ose me banorë të të dy feve por edhe në krahina të banuara vetëm nga të krishterë si Shpati, Thethi.

Islamizimi i një pjese të Shqipërisë rigjallëroi zakonin e poligamisë, por kjo i takonte më tepër klasës feudale të vendit, çifligarëve të mëdhenj dhe më rrallë agallarëve.

1 Në vitin 1610, Marin Bici, në relacionin e tij, tregon se në Mirditë ka gjetur raste që burrat mbanin në shtëpi konkubina (gra pa kurorë); dhe në relacionin e Don Voncentit mbi vizitën e Benedik Orsinit nëpër malësinë e Shkodrës, më 1629, duke folur për krahinën e Pultit thuhet se ka shumë mëkatnorë publikë, disa me dy gra. Madje B. Orsini në relacionin e vitit 1629 mbi vizitën në dioqezën e Shkodrës shkruan: «... Në tokën e Shoshit gjeta një nga krerët e vendit që kishte 9 gra.» ... Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII, vëll. I, f. 159, 387-397.

2 Kolë Kamsi. *Një dokument gjuhësor shqip* (1744). Buletin i USHT. Seria Shk. Shoq. 1958, nr. 2, f. 211.

3 AQH, Fondi i Shkodrës, Shënime historike mbi Shkodrën, Shkresë nr. 164, dat. 4. 3. 1893 e kryepeshkopit drejtuar sergjerdës.

Nga sa pamë mund të themi se në Shqipëri, në gjysmën e dytë të shek. XIX, deri në çerekun e parë të shekullit tonë, praktikohej poligamia e kufizuar për të lindur djem dhe se ky institucion në vendin tonë nuk është i ndikimit osman, por është shumë i vjetër.

Levirati dhe sororati

Një mbeturinë tjetër e lashtë, mbeturinë e martesës me grupe, është edhe levirati e sororati. Levirati (nga latinishtja kunat, vëllai i burrit) shprehet në atë që gruaja e ve është e detyruar ose ka të drejtë të martohet me vëllanë e burrit të saj të vdekur, kurse ky vëlla ose ka të drejtë ose është i detyruar në të tilla raste, të martohet me të. Ndërsa sipas sororatit (soror-motra), burri i ve duhet ose mund të martohet me motrën e pamartuar të gruas së vdekur.

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shek. XX raste të leviratis dhe të sororatis ndesheshin në disa krahina të Shqipërisë. Levirati ka qenë më i përhapur se sororati, por edhe ky po bëhej gjithnjë e më i rrallë, bile në disa krahina ai përbuzej.

Sipas të dhënave të ndryshme, nga shek. XVII e deri në gjysmën e shek. XIX ky zakon ka qenë përdorur mjaft të shqiptarët, veçanërisht në zonat e Shqipërisë së Veriut.¹ Bile më përpara këtë normë e gjejmë edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit. Në një artikull botuar në vitin 1871 me

1 Sipas relacionit të Don Vincentit të vitit 1628 mbi vizitën e B. Orsinit nëpër malësinë e Shkodrës mësojmë se aty «shumë mëkatnorë publikë. . . . kishin marrë për grua kunatat». Këtë gjë e pohon Orsini edhe në vitin 1629 dhe 1632. Edhe në relacionin e arqipeshkvit të Tivarit Gjergj Bardhi të vitit 1636 thuhet se një vëlla nga fshati i Gashit kishte marrë për grua të venë e vëllait të tij. (Relacionet, vëll. I, f. 387, 397, 429; Relacionet vëll. 2, f. 45).

titull «Ligja e Dukagjinit» në gazetën «Prizren», duke gjykuar në bazë të tij, mësojmë se në atë kohë në normat e kanunit përfshiheshin edhe norma të tilla si martesë dhe pengesat martesore, mbi fejesën dhe rimartesën e gruas me vëllanë e burrit të vdekur etj.

Por më vonë, duke filluar nga çereku i fundit i shekullit të kaluar, hyri në KLD dhe KS norma që ndalonte leviratën dhe sororatin.

Sipas pikëpamjes patriarkale, ishte një detyrë morale që një djalë të martohej me të venë, jo vetëm të të vëllait por edhe të kushërinjve të tij që banonin në një familje. Dhe qëllimi i marrjes për grua të kunatës së ve ishte se ajo duhej të qëndronte në shtëpinë e burrit dhe të rriste fëmijët. Dhe pikërisht këtë grua të ve me fëmijë ishte i detyruar ta merrte i kunati. Kaq e vërtetë ishte kjo, sa që gruaja e ve vetëm po të mos kishte fëmijë pyetej nga i zoti i shtëpisë nëse donte të qëndronte apo dëshironte të kthehej në gjini të saj. Rastet e kthimit të gruas së ve në gjininë e vet kanë qenë shumë të rralla. Populli kishte besim të rrënjësor thellë që ishte e drejtë e ligjshme të merrte për grua të venë e vëllait apo të kushëririt, derisa ajo vazhdonte të banonte në shtëpinë e përbashkët.

Sigurisht në mbajtjen gjallë të leviratit e të sororatit ka ndikuar drejtpërdrejt mënyra patriarkale e jetesës, forca e zakonit etj., por arsyeja bazë për praktikimin deri vonë të këtij zakoni, ishin shpenzimet e mëdha që bëheshin për të siguruar një grua. Do të ishte më e leverdishme që të mbaje gruan e ve në shtëpi, për të cilën nuk do të harxhoje asgjë, se sa të përpiqeshe për të siguruar një tjetër. Veç kësaj, familjes nuk i interesonte që të lironte një krah pune nga ekonomia e shtëpisë.

Martesa me rrëmbim

Në mbeturinat e lashta të trashëguara nga populli ynë dhe që kanë të bëjnë me martesat, është edhe rrëmbimi i vajzave dhe i grave. Ndonëse, për kohën që flasim deri

në Çlirim, ky fenomen ka qenë shumë i rrallë, në një të kaluar më të largët ishte mjaft i përhapur. Këtë fenomen e ka njohur edhe e drejta zakonore, megjithëse KLD dhe KS nuk e përligjnin një gjë të tillë. Në KLD thuhet: «Gruaja e vajza e grabitun e jashtëzakonshme kah feja e kanuja»¹. Kjo normë e përfshirë në Kanunin e Lekë Dukagjinit është një ndikim i drejtpërdrejtë i së drejtës kanonike, e cila e dënonte një veprim të tillë.

Duke filluar nga shekulli XIV e deri në shekullin XVIII dokumente të shumta dëshmojnë se grabitja e vajzave dhe e grave ka qenë mjaft e përhapur.²

Përhapjen e këtij zakoni, veçanërisht para shekullit XIX, e tregon edhe folklori ynë. Në repertorin e kreshnikëve një vend të rëndësishëm zënë edhe rrëmbimet e vajzave të palës kundërshtare. Këtu nuk është fjala për grabitje të thjeshta dhe të rastësishme, por për një institucion që ndihet i pranishëm dhe i harmonizuar në të gjitha momentet kryesore të këngëve. Subjektet tona sjellin raste, sado të kufizuara, ku bëhet fjalë për rrëmbime në grup. Muji me çetën e tij, organizon inkursione luftarake

1 KLD f. 10.

2 Nga Krisobula e carit Stefan Dushan me të cilin i dhuron Manastirit të shën Mërisë në Tetovë prona dhe të drejta të tjera feudale në vitin 1337 mësojmë se ky zakon duhet të ketë qenë shumë i përhapur përderisa ai thotë: «Dhe gjobat nga grindjet midis njerëzve të kishës si dhe nga *grabitjet e femrave* (nënvizimi ynë — A.D.) t'i marrë kisha». (Dokumente të zgjedhura për historinë e Shqipërisë» vëll. 2, f. 127).

Edhe më vonë grabitja e grave ka vazhduar te populli ynë. Në «Pasqyra e të rrëfyerit» e Pjetër Budit flitet gjatë për «mëkatet» që bëjnë të krishterët duke grabitur vajzat dhe gratë e të tjerëve. «A mos kishnja rrëmbyem oo grabitun kund ndonjë grua, e cila kafshë jo veçse është mkat murtaar e kundra ligjsë». Pasqyra e të rrëfyerit, f. 51. Në një dokument gjuhësor shqip të vitit 1744 thuhet: «Kjoft mallëkuem kush grabisin varzat, të vejat e tjera gra, ende kusc të mbahet sabet e ndim» (Kolë Kamsi, Bul. USHT, Seria Shkencat Shoqërore, 1968, nr. 2, f. 211).

në vise të Krajlisë ku zihen 30 e 300 çika «robina», me të cilat martohen 30 a 300 djem të Jutbinës. Por këngët më të shumta paraqesin ndërmarrje për martesë të një he-roi të caktuar.¹

Grabitje grash kanë ndodhur edhe gjatë shek. XIX dhe fillimit të shek. XX. Duke iu referuar të dhënave to- na del se ky fenomen ka qenë më i përhapur në zonat ma-lore. Dhe në shumicën e rasteve rrëmbimet e grave ndo- dhnin ndërmjet fisesh apo çetash të ndryshme, ndërmjet të cilëve lindte një armiqësi e madhe gjaku. Në të vërtetë rrëmbimi i grave në vendin tonë ka sjellë pasoja të mëdha. Shumica e vrasjeve që kanë ndodhur në kohë të ndryshme janë bërë edhe për shkak të rrëmbimit të grave. Dhe në të gjitha rastet, me përjashtim kur të dyja familjet merre- shin vesh me njëra-tjetrën, shtëpitë që u rrëmbeheshin vajzat binin në gjak me shtëpitë e djemve, goftë edhe kur kjo bëhej me pëlqimin e vajzës. Vrasja e djalit që rrë- mbente vajzën ose e ndonjë mashkulli nga farefisi i tij, e shpëtonte shtëpinë e vajzës nga hakmarrja e të fejuarit të parë, për të cilin ishte një çnderim i madh kur i merr- nin të tjerët vajzën e zënë. Prandaj ai e kërkonte vajzën me çdo kusht, pavarësisht se ndaj saj nuk ndjente asgjë dhe nuk e kishte parë kurrë. Këtë gjë e bënte për ta ruaj- tur nderin e tij e të shtëpisë.

Rrëmbimi i grave ka qenë një fenomen i përgjith- shëm, të cilin e kanë kaluar të gjithë popujt, dhe i përgji- gjjet periudhës së martesës me çifte. «Ndërsa në format e mëparshme të familjes (në kohën e martesës me grupe -A. D.) — shkruan Engelsi — për burrat nuk kishte ku- rrë mungesë grash, por, përkundrazi, kishte më tepër se sa duheshin, tani gratë u bënë të rralla dhe duheshin kë- rkuar. Prandaj me lindjen e martesës me çifte fillon rrëm- bimi dhe blerja e grave»².

1 Qemal Haxhihasani, *Tema e martesave në këngët tona të kreshnikëve*, Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike, Ti- ranë, 1977, f. 185.

2 F. Engels, *Vep. cit.*, f. 67-68.

Por megjithëse, siç e pamë edhe nga materiali, për periudhën që kemi marrë në shqyrtim janë ruajtur gjurmët e rrëmbimit të grave, kjo gjë nuk ka qenë tipike e kohës, por vetëm një përjashtim.

Në gjurmimin që i kemi bërë kësaj çështjeje kemi mundur të nxjerrim edhe një varg arsyesh që detyronin rrëmbimin e grave. Së pari, për arsye ekonomike. Në këtë rast, me pëlqimin e të dy palëve, të djalit e të vajzës, me qëllim që të evitoheshin shpenzimet e martesës, organizohej rrëmbimi. Kështu që të dyja familjet shpëtonin nga detyrimet ekonomike që kishin ndaj njëra-tjetrës. Raste më të shumta për këtë shkak ndodhnin në shtresat e varfra të popullsisë.

Së dyti, shkaku i mungesës së lirisë në zgjedhjen e burrit, i shtynte vajzat që të iknin nga shtëpia e prindërve. Në të kaluarën, siç marrim vesh nga dokumentet e shekujve XVII-XVIII, ikje të tilla ishin të shpeshta. Por me masat shtrënguese të marra herë pas here dhe me ndërhyrjen e vazhdueshme të kishës, veçanërisht të kishës katolike, e cila ka luajtur një rol reaksionar në të gjitha drejtimet, iu mbyll ky shteg gruas shqiptare duke e detyruar atë t'i nënshtrohej fatit të saj; ikjet u bënë kështu shumë të rralla pasi dënoheshin nga feja dhe nga kanuni.

Së treti, kur vajza refuzonte të martohej me djalin që i kishin zgjedhur prindërit. Në këtë rast prindërit e djalit, në marrëveshje me ata të vajzës, organizonin rrëmbimin.

Së katërti, kur shtëpia e vajzës refuzonte kërkesën e shkuesit të djalit për zënie e saj. Atëherë në shenjë hakmarrjeje njerëzit e djalit rrëmbenin vajzën.

KARAKTERI I LIDHJEVE MARTESORE PARA ÇLIRIMIT

Në përgjithësi, deri në prag të Çlirimit të populli ynë, martesat ruajtën karakterin e lidhjeve të vjetra të saj, një marrëveshje që bënin dy familje ose dy prindër (zakonisht baballarët) midis tyre pa pyetur të interesuarit. Kjo dukuri ishte e përgjithshme për shqiptarët, por më e theksuar ka qenë te klasat e pasura: borgjezët, bejlerët, bajraktarët, të cilët nusen e djalit kërkonin ta gjenin nga sëra e tyre. Për këto familje martesat ishin më shumë një marrëveshje që sillte forcimin e pozitës së tyre, shtimin e fuqisë dhe të pasurisë së shtëpisë. Rolin vendimtar e luanin interesat e shtëpisë dhe jo dëshirat, ndjenjat e të rinjve.

Në zonat malore, marrëdhëniet familjare — martesore trajtoheshin kryesisht sipas normave të së drejtës zakonore.

Sipas saj djali dhe vajza nuk kanë të drejtë të mendojnë për martesën e vet. «Djali sa të ketë prind, — thuhet në kanunin e Lekë Dukagjinit, — s'ka tagër me mendue për martesë të vet»¹. Kjo ishte më e theksuar për vajzën, për të cilën, edhe nëse nuk i kishte prindërit, «tagri — thoshte kanuni, — asht në dorë të vëllazënve e të kushërinjve. (Vajza — A. D.) do të shkojë për atë për të cilën e fejojnë»². Të njëjtat norma përfshihen edhe në Kanunin e Skënderbeut.

1 KLD, f. 10.

2 KLD, f. 11.

Në krahinat me fshatarë të vegjël dhe në zonat çifligare, megjithëse e drejta zakonore ishte dobësuar mjaft, normat e martesës, të gërshetuara me normat e së drejtës kanonike dhe të shariatit, qëndruan më gjatë dhe ishin ato që rregullonin lidhjet martesore. Në ndonjë rast të rinjtë, sidomos djemtë edhe pyeteshin, por mendimi i tyre nuk mund ta prishte dëshirën e prindërve.

Kështu ka qenë edhe në shtresat zejtare dhe tregtare të qytetit, ku familje të ndryshme të së njëjtës klasë apo shtresë lidheshin me krushqi ndërmjet tyre. Krushqia më e përshtatshme edhe në këtë pjesë të popullsisë së qyteteve varej jo nga dëshira e të rinjve por nga interesi i familjes.

Pa dyshim, pushteti absolut i prindit ndaj fëmijës i detyrohej edhe pozitës që zinin fëmijët në ekonominë e shtëpisë. Në shumë zona djali nuk kishte pasuri të vetën. Ajo ishte e përqëndruar në dorën e të zotit të shtëpisë. Kështu që fëmija, së bashku me të tjerët, ishte i detyruar të punonte në pronën e përbashkët të familjes. Duke mos pasur asnjëlloj të ardhure, i riu nuk ishte në gjendje të përballonte shpenzimet për martesën e vet (përgatitjet e pajës, harxhimet për dasmën etj.).

Në një pozitë më të nënshtuar ka qenë vajza, e cila nuk pyetej fare për këtë çështje. Fejesa i bëhej e ditur nga e ëma ose nga ndonjë grua tjetër e shtëpisë. Në kushtet e ekzistencës së moralit të vjetër feudopatriarkal, vajzës as që i shkonte ndërmend ndonjë herë se mund të plotësoheshin ëndrrat e saj. Ajo nënshtrohej dhe shkonte atje ku i kishin lidhur «fatin». «Në Shqipëri — shkruante Pashko Vasa — kurrë nuk pyeten zemrat e vashave, kur është fjala për martesë, prindërit bëjnë si duan vetë me to. Të ankohej ose të reagoje kundër vullnetit atëror, kjo gjë do të ishte një krim, që vajza e ndershme nuk do të guxonte kurrë ta bënte»¹.

Për zgjedhjen e nuses kujdesej i zoti i shtëpisë, i cili këshillohej jo vetëm me burrat e familjes, por shpeshherë edhe me burrat e vëllazërisë dhe të farefisit të tij.

1 Pashko Vasa, Bardha e Temalit, Prishtinë, 1969, f. 25-26.

Në zonat malore me zhvillim ekonomik e shoqëror të ulët, autoriteti i të zotit të shtëpisë shfaqej më i fuqishëm dhe fjala e tij vështirë se mund të shkelej. Ndërsa në fshatrat çifçinj, ku jetonin fshatarë të zhveshur nga pronësia mbi tokën, autoriteti i tij ishte më i vogël, e prandaj në ndonjë rast të rinjtë martoheshin pa pëlqimin e prindërve. Në këto krahina dëgjohej shumë edhe fjala e beut apo e agait, të cilët shpeshherë i detyronin të rinjtë të merrnin si bashkëshort të zgjedhurin prej tyre.

Në zonat pranë qyteteve, si dhe brenda në qytete, sidomos në disa krahina të Shqipërisë Jugore dhe Juglindore, vihet re njëfarë largimi nga këto parime patriarkale-feudale. Në klasat e pasura, sidomos të qytetit, po edhe të fshatit, ai po merrte tiparet e pushtet patriarkal-borgjez, i cili më shumë e më hapët se kushdo i shihte të gjitha marrëdhëniet nën prizmin e parasë e të fitimit.

Në zgjedhjen e nuses ai kujdesej që vajza të ishte në rangun e tij, nga shtëpi e mirë, me kamje, punëtore. Nga ana e tij, edhe babai i vajzës kishte të njëjtat kërkesa për djalin. Sigurisht, duhet bërë dallimi i lidhjeve martesore në mes klasave dhe shtresave të popullsisë. Zakonisht martesat bëheshin brenda klasës apo shtresës së popullsisë. Kjo ishte e përgjithshme. Ka pasur raste që **fizike e mendore, ose burra të kaluar në moshë merrnin për gra vajza nga shtresa të varfra.**

*
*
*

Në popullin tonë ndërmjetësimin për martesën e dy të rinjve mund ta merrte kushdo që njihnte dy familjet dhe që e shikonte të përshtatshme lidhjen e tyre me krushqi. Por kudo në Shqipëri, një rol të madh në këtë drejtim kanë luajtur bijat e martuara, të cilat bëheshin ndërmjetëse për martesën e motrës, të kushëririt, të vëllait apo të kushëririt të tyre. Dhe, pavarësisht se kush do ta bënte rekomandimin, si rregull iniciativën për kërkesë

e merrte pala e djalit. Ka pasur edhe raste që ana e vajzës mund të bënte kërkesë. Sigurisht, kjo e fundit nuk ka të bëjë dhe nuk është mbeturinë e formës së vjetër të ndërmjetësimit që i përket periudhës së matriarkatit, kur nëna interesohej dhe ndërhynte për martesën e fëmijëve. Kjo është një dukuri e vonë që përkon me zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste në Shqipëri. Ky lloj ndërmjetësimi praktikohet më shumë në shtresat e pasura të popullsisë dhe zbatohet më tepër në qytete.

Shkuesia



Përpara Çlirimit ndërmjetësimi për kërkesën e vajzës nuk bëhej drejtpërdrejt nga prindërit, por me anën e një personi të tretë, shkuesit. Shkuesia përdorej gjerësisht. Ajo i paraprinte fejesës dhe martesës. Prindërit ia jepnin fjalën shkuesit, i cili ndërmjetësonte për zënieën e vajzës për djalin dhe për martesën e tyre, pavarësisht nga fakti që bashkëshortët e ardhshëm nuk e kishin parë apo nuk e kishin njohur njëri-tjetrin.

Në krahina të veçanta shkuesi thirrej me emra të ndryshëm: *shkues, mesit, mbles, lajmës, krushqar* etj.

Shkuesi zakonisht duhet të ishte mik i të dy familjeve, të djalit dhe të vajzës. Në këtë mënyrë, ai do ta kishte më të lehtë misionin e tij. Veç kësaj, duhet të ishte një person që i njihnte mirë zakonet.

Ai do të shkonte disa herë në shtëpinë e vajzës derisa të bindte prindërit për moskundërshtimin e kërkesës së tij. «O lajmës, o din dushman dhe nga ti s'gjetëm derman», thuhet në një këngë popullore.

Shkuesi lavdëronte familjen e djalit, sidomos vetë djalin. Rëndësi të madhe kishin të dhënat për shtëpinë e dhëndrit të ardhshëm, për ekonominë e tij, për numrin e njerëzve të shtëpisë (sa më e madhe të ishte familja, aq më e fuqishme do të ishte ajo dhe, si pasojë, edhe me e preferuar, për traditat e saj patriotike, për besën dhe burrërinë). Bukur shprehej kjo në Myzeqenë e Vogël kur

njerëzit e shtëpisë i drejtoheshin shkuesit. «Ka qull? Ka zile e këmborë?» Preokupimi më i madh i prindërve ishte që vajza të shkonte në një familje, ku të mos mungonte të paktën, buka e bulmeti. Kjo tregon edhe varfërinë e madhe të familjeve fshatare, shumica dërrmuese e të cilave nuk mund të siguronin bukën e vitit.

Rrallëherë qëllonte që, me takimin e parë, ana e vajzës të jepte pëlqimin e vet. Kjo ndodhte vetëm në të tilla raste kur të dyja familjet, që donin të lidhnin kru-shqi, e njihnin mirë njëra-tjetrën dhe binin dakord që në fillim. Shkuesi në të tilla raste kryente vetëm një zakon pa të cilin nuk mund të fejohej një vajzë. Gjithashtu, pëlqimi mund të jepej menjëherë edhe kur shkuesi ishte daja ose një i afërt tjetër i vajzës, për qëllimet e mira të të cilit nuk dyshohej. Në raste të tilla i ati i vajzës i drejtohej shkuesit: «Hajde, mos qoftë prishur, ta kam falur vajzën. Në dorën tënde! Në e gremissh, më paç në qafë mua dhe atë! Në na nderofsh, nderet dhe të mirat të ndjekshin pas me gjithë ç'ke!»

Në shumicën e rasteve përgjigjja nuk jepej menjëherë. I zoti i shtëpisë, ndonëse kishte të drejta absolute mbi fëmijët, sipas zakonit, pyeste burrat e shtëpisë. të vëllazërisë dhe të farefisit, të cilët, të gjithë së bashku, hetonin për shtëpinë dhe për djalin.

Ndër ata që pyeteshin nga i zoti i shtëpisë apo prindi i vajzës që edhe daja. Kjo ishte një dukuri e mbarë popullit tonë, ndonëse në krahina të veçanta viheshin re nuanca të ndryshme. Kujdesi i dajës për zgjedhjen e dhëndrit apo të nuses për nipat dhe mbesat e tij e ka zanafillën e vet në periudhën e kalimit nga matriarkati në patriarkat, ku vëllai i nënës, farefisi mashkull më i afërm, sipas së drejtës amtare, quhej ende si njeriu më i afërm.

Pasi hetohej mirë nga të gjithë, në ditën e caktuar për dhënien e përgjigjes, takoheshin me shkuesin, të cilit i jepnin ose jo pëlqimin. Kur pala e vajzës nuk jepte pëlqimin për lidhje krushoie, asnjëherë nuk tregoheshin arsye të vërteta, gjithnjë përpiqeshin të mos e fyenin palën e djalit. Kur jepej pëlqimi, caktuhej dita e takimit e të dy palëve.

Në përgjithësi, në vendin tonë, për shërbimin që bënte, nga ana e shtëpisë së djalit shkuesit i jepej një shpërblim simbolik, që në të shumtën ka qenë «një palë opinga» ose «një palë këpucë», duke pasur parasysh «dëmin» që kishte pësuar, duke shkuar e duke ardhur nga njëra shtëpi tek tjetra. Më vonë këto morën kuptim më të gjerë, «këpucë» që do të thoshte të pagueshin edhe shpenzimet e ditëve të humbura me këtë rast. Nën këtë emërtim mund të bëheshin edhe peshqeshe të tjera dhe, ngandongëherë jepeshin edhe shpërblime në të holla.

Vlen të theksohet se shkuesia duhet të ketë kaluar në tri faza kryesore: faza e parë, kur shkuesi nuk shpërblehej; faza e dytë, kur shkuesi merrte një shpërblim simbolik dhe faza e tretë, kur shkuesi për misionin e tij kërkonte një shpërblim të mirë. Por faza e fundit, kur hyjnë si shpërblim të hollat, qoftë edhe si ekuivalent i vlerës së «këpucëve të grisura», duhet vlerësuar si një shpërblim jo më simbolik, por një veprim që ndërmerrej nga persona të veçantë me qëllime fitimi. Pra, kjo është koha e degenerimit të këtij institucioni, periudha e kthimit të tij në një marrëveshje thjesht tregtare, nga e cila shkuesi nxirrite përfitime të mira.

Të tria fazat e përmendura më lart janë përdorur nga populli ynë. Por ajo që ka qenë mbizotëruese, për mendimin tonë, është faza e dytë, kur shkuesi merrte si shpërblim një peshqesh simbolik. Kjo nuk përjashton edhe rastet kur njerëz të veçantë, të pandërgjegjshëm dhe të shtyrë nga interesa personale, u kthyen në shkues profesionistë dhe e ushtruan këtë «zanat» vetëm për fitim. Dhe shkues të tillë ka pasur gati në të gjitha krahinat e vendit tonë.

Të nisur nga interesa personale, duke vënë mbi gjithçka fitimin, këta njerëz shpeshherë lidhnin martesë të papërshtatshme, me diferencë të theksuara moshe, me njerëz me të meta fizike dhe mendore. . . Dhe, ndonëse opinioni i prapambetur e reaksionar, klasat sunduese dhe feja e përkrahnin një gjë të tillë, shumica dërrmuese e popullit ishte kundër këtyre qëndrimeve. Gjykimi i shëndoshë popullor, në krijimtarinë e tij, ka satirizuar marte-

sat e shëmtuara që bëheshin me shkuesi, si ato me diferencë të madhe moshe, martesat në vogli etj., dhe me gojën e të rinjve është shprehur protesta e tyre: «Më thojshin shoqet mbëram/ Merre moj, merre plakun-o!/ Plaku kambët si çibuk,/ Shpina e plakut ishte knut,/ Plaku duert si kërthi,/ Plaku barkun si saksii,/ Plaku buzën si mëlçi,/ Qyqja, ç'ta baj plakun-o»?/ «Ç'ke, vash-o, që lan e qan ?/ Laj e qaj se më martun-o/ Më martun-e, më dhënë një plak-e/ Ç'i rash ngjat e gdhina larg-e/ Vinte era, moj, si sqap-e/».

Zënia (fejesa) dhe detyrimet ekonomike ndërmjet palës së djalit dhe palës së vajzës

Zënia e vajzës ishte një marrëveshje ndërmjet zotërve të shtëpive apo prindërve të të rinjve për lidhjen e martesës së ardhshme.

Zënia nuk bëhej me pëlqimin e të rinjve, por me dëshirën e prindërve dhe me ndërmjetësimin e shkuesit.

Në të kaluarën, te ne pak ndihej termi fejesë. Përdorshin fjalët: *Zënie, mblesë, mbulesë, vlesë*. Fejesë, me sa duket, ka hyrë nga fillimi i shekullit tonë, më parë në qytet, veçanërisht në ato të Jugut, duke u përhapur edhe në fshatra. Madje, në Kodin Civil të vitit 1929 fejesa parashikohej si institucion juridik, prishja e së cilës, pa shkaqe të arsyeshme, shkaktonte pasoja juridike. Megjithatë, termi «fejesë» nuk u përhap në masat e gjera popullore dhe të rinjtë e fejuar vazhduan të quhen sipas traditës: *vajza e zënë* (e nxanë, e zanë), *e vluar, e mbuluar*, ndërsa djali *i zënë* (i nxanë, i zanë) *i vluar, i mbuluar*. Por, termi më i përdorur ishte *i zënë, e zënë*.

Në vendin tonë, në përgjithësi, mosha për zënieën e dy të rinjve ka qenë: për vajzat, 12-14 vjeç dhe për djem, 16-18 vjeç. Kjo nuk do të thoshte që prindërit të mos kujdeseshin për zënieën e tyre përpara kësaj moshe. Këtë të drejtë ua jepnin prindërve zakonet patriarkale-feudale, sipas të cilave, babait i njihej e drejta e pakufizuar mbi fë-

mijët, pra, edhe e drejta për zënie e fëmijës në çdo moshë e, ngandonjëherë dhe para lindjes. Ky zakon për parinë kishte karakter të theksuar politik, sepse nëpërmjet fejesave, krushqive, forcohej familja patriarkale, forcoheshin lidhjet ndërfinnore midis familjeve, përjetësohej pushteti politik i klasave shfrytëzuese.

Zënia e fëmijëve që në vogëli, në djep dhe në ndonjë rast që pa lindur, praktikoheshin më tepër në shtresat e pasura. Por, nën ndikimin e tyre, u shtri edhe në shtresat e tjera të popullsisë. Megjithatë ajo praktikoheshin rrallë.

Kjo dukuri ka qenë më e përhapur në shekullin e kaluar ndonjëherë praktikoheshin te mbarë shqiptarët. Fëmijët e të dyja seksëve fejoheheshin që në djep pa u lejuar që të shiheshin e të njiheshin gjatë kohës së fëmijërisë, as kur rriteshin në moshë. Ndodhte shpesh që të fejuarit të mos e dinin se i ishin premtuar njëri-tjetrit. Një rregull i tillë ishte e drejta dhe e fshehta e prindërve të tyre, të cilët ua bënë të njohur të rinjve kur dëshëronin vetë; vajzat zakonisht atëherë ishin 12 vjeç dhe djemtë 18.

Në shtresat e mesme dhe të varfra të popullsisë zënia që në djep ose pa lindur fëmijët bëhej me qëllim që të forcohej miqësia e dy shtëpive. Kjo kryhej drejtpërdrejt, me marrëveshjen e dy zotërve të shtëpisë ose të dy prindërve të fëmijëve. Kur dy gra nga shtëpitë e tyre ishin me barrë, ata shfaqnin dëshirën që, po që se lindnin njëra djalë e tjetra vajzë, të porsalindurit do të quheshin të zënë ndërmjet tyre. Me këtë rast, bëhej ndonjë ceremoni e vogël dhe, kur lindnin fëmijë me seks të kundërt, lajmërohej me të shtëna pushke se të dyja familjet ishin lidhur me miqësi. Ndodhte që zënia e fëmijëve bëhej kur këta arrinin 3-4 vjeç. Për ligjësimin e kësaj shkëmbehej edhe buka, domethënë organizoheshin gosti në të dyja familjet.

Në vendin tonë, me ndonjë përjashtim, në martesën e vajzave ndiqej radha. Në fillim më e madhja, pastaj me radhë. Kjo respektohej kudo dhe, kush e shkelte, përbufej nga të gjithë. Madje, ndodhte që djali, po të kishte

motra, nuk martohet para tyre, pavarësisht se ai mund të ishte edhe më i madh.

Që vajza të quhet e zënë duhet, pa dyshim, që të zhvillohet ceremonia e rastit, e cila zhvillohet në shtëpinë e vajzës ose në shtëpinë e një të treti.

Zakonisht, të dyja palët (ata bëheshin rreth 6-8 vetë, nga 3-4 për secilën palë), pasi mbaronin qerasjen, shkëmbenin nishanet ose dorëzonin shenjën (shejin, si përdoret në Veri). Në përgjithësi, shenjën e dorëzonte një i afërt i djalit, ngandonjëherë edhe i zoti i shtëpisë, apo shkuesi. Ky ia lëshonte në dorë të atit të vajzës. Së bashku me shenjën dorëzoheshin edhe të hollat.

Kanuni i Lekë Dukagjinit e përcaktonte shenjën të përbërë prej «nji unaze të remët a t'argjenët... Unaza e dhetë grosh janë me kanun»¹. Në Kosovë vinin në tryezë unazën dhe një koronë argjendi, që ishte shenja e dhënies së fjalës. Kjo tregonte që vajza ishte lidhur e nuk mund të jepej gjetiu. Edhe në jug të Shqipërisë jepej një shenjë e tillë. Nishani, zakonisht, ishte një para e vjetër floriri ose sermi, e cila nuk qarkullonte në treg. Në shumë krahina të Shqipërisë, veçanërisht në veri, së bashku me unazën jepej edhe një shami. Ajo ishte një shenjë rituale që tregonte se vajza ishte e «mbuluar» apo e «zënë».

Në zonat malore dhënia e shenjës ishte njëfarë kapari (që pala e djalit i jepte asaj të vajzës). Mbas shenjës, askush tjetër s'kishte të drejtë të vinte dorë mbi atë vajzë, ndryshe do të binte në gjak.

Në fillimin e saj shenja, siç duket, ka qenë një objekt i vetëm që nuk shoqërohet me ndonjë plaçkë tjetër. Më vonë u shoqërua me një numër të caktuar objektesh dhe, shpeshherë, edhe me të holla.

Në Malësi të Madhe pasi merrej miratimi për zënie e vajzës, caktohet afati, kur do të dorëzohej «çmimi i nuses». Në këtë datë shkuesi dorëzonte pjesën e parë të «çmimit», domethënë paret e unazës, që përbënin kaparin.

1 KLD, f. 13.

Me kursin e sotëm të të hollave kjo shumë arrinte deri në 500 lekë. Zakonisht, shumë e të hollave e kërkonte miku.

Në Malësi të Gjakovës, para se të pihej kafja e zënies, shkuesi merrej vesh për punën e «mësitit», shpërblimit që pala e djalit duhej t'ia jepte anës së vajzës. Mësiiti në fillim shprehej me dhurata të ndryshme për të afërmit e vajzës, si p.sh. të atit një dhjetëshe turke (revole), vëllait një mauzer, dajës së vajzës një sahat me qostek, s'ëmës dhjetë kokë dhi. Më vonë «mësiiti» u kërkuua në të holla, që arrinin 3 000 deri në 5 000 lekë.

Në Nikaj-Mërtur gjatë kohës së zënies së vajzës lihej një kapar, që ishte një shumë të hollash, të cilat i merrte i zoti i shtëpisë. Në fillim vlera e kaparit ishte e papërfillshme, një mexhide, një koronë apo një lek. Ka pasur raste që si kapar ka shërbyer një shami, një sapun, madje edhe një cigare duhan. Por këto shërbenin vetëm sa për zënien e vajzës. Më vonë bëhej marrëveshja për «pazarin e çikës», që zakonisht pritej 12 qese sermë (baras me 12 napolona flori). Nga këto gysma ishin të hollat e unazës, 6 napolona (baras me 3 000 deri në 4 000 lekë).

Në Lumë (Kukës), kur vinte mahrama, një shami që i jepej shkuesit si shenjë se i ati pranonte të jepte vajzën, familja e djalit, me anën e shkuesit i çonte vajzës disa dhurata si lesh, pambuk, bojëra të ndryshme etj., si dhe disa të holla që quheshin «pare hupsa», sepse nuk llogariteshin në shumë që i caktohej dhëndrit për nusen.

Në Fushë-Arrëz (Pukë) etj. ditën e zënies së vajzës pala e djalit çonte shenjën që përbëhej nga një unazë e një rubë e kuqe, si dhe një shumë të hollash.

Në Lezhë, me këtë rast, përveç unazës së argjenditë dhe shamisë, që ishin të vajzës, shtëpia e djalit dërgonte edhe disa të holla, sasia e të cilave varej sipas kërkesës së mikut. Në qoftë se miku treguhej i arsyeshëm, atëherë shuma ishte e vogël dhe arrinte deri më 300 lekë, por kishte edhe raste që ai kërkonte 1 000 lekë. Këto të holla shërbenin si kapar.

Në Mat çoheshin si shenjë një unazë, një shami dhe disa të holla, ndërsa në Mirditë shenja zakonisht ishte

më e shtrenjtë. Në Kushnen, në të kaluarën, paguanin një shumë të hollash që shkonte 3 000 deri në 4 000 lekë. Po kaq paguanin edhe në Kthellë të Epërme dhe në bajraçet e tjera të Mirditës.

Në zonën e Kurbinut ditën e zënies së vajzës, i ati i djalit dërgonte në shtëpinë e saj shenjën, që përbëhej nga një unazë, një shami mëndafshi dhe një peshtaf, brenda të cilit viheshin sendet e tualetit. Veç këtyre, babai i dhëndrit dërgonte edhe 500 deri në 2 500 lekë (kjo varej nga gjendja ekonomike e shtëpisë së djalit). Kishte edhe raste që këto të holla familja e vajzës i përdorte për përgatitjen e rrobave të saj.

Edhe në krahinat e Tiranës, sidomos në Malësi, pala e dhëndrit paguante një sasi të hollash për zënien e vajzës.

Në Hasdushk (Rrogozhinë) dhe në Rostej (Durrës) familja e djalit i jepte palës së vajzës një sasi të hollash, shuma e të cilave caktohej nga i ati vajzës dhe shkuesi.

Duke zbritur në krahinat e Jugut kjo dukuri paraqitej e zbehtë ose nuk shfaqej fare. Në Korçë dhe në rrethinat e saj, në Ersekë, në Përmet, në disa zona të Gjirakastrës (Lunxhëri, Zagori, qytet), në Çamëri e në ndonjë vend tjetër kapari nuk përdorej. Ndërsa në Bërzeshtë (Librazhd) ky dukej shumë qartë. (Ka qenë zakon që, për të zënë një vajzë, babai i djalit ditën e nishaneve i jepte të atit të vajzës nëpërmjet shkuesit një sasi të hollash si kapar për zënien e saj).

Pra kjo dukuri ka qenë më e theksuar në zonat malore, ndërsa në zonat me fshatarë të vegjël dhe çifçinj pothuaj nuk shfaqej fare. Megjithatë, në një të kaluar më të largët, kjo ka qenë një dukuri për të gjithë shqiptarët. Këtu na e tregon e drejta e anës së vajzës për të kërkuar pajën nga ana e shtëpisë së djalit, gjë që shfaqej edhe në zonat jomalore. Por edhe atje ku nuk shfaqej kjo dukuri, të dyja palët bënin përgatitje për martesën dhe shpenzimet ishin të dyanshme. Në këto zona kishte marrë një zhvillim të madh shkëmbimi i nishaneve. Sigurisht, në mes shtresave dhe klasave të shoqërisë shqiptare të asaj kohe, duhet bërë dallimi: klasat e pasura paguanin më

shumë për nishanin. Por edhe në shtresat e mesme dhe, në një masë më të vogël, edhe në shtresat e varfra të popullsisë, nën ndikimin e drejtpërdrejtë të shtresave të pasura, shkëmbimi i nishaneve mori përhapje të madhe, duke u bërë një barrë e rëndë për ekonominë e shtëpisë.

Shkëmbimi i nishaneve, që praktikohej më shumë në jug të Shqipërisë dhe në qytete, mori një zhvillim të madh veçanërisht nga gjysma e dytë e shek. XIX dhe vazhdoi deri në prag të Çlirimit, kur tashmë Shqipëria kishte hyrë në rrugën e zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste. I theksuar ka qenë në qytetet e Korçës, të Shkodrës, të Gjirokastrës, të Tiranës, të Beratit, të Vlorës, etj. dhe në fshatrat rreth qyteteve të Jugut. Madje, në Korçë kjo kishte marrë formën e një gare midis familjeve të ndryshme. Ka të dhëna që flasin se në vitin 1826, burrat e komunitetit ortodoks të Varoshit të Korçës, morën vendim për të kufizuar shpenzimet e tepërta që bëheshin në lindjet, në fejesat, në martesat dhe në vdekjet. Kjo u bë shkak se këto shpenzime rëndonin ekonominë e familjeve dhe populli i thjeshtë dhe i varfëruar nuk u bën-te dot ballë atyre.

Por gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, shpenzimet që bëheshin për fejesat dhe martesat u zgjeruan sidomos në shtresat e borgjezisë së re tregtare dhe të zanatçinjve të qytetit, të cilët përpiqeshin të imitonin shtresën e borgjezisë tregtare të Selanikut e të Manastirit, me të cilët kishin kontakte. Veprimet e tyre ndikuan edhe në shtresat e tjera të qytetit.

Duke parë përmasat e mëdha që morën këto shpenzime, banorët e qytetit të Korçës iu drejtuan Këshillit të Pleqve të Komunitetit për t'i kufizuar. Kështu në vitin 1905, ai komitet hartoi kanonizmën e re, që kufizonte shpenzimet për lindjet, për fejesat, për martesat dhe për vdekjet. Lidhur me fejesat kufizoheshin shpenzimet në ceremoninë e shkëmbimit të nishaneve e të tjera.

Edhe në qytetin e Shkodrës zënia e vajzës bëhej me shpenzime të tepërta. Për këtë në vitin 1910 doli një rregullorë për kufizimin e tyre.

Por edhe pse u morën këto vendime e dolën këto rregu-

llore, që për kohën ishin pozitive, shpenzimet që bëheshin në këto raste jo vetëm nuk u kufizuan, por u shtuan edhe më shumë, veçanërisht në shtresat e pasura të qytetit. Nën ndikimin e qytetit kjo dukuri u shtri edhe në fshatrat dhe në disa qytete të tjera, si në Ersekë, në Leskovik, në Përmet etj., duke u bërë kështu një sëmundje që sa po vinte e po shtoej.

Ajo që rëndonte më shumë ekonominë e familjes, ishte pagesa që bënte pala e dhëndrit për përgatitjen e nuses. Kjo dukuri nuk paraqitej kudo njëjloj. Në zonat malore dhe, në ndonjë rast, edhe në zonat e ulëta, për përgatitjen e pajës së nuses paguante shtëpia e dhëndrit.

Në Malësi të Madhe, në fillim të shekullit XX, për zënieën e një vajze shuma e të hollave varej në radhë të parë nga gjendja ekonomike e familjes së vajzës, por edhe nga ajo e familjes së djalit. Kjo të le të kuptosh që familja e një vajze me gjendje të mirë ekonomike kërkonte një shumë të hollash më të madhe se një familje e mesme apo e varfër.

Pagesa bëhej në të holla, por ka pasur raste që të bëhej edhe në natyrë: në Malësi të Vogël, në vend të të hollave jepnin edhe kafshë dhe armë, në Malësi të Madhe vetëm armë.

Në Malësi të Gjakovës paguante vetëm familja e djalit. Veç të hollave ajo do t'i dërgonte familjes së vajzës edhe 50 kg lesh, 20 kg pambuk (penj), bojëra etj.

Në zonën e Nikaj-Merturit për teshat që përgatiste pala e vajzës paguante vetëm pala e djalit. Vlera arrinte deri në 5 000 lekë. Kjo vlerë paguhet gjysma në të holla dhe gjysma në natyrë.

Në krahinën e Lumës, në kohën e zënies së vajzës, i ati i djalit «priste edhe forcën» (këpucët), domethënë merrte vesh sa të holla duhej t'i dërgonte mikut. Miku i kthente ato përsëri në një formë tjetër, në rrobet e përgatitura për vajzën.

Në Pukë, në të kaluarën, pala e vajzës përgatiste gjithë rrobat e saj, por këto shpenzime i paguante pala e djalit.

Në Mat, gjashtë muaj para dasmës «pritet hesapi».

Shkuesi me prindin dhe disa veta nga farefisi i vajzës shkonin në shtëpinë e djalit dhe aty caktonin sa rroba duhej të bënte dhëndri për nusen, numrin e dyshekëve, të velenxave, të qilimave, si dhe orenditë e kuzhinës.

Në Lezhë dhe në malësi të saj, ana e vajzës i kërkonte anës së djalit të gjitha shpenzimet për rrobat e nuses. Të hollat paguheshin herë pas here gjatë periudhës së fejesës.

Zakonisht, në Mirditë të gjitha rrobat e nuses bëheshin me të hollat e dërguara nga pala e dhëndrit, që arrinin 7 000 deri në 8 000 lekë. Por, përveç këtyre, kur caktohej dita e dasmës, do të «priteshin këpucët». Ky ishte detyrimi i dytë që pala e dhëndrit kishte kundrejt asaj të nuses dhe që shkonte deri në 2 000 lekë.

Në Malësi të Krujës, në shumicën e rasteve nuk caktohej shuma e të hollave që duhej të paguante shtëpia e dhëndrit për përgatitjen e rrobave. Pavarësisht nga kjo, sipas traditës, dhëndri duhej të paguante 7 000 deri në 10 000 lekë. Kishte edhe raste që kjo shumë kalohej, duke e varfëruar së tepërmi shtëpinë e djalit. Kur nuk plotësohej shuma e të hollave, ajo kompensohej me bagëti, tokë etj.

«Për plaçkat e gocës, thuhet në një material nga Malësia e Tiranës, kryetari i familjes së djalit i jepte nënës së vajzës 40 okë lesh për rrobat e leshta. Pjesa tjetër e plaçkave, që nuk mund të përgatiteshin në fshat, si p.sh. dyshekët, jorganët, këpucët, enët e bakrit, si dhe arka e nuses bliheshin në qytet me të hollat e dhëndrit.

Në fshatrat e Durrësit, të Kavajës e të Rrogozhinës babai i djalit ishte i detyruar të paguante të gjitha shpenzimet që bënte ana e vajzës për përgatitjen e plaçkave.

Në disa zona të Librazhdit, në kohën e zënies së vajzës, babai i saj kërkonte të holla për përgatitjen e së bijës. Kishte dhe raste që, në vend të të hollave, të kërkonte 5-6 kokë bagëti të imëta, një ka ose një lopë.

Në Myzeqe babai i vajzës i kërkonte të atit të dhëndrit një shumë të hollash që quheshin para «argëllëku», velenxën dhe rrobat e nuses. Ngandonjëherë, në vend të argëllëkut në të holla, kërkoheshin gjë e gjallë, numri i të

cilave varej sipas gjendjes ekonomike të shtëpisë së djalit. Mund të jepeshin 20-40 krerë të imëta, një pendë qe ose buaj, një kafshë pune etj. Argëllëku merrej edhe në disa fshatra të Mallakastrës së Butë si në Kurjan, Mbërs etj. Në Kurjan, në vend të të hollave, kërkoheshin bagëti apo bereqet.

Në krahinën e Labërisë, sipas zakonit, shtëpia e dhëndrit paguante një shumë të konsiderueshme të hollash që nevojiteshin për përgatitjen e plaçkave, të cilat i punonte nusja. Në Kurvëlesh, në zonën e Salarisë, të Buzit dhe të Krahësit, me rastin e martesës, shtëpia e dhëndrit duhej të paguante «argëllëkun», rrobat e nuses, të cilat i zgjidhte babai i nuses dhe i paguante i ati i dhëndrit. Në Bregdetin e Himarës, familja e djalit paguante një sasi të hollash për përgatitjen e rrobave nga ana e nuses.

Në krahinë të tjera të Shqipërisë së Jugut dhe në qytetet, shtëpia e dhëndrit nuk kishte ndonjë detyrim shtrëngues për përgatitjen e plaçkave të nuses. Ato i bënin së bashku të dyja palët. Madje, në këto zona familja e vajzës kontribuonte më shumë, ndërsa në Çamëri, të gjitha rrobat e nuses i përgatiste i ati i saj.

Zakoni që pajën ta përgatisnin të dyja palët kishte përhapje më të madhe. Veç qyteteve kryesore, ai përfshinte edhe pjesën më të madhe të fshatrave të Jugut.

Në qytetet kryesore të Shqipërisë dhëndri i bënte nuses veshjen e plotë, sende tualeti, si dhe disa peshqeshe për njerëzit e saj. Ndërsa nusja, përgatiste teshat për vete dhe të gjitha dhuratat për njerëzit e burrit. Veç këtyre, i ati i vajzës i jepte së bijës edhe enë e orendi.

Kjo dukuri filloi të marrë përhapje gjithnjë e më të madhe edhe në fshatrat. Familja e djalit përgatiste rrobat e fjetjes (dyshekë, jorganë dhe jastëkë), si dhe një ose dy veshje të plota për nusen. Nusja, nga ana e saj, bënte veshjen për vete dhe darovën për njerëzit e burrit.

Në krahinën e Çamërisë, në të gjitha fshatrat e saj, shumicën e pajës e përgatiste ana e vajzës. Djali çonte vetëm dhuratat për nusen e të afërmit e saj. Madhësia e pajës së vajzës varej nga gjendja ekonomike e familjes. Megjithatë, edhe ata që ishin hollë (të varfër) përpiqej-

shin ta bënin sa më të plotë, pavarësisht se dëmtonin ekonominë e shtëpisë.

Në disa qytete, si në Shkodër, Korçë, Ersekë, Leskovik, Përmet përveç pajës që përgatiste vajza, i ati i jepte edhe prikë, një pjesë të pasurisë së familjes (e shprehur kjo në pasuri të patundshme dhe në të holla). Ndonëse prika si institucion është e vjetër, ajo mori zhvillim të madh në kohën e feudalizmit, kur familjet e mëdha mbretërore dhe princërore, me qëllim që të lidhnin aleancë në mes shteteve dhe principatave të ndryshme, bënëin kru-shqi me njëra-tjetrën, duke u dhënë vajzave krahina të tëra, që kalonin në pronësinë e burrave të tyre. Dokumente të ndryshme flasin për aleanca të tilla edhe në vendin tonë. Në shek. XIII (në vitin 1258) nevoja për aleatë e shtyu Mihalin II të Epirit të lidhte aleancë me Manfred Hohenshtaufen, princin e Tarentit, duke i dhënë për grua bijën e vet Helenën dhe në formë prike një varg qytetesh të Shqipërisë, si: Durrësin, Vlorën, Kaninën, Beratin etj¹.

Kjo traditë vazhdoi të përdoret edhe nga dyert e mëdha feudale arbëreshe në shekujt e mëvonshëm. Vajzat e familjeve të mëdha feudale, kur martoheshin, merrnin prikë të madhe toke. Gjon Muzaka në testamentin e tij thotë se Vlora dhe Kanina kanë qenë të Muzakëve dhe i ishin dhënë prikë të mbesës Regina që u martua me despotin e Serbisë². Dhënia e prikës vazhdoi edhe nga familjet e pashallarëve dhe të agallarëve. Por, më e theksuar kjo u bë në shek. XIX në qytetin e Korçës, veçanërisht në shtresat e borgjezisë së re, të cilat, duke shfrytëzuar

1 *Acta et Diplomata*, I, 245, 1258, në «Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë», vëll. 2, f. 66, 99. Dokumenti midis të tjerash thotë: «Mihali II, despot i Epirit, bijës së vet Helenës që do të bashkohet në martesë me Manfredin, princin e Tarentit, i jep si prikë përveç ishullit të Korfuzit dhe kështjellave të Sopotit (Subotum) dhe të Butrintit edhe disa kështjella e vende në Arbëri: Durrësin Vlorën, Kaninën, Beratin, malet e Spinariçës.

2 Ch. — Hopf. *Chroniques greko-romanes*, Berlin 1873, f. 290-291.

dhënien e prikës, donin dhe kishin mundësi t'u siguronin vajzave një jetë bashkëshortore sa më të mirë, duke u dhënë burra nga shtresat më të larta të shoqërisë. Prika mori një përhapje të gjerë edhe në shtresat e mesme të popullsisë dhe u shtri edhe në zonat fshatare të elementëve ortodoksë të Shqipërisë së Jugut, duke u bërë kështu një barrë e rëndë për ekonominë e familjes së vajzës. Në popullsinë kristiane shqiptare të Çamërisë (Gumenicë, Grikoher, Kushovicë, Peshtan, Kastriçë, Ledhëzë etj.) përveç pajës, vajzës i jepej si prikë edhe ndonjë dyqan, vreshtë, ulli, tokë buke apo edhe të holla. Kjo ka qenë karakteristike për shtresat në gjendje të mirë ekonomike.

Në të tria rastet, kur shpenzimet për përgatitjen e rrobave të nuses dhe, në përgjithësi, për dasmën binin vetëm mbi shtëpinë e djalit kur ato bëheshin nga të dyja palët dhe kur barra me e rëndë për përgatitjen e pajës së nuses i binte palës së vajzës (që shprehen edhe në dhënien e prikës), ato ishin një barrë e rëndë në ekonominë e familjes. Prandaj, për të siguruar shumën e të hollave që nevojitej për pajën dhe, në përgjithësi, për shpenzimet e dasmës, i zoti i shtëpisë merrte masa të ndryshme, shiste tokë apo kullotë, bagëti të imëta apo të trasha dhe, jo rrallë, çonte si punëtor një ose dy djem të shtëpisë, për të punuar në familjet e pasura, në qytete, madje edhe në kurbet, siç ndodhte në krahinat e jugut, derisa të siguroheshin të ardhurat për shpenzimet e dasmës. Kjo plagë e rëndë e shoqërisë shqiptare të Paraçlirimit, nën shtytjen e masave popullore, u kufizua disi. Megjithatë, deri në prag të Çlirimit, ajo ishte problem dhe mund të zhdukej vetëm me përmbysjen e marrëdhënieve të vjetra në prodhim.

Pagesa që shtëpia e dhëndrit i bënte asaj të nuses, paja dhe prika, janë institucione të ndryshme, të pavarura nga njëri-tjetri. Secili ka linjën e vet të zhvillimit.

Në rastin e parë, domethënë kur pala e dhëndrit do të jepte një shpërblim për zënieën e vajzës (shenja, dhënia e materialeve të ndryshme apo dërgimi i të hollave që shërbenin për përgatitjen e rrobave të nuses, dhuratat e

shumta, që familja e dhëndrit ishte e detyruar t'u bënte njerëzve të nuses etj.), tregojnë për mbeturina të blerjes së grave.

Lindja e institucionit të blerjes së grave i takon etapës së parë të zhvillimit të fisit, matriarkatit. Sipas Engelsit, me lindjen e martesës me çiftë fillon rrëmbimi dhe blerja e grave.

Por edhe më vonë me zëvendësimin e matriarkatit me patriarkatin dhe me lindjen e familjes patriarkale, martesë me të blerë mori një zhvillim akoma më të madh. Këtë e tregon edhe interesimi i gjithë anëtarëve të komunitetit familjarë të cilët ndihmonin për grumbullimin e shpërblimit që do t'i jepej familjes së gruas. Pra, martesë me të blerë është karakteristike e marrëdhënieve patriarkale dhe është e lidhur me familjen e madhe patriarkale, pa varësisht se lindja e saj i përket periudhës së matriarkatit. Martesë me blerje, siç duket, rritej e forcohej së bashku me rritjen e prirjeve patriarkale, nën ndikimin e marrëdhënieve të reja shoqërore, dhe arriti zhvillimin e plotë me lulëzimin e marrëdhënieve patriarkale.

Me shpërbërjen e familjes së madhe patriarkale dhe me lindjen e familjes së vogël, zhduket edhe blerja e gruas, mbeten vetëm mbeturinat e saj. Por zhdukja e këtij institucioni nuk tregon se u ndryshua baza e martesës. Martesë nuk e humbi karakterin e saj si një marrëveshje ekonomike. Me lindjen e familjeve të vogla, kur gruaja i humbi të gjitha të drejtat e saj të trashëguara më parë, dhe kur rritej rëndësia ekonomike e punës së burrit (e cila zinte degët kryesore të aktivitetit prodhues), puna e gruas në shtëpi gjithnjë e më shumë zinte vend më të madh. Kjo përcaktonte edhe fatin shoqëror të saj, të cilin e plotësonte edhe martesë me të blerë. Tani familja-ekonomi e shikonte çdo pjesëtar si forcë pune, prandaj, duke dhënë vajzën të djali, familja e saj kërkonte kompensimin përkatës. Në fillim kjo shprehej me dhuratat që familja e dhëndrit ia çonte familjes së nuses, në radhë të parë të jaitit dhe s'ëmës, pastaj të vëllezërve, dajës së nuses dhe të afërmeve të tjerë. Me zhvillimin e shkëmbimit tregtar,

vlera e punës së gruas, veç objekteve në natyrë, mori shprehjen e saj edhe në të holla. Kështu lindi «çmimi i gruas».

Është ky «çmimi i gruas» që përmendet në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe në materiale të tjera. Gati në të gjitha krahinat dhe në zonat e tjera të vendit tonë, burri, në raste të veçanta, e quante gruan si të blerë.

Madje dhe vetë gruaja ishte e ndërgjegjshme se ishte «shitur» te i shoqi dhe kjo shfaqej në sundimin despotik të burrit ndaj gruas, e cila i bindej verbërisht.

Por, pavarësisht nga këto, pas gjysmës së dytë të shekullit XIX deri në prag të Çlirimit nuk mund të flasim për martesë me të blerë. Ajo ka qenë kapërcyer prej kohësh nga populli ynë, duke na lënë si trashëgim disa nga mbeturinat e saj, të cilat ishin më të zhvilluara në zonat e thella malore.

Paja dhe prika si institucione, kanë lindur në periudhën e shturjes së familjes patriarkale, me ndarjen e saj në familje të vogla. Vajza që marotohej, duke u larguar nga ekonomia e familjes, merrte njëfarë pjese nga pasuria kolektive e saj. Kjo pjesë formonte pasurinë personale të gruas së martuar të veçantë nga pasuria e shtëpisë së burrit, pasuri që e zotëronte në mënyrë të lirë dhe mbi të cilën nuk mund të vinte dorë askush, bile as burri. Kjo pasuri, që deri në njëfarë shkalle përbente bazën e pavarësisë së gruas, në popullin tonë quhej salem në veri, pekuli në jug.

Me thellimin e diferencimit klasor dhe me rritjen e forcave prodhuese, paja dhe prika morën një zhvillim të madh. Që në kohën e vjetër, klasat dhe shtresat e pasura, për të mos copëzuar ekonominë e përbashkët të familjes, si kompensim të pjesës së vajzës në këtë ekonomi, filluan të jepnin një shumë të konsiderueshme të hollash. Vajza që merrte prikë nuk kishte më të drejtë trashëgimie në familje. Duke filluar nga shek. V e këtej, në shumë popuj asnjë martesë nuk bëhej pa pajë e pa prikë. Në këtë periudhë u zhvillua paja me plaçka; veshmbathje, enë e orendi të ndryshme etj.

Edhe në kohën e feudalizmit u ruajt mënyra e lidhjes

së martesës në bazë të së cilës qëndronte interesi ekonomik. Madje, në feudalizëm, familjet e mëdha, për të forcuar pozitën e tyre dhe për të krijuar aleanca të ndryshme, i martonin vajzat e tyre me familje të forta, duke u dhënë një prikë të majme (e shprehur kjo në pasuri të patundshme që, nganjëherë, arrinte në krahina të tëra).

Paja dhe prika morën një zhvillim akoma më të madh në kapitalizëm. Duke shndërruar çdo gjë në mall që shitet e blihet, prodhimi kapitalist i zhduku pothuaj të gjitha marrëdhëniet e lashta, të trashëguara nga e kaluara. Martesa me llogari, martesa për përfitim material u bë lloji kryesor i martesës, që praktikohet në radhët e borgjezisë. Borgjezia shtron përpara martesës në radhë të parë qëllime ekonomike, e shikon atë jo si bashkim njerëzish, por si bashkim kapitalesh, si një mjet për të grumbulluar kapitale të reja. Legjislacioni në shumë vende kapitaliste i jep të drejtë burrit të administrojë pasurinë e familjes, duke përfshirë edhe pasurinë (prikën apo pajën) e gruas.

Pra, zakoni i marrjes së pajës, pavarësisht nga origjina e tij e lashtë, e ka burimin në pronësinë private mbi mjetet e prodhimit dhe, si pasojë, ai është një zakon i trashëguar nga shoqëria me klasa antagonistë.

Ky zakon, i cili e ka burimin në trashëgiminë, përkrahshmerinë e pronës së klasave të privilegjuara (sepse vetëm ato kanë qenë në gjendje t'u jepnin fëmijëve pajë dhe prikë të madhe) u bë një zakon masiv. Paja dhe prika ishin baza, me anën e të cilave mateshin vlerat e të rejave që do të martoheshin.

Edhe në popullin tonë paja dhe prika kishin marrë një përhapje relativisht të madhe, por madhësia e tyre varej nga gjendja ekonomike e familjeve. Në klasat e pasura ato kishin përmasa më të mëdha. Megjithatë, nën ndikimin e këtyre klasave, ato morën një përhapje të dukshme edhe në shtresat e tjera të popullsisë, duke u bërë një plagë e rëndë për shoqërinë shqiptare të Paraqlirimit.

Ceremoniali i dasmës

Dasma, që bëhet në shtëpinë e nuses e të dhëndrit, i jep fund ciklit të martesës. Si një proces që ka jetuar prej kohëve më të para, me ritet dhe me ceremonitë e shumta e të larmishme, ajo sjell elementë me interes dhe me prejardhje të ndryshme etnografike. Këtu hyjnë ritet dhe zakonet e njohura të përgatitjes së dasmës në shtëpinë e nuses e të dhëndrit, ritet e ndarjes së saj nga gjinia dhe nga shtëpia e babait, të aktit të përcjelljes së nuses, të pritjes së saj në shtëpinë e dhëndrit dhe të shumë ceremonive të tjera, që bëheshin me këtë rast. Në ceremonialin e dasmës shqiptare dallohen gjurmë zakonesh e rritesh të vjetra, mbeturina të sistemeve ekonomiko-shoqërore të epokave të ndryshme historike dhe të kulturave të tyre, ndikime të zakoneve të huaja etj. Këto shtresime historiko-etnografike i japin ceremonialit të dasmës një karakter të lashtë dhe e paraqesin atë me një ritual mjaft të pasur dhe me interes. Duke qenë produkt i shumë shënkujve e i shumë brezave, ceremoniali i dasmës ka pësuar një ndikim të fuqishëm patriarkal e klasor, në të cilin pleksej edhe feja.

Sigurisht, shumë zakone e kanë humbur kuptimin fillestar të tyre dhe përdoren më shumë si lodra apo ceremoni zbavitëse. Por, në të kaluarën në dasma shfaqeshin edhe praktika e veprime që merrnin nëpër këmbë dhe ulnin dinjitetin e gruas. Të gjitha këto kishin gjetur një përkrahje të madhe në klasat e pasura reaksionare, në fenë dhe në ideologjinë e saj, të cilat në çdo kohë dhe vazhdimisht, kanë përligjur shtypjen e gruas nga burri dhe e kanë quajtur këtë si një krijesë pa të drejta dhe që, me çdo kusht, duhej t'i përulej burrit.

Përgatitja e dasmës

Caktimi i ditës për martesë te populli ynë bëhej menjëherë pas përfundimit të përgatitjeve për dasmë.

Këtë e caktonin prindërit e vajzës sipas kërkesës së palës së djalit. Shpeshherë në caktimin e ditës së martesës merrete pjesë edhe shkuesi, i cili në disa krahina luante rolin kryesor.

Prerja e ditës së dasmës, sipas krahinave të ndryshme, emërohej: «orok», «prerja e ditës», «ndarja e ditës», «premjia e vades», «prerja e fjalës», etj. «Prerja e ditës» do të thoshte caktimi i kohës kur do të bëhej dasma, kur do të niseshin krushqit për të marrë nusen. Dita e prerë në shumicën e krahinave të Shqipërisë nuk mund të ndryshonte. Krushqit niseshin atë ditë për të marrë nusen. Shtyrja ndilte tersllëk dhe jo lumturi. Nga ana tjetër, përgatitjet e dasmës ishin bërë, kështu që për disa krahina të veçanta, aty ku e drejta zakonore kishte ndikim të madh, as rastet e vdekjes në njërin nga të dyja familjet nuk e shtynin martesën. Tregohen raste që nga njëra dhomë ka dalë i vdekuri nga tjetra është nisur nusja për në shtëpinë e dhëndrit. Madje, edhe kur nusja apo dhëndri sëmureshin, dita nuk shtyhej.

Në vitin 1932, në katundin Kacinar (Mirditë) ka ndodhur një ngjarje tragjike:

Një fshatar nga Kacinari do të jepte vajzën në Livadhas të Oroshit. Dita ishte prerë, por vajza dy javë para se të bëhej dasma u sëmur rëndë. I ati i vajzës kërkoi që të shtyhej dasma, por miku (krushku) nuk dëgjoi dhe i tha: «Në bazë të zakonit që ka Mir-dita, oroku i nuses nuk shtyhet dhe ditën e caktueme unë do të nis krushqit. O gjallë, o deké, due nusen».

Babai i vajzës, duke u gjetur para një situatë të tillë nuk kishte nga t'ia mbante. Kështu, ditën e caktuar erdhën krushqit. Vajza ishte duke vdekur. Në të zbardhur të ditës dolën krushqit; doli dhe nusja që e mbanin nga krahët. Kur u përshëndet me të jatën, i tha: «Nuk besoj se shifena ma». Dhe, me të vërtetë, në gjysmën e rrugës vajza vdiq. Krushku i parë tha: «Kjoftë mallkue zakoni i Mirditës, se nuk qitet nusja tuj deké». Dasma u kthye në mort. Nusja u va-

ros në shtëpi të burrit. Populli që nuk pajtohej me këto zakone të egra, këndoi:

Na u mblodh Shtufi e bajnë kuvend,

Si me ba ket punë pa mend

«Cucën të ligjë, tue dekë me qitë

Thue në vjet s'ka tjetër ditë».

Mbasi pritej dita, vajza mbyllej në shtëpi, duke mënjanuar takimet me njerëzit e shtëpisë dhe me të afërmit e tjerë. Gjatë kësaj kohe, e ndihmuar edhe nga gratë e vajzat e farefisit, ajo i jepte fund përgatitjeve të pajës.

Në vendin tonë, sikurse në shumë vende të tjera, martesat bëheshin në vjeshtë, kur merrnin fund punët bujqësore dhe hambarët ishin plot. Nuk mungonin edhe rastet, po këto shumë të rralla, kur nusja merrej në stinën e pranverës, atëherë kur punët bujqësore ishin në kulmin e tyre dhe duheshin krahe pune.

Për marrjen e nuses caktohej një ditë jave që sipas besimeve popullore sillte mbarësi dhe lumturi. Por, meqenëse në krahina të ndryshme për ditët e javës ruanin pikëpamje të ndryshme, dita e dasmës nuk ishte e njëjtë për të gjitha krahinat. Në shumicën dërrmuese caktohej e djela ose e enjtja, si ditë më të mbara. Në disa krahina, ka qenë zakon që, po të bëhej fejesa të dielën, martesë duhej të bëhej të enjten dhe anasjelltas. Dita e martesës caktohej në kohën e hënës së plotë. Hëna e re dhe hëna e plotë ka qenë vështruar edhe nga popuj të tjerë të Evropës si të dobishme e me fat.

Prerja e ditës shoqërohej me përfundimin e përgatitjeve të rrobeve të nuses, me përgatitjen e pajës, me marrjen e masave për thirrjen e krushqve, për sigurimin e ushqimeve etj. Këto ishin përgatitje të mëdha dhe, përveç anëtarëve të familjes, mobilizohej edhe farefisi i djalit dhe i vajzës, si dhe të tjerë nga mëhalla. Në këto raste vihej re një solidaritet dhe ndihmë e madhe shoqërore.

Dasma zakonisht fillonte një javë, pesë ose tri ditë përpara marrjes së nuses. Që ditët e para të fillimit të das-

mës bëheshin vizita nga të afërmit, miqtë dhe fqinjët. Gjatë gjithë javës së nuses gratë e vajzat e farefisit ishin në këmbë, grumbullonin enët e orenditë e nevojshme, qëronin orizin, zinin brumin, përgatitnin bukët, gjellët, ëmëlsirat etj.

Pas përgatitjeve të dasmës, i zoti i shtëpisë thërriste në dasëm të afërmit dhe miqtë e familjes. Ata që caktoheshin për të ftuar dasmorët thirrreshin me emra të ndryshëm: *thirrës, grishës, lajmës, lajmëtar, ftonjës, i porositur, dërgues*. Këta, në të shumtën duhet të ishin djem, si thirrës mund të dërgoheshin edhe burra. Madje, ka pasur raste që këtë detyrë ta kryenin vajza ose gra.

Thirrësit shkonin dy-tri ditë para fillimit të dasmës, sidomos në familjet e fshatit. Por, kur caktoheshin si krushq, nganjëherë ata thirrreshin edhe një ose dy javë para fillimit të dasmës, në mënyrë që të kishin kohë për t'u përgatitur për dasëm. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, «katër javë para dasme i ati i dhëndrit a i zoti i shpis do të shkojë vetë në krye me thirrë krushqit»¹.

Thirrësit visheshin me rrobat më të mira dhe niseshin shtëpi më shtëpi për të njoftuar ditën e dasmës dhe personat që duhej të vinin atë ditë. Thirrësit shkonin veç njëri nga tjetri, por ka pasur edhe raste që mblidheshin dy-tre vetë dhe bënin ftesat duke kaluar shtëpi më shtëpi. Në Kolonjë, që ditën e premtë në mëngjes, dy ose tre djem të afërm të dhëndrit, me një torbë të kuqe me xhufka, që ishte torba e dasmës, shkonin e ftonin miqësinë me nga një kulaç të vogël. Kjo ftesë përsëritej edhe ditën e shtunë, kur fëmijët merrnin edhe një plluskë me verë, të stolitur me lule dhe, duke hyrë në derë, ua jepnin miqve të pinin verë. Në këtë mënyrë bëhej ftesa për dasmë. I njëjti zakon ishte edhe në zonën e Devollit. Në Leskovik, dy ditë para dasmës, të premtën, prindërit e dhëndrit ftonin farefisin e miqtë e po atij fshati me anë kuleçësh të vegjël, që ndaheshin nga një djalë i vogël.

Edhe në fshatin Zym (Kosovë), grishtari merrte me

¹ KLD, f. 16.

vete një strajcë, në të cilën vinte çutrën (një lloj matare druri ose dheu e zbukuruar më së miri) ku hidhej verë ose raki. Çutra i jepej së pari të zotit të shtëpisë dhe më radhë gjithë anëtarëve të familjes që ftonte grishtari. Duke pirë pak verë, ata uronin që gëzimi të jetë i mbarë dhe i zoti i dasmës «Prit'e martoftë edhe të tjerë!»

Në disa zona ftesa simbolike i bëhej edhe nuses, edhe dhëndrit. Në Devoll, të premtën paradreke dhëndri me disa prej farefisit merrnin një bukë e shkonin të ftonin nusen në dasmë. Sapo hynin brenda, delnin krushqit e i prisnin. Ata, duke u dhënë bukën, u thoshnin: «Të djelën kemi dasmën e N. Të na urdhëroni!». Nusja, që sipas zakonit duhej të vishej me rroba të vjetra e të palara, fshihet pas qosheve që të mos e gjente dhëndri. Po atë ditë shkonin me një bukë njerëzit e nuses për të ftuar dhëndrin. Sapo hynin në shtëpinë e tij, pyesnin: «Ku është. . .?». Të pranishmit përgjigjeshin: «S'është këtu. Ka vajtur me dhen». «Mirëpo ne duam ta shohim, se pasnesër, të die-lën, N. ka dasmën e vajzës. . . dhe erdhëm ta ftojme». Në çast hynte dhëndri i veshur si bari, me kërrabë në dorë. «Ç'janë gjithë këta njerëz? Çka ngjarë? Ç'bëhet kështu në shtëpinë tonë?» Një nga shokët e tij i përgjigjej: «E more vesh? Marton N. vajzën të djelën dhe kanë ardhur të të ftojnë në dasmë». Atëherë krushqit i jepnin dhëndrit bukën, dhe ky i gëzuar u thoshte: «Oh, ju faleminderit që më kujtuat edhe mua, një bari! T'u trashëgohet dhe t'u plaket vajza!»

Zakonisht në dasmë thirreshin të gjithë të afërmit nga gjaku dhe gjinia, si dhe miq e shokë të familjes që bënte dosmën.

Dalloheshin tri kategori të ftuarish: të ftuar familjarisht, të ftuar vetë i dytë (burrë e grua) dhe të ftuar të veçantë.

Në popullin tonë, veçanërisht në krahinat e Veriut, në Malësi të Tiranës, në Skrapar, në Labëri etj. njerëzit e afërt të familjes nuk thirreshin në dasmë. E gjithë vëllazëria e atij që bënte dasmë mblidhej në shtëpinë e tij dhe merrte përsipër drejtimin e dasmës. Të thërrisje një

të vëllazërisë në dasmë ishte fyerje për të, vështrohej si njeri i huaj. Vëllazëria vinte vetë, ishin të shtëpisë.

Ditët e para të dasmës kalonin pa ndonjë ceremoni të veçantë, megjithatë disa ditë ishin të caktuara për punë të veçanta.

Dita e druve quhej dita kur shkonin për bërjen e druve të dasmës. Në disa krahina kjo quhej dita e karthijave ose karthijat e dasmës.

Dita e druve nuk ishte e caktuar, por shumicën e rasteve ishte e enjtja, kur nusja merrej të djelën. Edhe në ditë të tjera mund të bënin dru si të hënën, të mërkurën, të premtën dhe të djelën.

Në disa krahina familja që bënte dasmën dërgonte disa ditë përpara marrjes së nuses ndonjë njeri në familjet e fshatit dhe i ftonte për dru me gjithë kafshë. Në disa krahina të tjera bërja e druve shoqërohej edhe me ndonjë ceremoni të vogël. Në Labëri dy ditë para dasmës mblihdeshin në shtëpi të dhëndrit gra, vajza e djem dhe shkonin në pyll për dru. Në pyll mblihdnin lule dhe gjethe të njoma dhe me to stolisnin dy drunj, njëri si dhëndër e tjetri si nuse. Pastaj ngarkonin kafshët dhe, me dy drutë e stolisur përpara, shkonin duke kënduar në shtëpi të dhëndrit. Ndërsa në Përmet që ditën e hënë që fillonte dasma prindërit e dhëndrit ftonin nuset dhe vajzat e fshatit për karthijat e dasmës. Këto mblihdeshin në shtëpi të dhëndrit, ku zbrazej një pushkë që lajmëronte orën e nisjes për në pyll. Me tërkuza e sëpata me vete, me dhëndrin në krye. Vonë, kur ktheheshin në shtëpi, vinin mbi portë disa ashkla dhe një rrobë të kuqe, për t'u njohur nga larg shtëpia që bënte dasmën.

Në Zagori, në kalin e nuses vendosnin një kukull të zbukuruar. Kukullën (e disa herë edhe një dru lisi të zbukuruar si dhëndër) e vendosnin pastaj mbi çati. Në Kolonjë drutë bëheshin gati dy ose tri javë përpara martesës. Djemtë e fshatit (sidomos shokët e dhëndrit) mblihdeshin dhe, duke kënduar, shkonin në mal, ku bënin drutë. Të nesërmen grumbullonin gjithë kafshët e fshatit dhe i ngarkonin. Në shtëpinë e dhëndrit me këtë rast bëhej një gosti.

Në disa zona në jug të Shqipërisë kaq e përhapur ka qenë dita e druve saqë i zoti i shtëpisë nuk bënte thirrje, por vetë fshatarët e bënin këtë gjë. Në Mursi, që të enjten në mëngjes 15-30 gra shkonin në pyll për dru me iniciativën e tyre. Në mbrëmje, me të perënduar dielli, u shtrohej një darkë. Për dru shkonin burra e gra, djem e vajza, duke i lidhur barrët me litarë të kuq dhe të bardhë. Në shumicën e rasteve për dru shkonin gratë dhe vajzat dhe, më rrallë, burrat. Gratë në të gjitha krahinat e vendit tonë ngarkoheshin me dru, ndërsa burrat, edhe kur shkonin i ngarkonin në kafshë ose në qerre. Dita e druve për shumë krahina ishte edhe caku i fillimit të dasmës.

Dita e brumit apo zënia e brumit, dita e çyrekëve, kulaçi i nuses etj. lidhen me përgatitjen e elementit kryesor të ushqimit, me bukët rituale. Ndonëse te populli ynë ceremonia e zënies së brumit ka nuancat e saj nga njëra krahinë në tjetrën, e rëndësishme është se ky rit njihet në mbarë shqiptarët dhe se ka qenë një nga më të rëndësishmit e dasmës shqiptare.

Në Shqipëri brumi zihej tri ose katër ditë para se të vinte nusja, të mërkurën ose të enjten (nëse dasma do të bëhej të djelën). Por mund të zihej edhe në ditë të tjera, të martën, të premten apo të shtunën.

Sitja e miellit dhe zënia e brumit zakonisht bëhet nga vajza të reja me prindër gjallë, të cilat mblidheshin në shtëpinë e djalit e të vajzës dhe zinin brumin duke kënduar.

Në fshatin Dobratin të Llapit (Kosovë) kulaçin fillonte ta sitte një djalë, që vinte një qeleshe në kokë. Mandej vazhdonin kulaçtorët, derisa sitej një sitë miell.

Në Zym të Hasit (Kosovë) të enjten pas mesnate, mblidheshin vajzat e lagjes për të marrë pjesë në ceremoninë e të gatuarit të kulaçit. Kulaçin e gatuate një vajzë e fejuar që i kishte prindërit gjallë, kishte dhe vëllezër. Në këtë kohë, i zoti i shtëpisë qëllonte me pushkë si shenjë e fillimit të dasmës. Vajza që gatuate kulaçin nuk fliste. Besohej se kështu nusja do të ishte e pafjalë, e urtë dhe e dëgjueshme.

Në Malësi të Gjakovës kulaçin e gatuate një grua me fat të mbarë, duke e zënë brumin me qumësht. Këtë grua e ndihmonte një djalë me prindër gjallë dhe me shumë vëllezër.

Në Lumë, ditën e mërkurë, pa u gdhirë mirë, njerëzit e familjes e të afërmit çoheshin dhe merrnin pjesë në zënien e brumit të kulaçit të nuses. Brumin e përziente me tytën e pushkës një djalë me nënë e me baba. Me këtë pushkë djali shtinte një herë. Krisma shënonte fillimin e dasmës. Pas kësaj vinin njerëzit për të uruar.

Në Skrapar, ditën e brumit mblihdeshin vajzat e fisit e të afërmit dhe fillonin gatimin e bukës, ndërsa djemtë thernin bagëtitë. Ardhja e brumit lajmërohej me të shtëna pushke. Edhe në koloninë arbreshe të San Nikolla del Altos brumin e nuses e përgatit një vajzë «me nënë e me baba».

Brumi zakonisht zihej me miell gruri por kishte edhe zona që e zinin me qiqra. Në Myzeqe, ditën që do të zihej brumi vajza dhe gra të reja shtypnin qiqrat për të zënë bukët e dasmës. Gjatë kësaj kohe, një djalë e një vajzë dërgoheshin për të mbushur ujë në tri burime ose në tri puse. Rrugës nuk duhej të flisin dhe as të kthenin kokën prapa. Të dy këta fëmijë e zinin brumin në dy enë, njëra e vajzës dhe tjetra e djalit.

Edhe në Bilisht zjenin dy poçe me qiqra: një për dhëndrin e tjetrin për nusen. Cila poçe vinte më parë ajo do të qe më e mbarë. Me qiqrat dhe me miellin gatuanin po atë ditë kuleçë të vegjël që i shpërndanin nëpër njerëzit e fshatit e, siç e pamë edhe më lart, me këta bëheshin ftesat për në dasmë.

Në Përmet, të mërkurën në mbrëmje, ftohej farefisi e miqësia për zënien e brumit. Të ftuarit vinin me kanistra të mbushura me pemë. Njëra nga gratë e shtëpisë nxirrte një havan tunxhi me pak qiqra dhe ua kalonte të gjithë të ftuarve. Burrat e preknin me dorë, ndërsa gratë i shtypnin qiqrat deri në fund dhe miellin e përvëlonin me ujë të valuar. Zakone të tilla të ngjashme ekzistonin edhe në krahinat e tjera të Shqipërisë.

Zënia e brumit është një rit mjaft i lashtë. Ritet e

ndryshme që bëheshin me këtë rast si: gatimi i brumit pa folur, vajtja në tri çezma për të mbushur ujë, përzierja e brumit me tytën e pushkës, futja në brumë e një freri kali (Myzeqe e Vogël) apo zakoni që në magje të lihej një unazë floriri, të cilën duhej ta gjente një djalë i vogël dhe ta zinte me dhëmbë (Gjirokastër) e të tjera, ndonëse në periudhën për të cilën flasim kishin më shumë karakter argëtues, në kohë më të hershme ato bëheshin për ruajtjen e çiftit të ri nga magjitë e ndryshme dhe nga respekti që njerëzit kishin për bukën, ushqimin e tyre kryesor.

Dita e rrobave të nuses është ajo ditë, kur nuses i çonin peshqeshet e dhëndrit apo edhe plaçkat (pajën). Kjo ditë quhej me emra të ndryshëm si dita e kutijave, dita e arkave, dita e armeganeve etj. Zakonisht, tek të gjithë shqiptarët, kjo ishte dita e enjte ose e djela, sipas ditës së marrjes së nuses. Por ka pasur edhe raste që të ishte një ditë tjetër jave: e hëna e mërkura ose e shtuna.

Në Malësi të Gjakovës, pasi të ishte caktuar dita e dasmës, familja e djalit pesë ose gjashtë ditë përpara dërgonte në shtëpinë e vajzës arkat me rrobat e nuses dhe kënanë. Në Lumë, rrobat që i bënte dhëndri nuses i dërgoheshin asaj pesë, tri ose një ditë para dasmës.

Në Shkodër, *dhuntia* (paja) çohet në shtëpinë e vajzës nga një burrë. Vajza e fejuar rrinte rënë në qoshen e një dhome, e mbuluar dhe e veçuar prej vajzave të tjera të shtëpisë. Posa vinte dhuntia djemtë dhe gratë që e prisnin, e merrnin dhe ia hidhnin vajzës në shpinë duke bërë shaka dhe duke e ngacmuar me fjalë. Ndërsa në pjesën e ish-fesë katolike dhuntia çohet dhjetë ditë para dasmës, të enjten, ndërsa më vonë të shtunën para dasmës.

Në Malësi të Tiranës, dy-tri ditë përpara se të merrej nusja dërgonin rrobat e nuses, të cilat i bënte gati një burrë e një grua nga trugu i familjes së dhëndrit. Ndërsa në qytetin e Elbasanit dy ditë para se të merrej nusja çohet kënaja dhe plaçkat e nuses.

Në Përmet, një javë para se të fillohet dasma, mblihdeshin në shtëpinë e dhëndrit nuset dhe vajzat e lagjes

dhe bënin gati kanistrën e nuses, Kjo ditë quhej e «enjtja e luleve». Nuses i çonin peshtafin e tualetit, çadrën, këpucët, pemë, ëmbëlsira si dhe të varturat, zakonisht një dupje ari me zinxhir që ia venin nuses në qafë. Kanistra e luleve nuk kthehej bosh nga pala e nuses, por mbushej me fruta të ndryshme. Ata që çonin kanistrat quheshin vlesë dhe numri i tyre duhej të ishte tek. Priteshin me nderime në shtëpinë e nuses dhe pastaj pyeteshin përse ishin munduar që kishin ardhur. Duke fshehur qëllimin e vizitës, ata përgjigjeshin se u kishte ikur një thëllëzë e kishte hyrë në këtë shtëpi, prandaj kishin ardhur për ta zënë. Ardhja dhe ikja e vlesëve shoqërohej me të shtëna pushkësh.

Në Çamëri dita e dërgimit të dhuratave të nuses quhej dita e armeganeve. Në këtë ditë, pala e djalit i dërgonte nuses armeganet: kënanë, disa sende për të ngrënë (arra bajame, lajthia, fiq të thatë, llokume, karamele etj.). Së bashku me armeganet dërgoheshin edhe plaçkat e dhëndrit për nusen.

Përgjithësisht, në të gjitha krahinat dhuratat dhe plaçkat e nuses i çonin djemtë.

Lidhur ngushtë me dërgimin e rrobave është edhe zakoni i ngjyerjes së flokëve të nuses me bojë, vënia e kënasë. Boja dhe kënaja (materiale makiash), përdoreshin kudo të shqiptarët për zbukurimin e nuses, si një zakon mjaft i lashtë që ka zbritur deri në kohët e vona. Te pulli ynë vënia e kënasë bëhej një ose dy ditë para marrjes së nuses. Në këtë rast në shtëpinë e nuses mbledheshin gra e vajza, të cilat merrnin pjesë në këtë ceremoni. Vajza e rrethuar nga shoqet e saj, qante, sepse kjo ishte shenja e shkëputjes nga jeta e vajzërisë. Ajo, duke menduar se së shpejti do të ndahej nga shtëpia ku ishte rritur, nga prindërit, nga vëllezërit, nga motrat, nga të afërmit dhe nga shoqet e saj, kundërshtonte për të vënë kënanë. Të qarët e saj përzihej me këngët e shumta e të ndryshme që këndoheshin me këtë rast.

Me bojë ngjyenin flokët, ndërsa me këna i ngjyenin thonjtë e duarve dhe të këmbëve. Gjithashtu, me këna ngjyenin edhe gjysmat e gishtërinjve të duarve, ndërsa

në pëllëmbë i bënin një vulë të rrumbullakët. Zakonisht, gratë e ish-besimit ortodoks ngjyenin vetëm flokët.

Ishte zakon që, pas nuses, të vinin këna edhe të gjitha gratë dhe vajzat e reja.

Gjatë vënies së kënasë zhvilloheshin ceremoni të ndryshme, që kishin për qëllim ta ruanin nusen nga syri i keq dhe magjitë.


Dy ditë para se të merrej nusja, fillonin të vinin dasmorët. Në fillim vinin motrat, daja dhe hallat e dhëndrit. Ardhja e të ftuarve vazhdonte deri ditën e dasmës. Të ftuarit (qofshin këta të afërm, miq e shokë), me t'u afruar shtëpisë, qëllonin me armë. Me të shtëna u përgjigjeshin edhe njerëzit e shtëpisë.

Sipas kategorisë së të ftuarve bëheshin edhe peshqeshet. Madje, për shumë krahina dhuratat ishin të caktuara. Në disa zona të Labërisë krushqit e parë, ata që thirrreshin familjarisht, vinin me berr në këmbë, domethënë të patherur; krushqit e dytë me mish dhe krushqit e tretë me kanistër. Është me vend të theksojmë se te shqiptarët ishte shumë i përhapur zakoni që dasmorët e dhëndrit, sidomos ata që thirrreshin familjarisht, të sillnin si peshqesh për dasmë një dash. Nuk mungonin rastet që në vend të dashit të sillnin cjan ose edhe bagëti të trasha, si ndonjë ka, lopë apo viç. Në qoftë se nuk sillnin bagëti, atëherë sillnin vleftën e një dashi në të holla. Bile në Veri të Shqipërisë edhe të hollat quheshin «dash». Dashi i dasmës, shpeshherë, në pjesën e qafës, të ballit dhe të kurrizit lyhej me bojë të kuqe dhe i varej një këmborë ose lule për zbukurim. Desharët priteshin me nderime të mëdha nga i zoti i shtëpisë. Kaq e përhapur ka qenë sjellja e dashit në dasmë, saqë kudo në vendin tonë, në këngët popullore lirike gjejmë variante të ngjashme, si:

Kush asht ai që vjen me dash

Asht N. N. bylykbash....

Gjithashtu, ishte zakon që së bashku me dashin të sillnin edhe gjëra të tjera ushqimore, sidomos ëmbëlsira,



Nusja e mbuluar me duvak
— Gur i Bardhë (Mat)

1



Nusja e mbuluar me duvak
— Kërpicë (Tomorricë)



**Përgatitja e nuses për të
shkuar në shtëpinë e burrit
– Malësi e Madhe (Shkodër)**

Krushqit me nusen në rrugë (Mat)



bukë, sheqer, oriz, raki ose verë. Dasmorët e kategorive të tjera sillnin sende ushqimore dhe plaçka për dhëndrin (çorape, këmbishë, peshqirë etj.).

Në kohë të para, deri në fund të shekullit të kaluar, në Skrapar, të ftuarit i therrnin vetë bagëtitë në oborrin e shtëpisë që bënte dasmën dhe secili piqte në hell mishin për vete. I zoti i shtëpisë i falej me raki herë njërit e herë tjetrit.

Për nusen ishte zakon që të mos çonin mish, por vetëm gjëra ushqimore (sidomos ëmbëlsira) dhe plaçka për vajzën.

Në të dyja shtëpitë, të dhëndrit dhe të nuses, të ftuarit priteshin me nderime të mëdha, por ceremonitë më të shumta bëheshin në shtëpinë e djalit.

Nisja e krushqve për të marrë nusen

Më në fund, mbasi mblidheshin të gjithë dasmorët, caktoheshin krushqit që do të shkonin për të marrë nusen. Ata caktoheshin nga i zoti i shtëpisë dhe të afërmit e tij dhe duhej të ishin burrat më të zgjedhur.

Në krye rrinte krushku i parë ose, siç quhej ndryshe, krushkapari, kryekrushku, selamazi, i cili udhëhiqte të tjerët.

Sipas KLD dhe KS, krushku i parë nuk ishte mik (pra, i lidhur me krushqi), por shok i dhëndrit dhe nuk duhet të ishte nga fisi i tij. Gjithashtu, krushk i parë ishte ai që i përkiste kreu në vendin e parë të fiseve të fshatit të tij apo të bajrakut pavarësisht nga pamja e jashtme apo mosha. Në Malësi të Gjakovës dhe në Mat këtë detyrë e kryente burri më i vjetër i fisit, që gëzonte autoritet midis të tjerëve dhe njihnte mirë zakonet. Në krahina të tjera mund të ishte një i afërt i dhëndrit, bile edhe vëllai më i madh. Si i tillë mund të shkonte edhe daja i dhëndrit, miku më i largët. Por, pothuaj në të gjithë Shqipërinë, daja luante rol të veçantë në drejtimin e dasmës. Ai shpesh ishte krushku i dytë.

Krushku i parë kishte një detyrë të rëndë përsipër. Ai jo vetëm që duhej të ishte i zgjedhur dhe i shkathët, por duhet të kishte dhe zotësi të tjera: të njihte zakonet mirë, të ishte shakaxhi, të drejtonte mirë krushqit e tjerë sipas situatës etj. Krushqit gjurmoheshin me kujdes të madh, sepse edhe për një gjest të vogël i vinin në lojë.

Zakonisht në popullin tonë për marrjen e nuses shkonin vetëm burra, por ka pasur raste që të shkonin edhe gra. Kjo më shumë në qytete dhe në disa krahina të Jugut.

Sipas një zakoni të vjetër, dhëndri ditën e dasmës shkonte me bagëti, fshihej në shtëpinë e ndonjë shoku apo të dikujt tjetër. Gjithashtu, zakoni e kërkonte që atë ditë ai të vishej me rrobat më të vjetra dhe të ngarkohej me punët më të shumta. Në Kosovë, në Malësi të Madhe, në Postribë, në Kallmet, në Mirditë, në Myzeqe të Vogël, në Çamëri dhëndri shkonte të kulloste bagëtinë. Madje, edhe kur nuk e kishte këtë profesion, largohej dhe delte në mal te tufa e bagëtive ose fshihej në një vend tjetër. Në Myzeqe ditën e dasmës, herët në mëngjes, dhëndri largohej nga shtëpia dhe fshihej në kopsht ose në shtëpinë e ndonjë fqinji. Për ta gjetur, mblidheshin shokët e tij. Pas një ore, shkonin në vendin ku ishte fshehur dhe, duke e mbajtur nga krahët, e sillnin në oborrin e shtëpisë. Edhe në qytetin e Elbasanit një ditë para martesës, dy orë para perëndimit të diellit, dy shokë të dhëndrit, me këngë ahengu e sillnin dhëndrin dhe e ulnin në karrige.

Pasi të sillej dhëndri nga «izolimi», para nisjes së krushqve, bëhej ceremonia e rruarjes apo e qethjes së dhëndrit. Meqë në shumicën e rasteve kjo që rruarja e parë që bënte dhëndri, si ditë e shënuar në jetën e tij, shoqërohej me ceremoni të shumta. Sjellja e dhëndrit dhe vendosja e tij në karrige shoqërohej me këngët e shumta të grave e të burrave. Ndërsa rruhej dhëndri, gra e burra mbanin nga pak lesh në dorë dhe e hiqnin sikur e krehnin (Përmet). Në Skrapar, gratë me një dorë lesh ose li, dilnin në oborr dhe shprishnin duke kënduar një këngë «lesh

e li. Këto rite bëheshin për shtimin e çiftit të ri si fijet e leshit e të lirit.

Pas rruarjes së dhëndrit dhe pasi merrnin fund të gjitha përgatitjet e duhura, krushqit, të veshur me rrobat më të mira, të pajisur me armë dhe me fishekë, ishin të gatshëm të merrnin pjesë në të gjitha ceremonitë e kësaj dite.

Me të dalë në oborr, ata shtinin me pushkë dhe, pasi përshëndeteshin, niseshin për rrugë. Në disa raste sinjalin e nisjes e jepte e shtëna e dhëndrit. Që nga larg krushqit ngjanin si një çetë luftarake e përgatitur për ndonjë aksion të rëndësishëm. Kjo i përket së kaluarës shumë të largët kur krushqit rrëmbenin një grua të një fisi tjetër për ta sjellë në fisin e tyre.

Në përgjithësi, në krahinat e Shqipërisë së Veriut dhe në ato zona ku vepronte Kanuni i Skënderbeut, dhëndri nuk shkante ta merrte nusen. Edhe në Shqipërinë e Jugut, me përjashtim të zonave të ish-besimit ortodoks, dhëndri nuk shkante me krushqit.

Në të kaluarën, në malësitë tona, para se të niseshin krushqit, në mes të oborrit therej një berr, të cilin e kapërcenin me radhë gjithë krushqit. Në Skrapar, në kohën e nisjes së krushqve, i afronin dhëndrit kalin e nuses dhe pranë tij linin një enë bakri me ujë. Dhëndri i binte me këmbë enës duke e përmbysur që të derdhej uji dhe pastaj i hipte kalit të nuses e që andej qëllonte me pushkë. Ndërsa babai i dhëndrit merrte një dash të mirë dhe e thërtë para kalit të nuses. Dhëndri e kapërcente me kalë këtë dhe drejtohej nga dera. Pas tij niseshin sipas radhës krushqit e tjerë, pasi të kapërcenin edhe ata kurbanin. Edhe në Frashër (Përmet) dhëndri derdhte me këmbë ibrikun me ujë dhe i binte një helli të hekurt, pastaj i hipte kalit të nuses dhe kapërcente kurbanin. Në disa fshatra të Përmetit, në vend të dashit, në prag të derës thernin një këndes, gjakun e të cilit e kapërcente dhëndri. Në Myzeqe, dhëndri kapërcente kurbanin e therrur në atë kohë dhe pastaj i hipte kalit. Në Mursi, dashi therrej nga i ati i djalit, sapo të lindte dielli. Gjakun e tij e kapërcente dhëndri.

Të gjitha këto ceremoni interesante të kujtojnë ritin e vjetër të grabitjes së gruas: dhëndri i hipur në kalë qëllonte me armë (shenjë e nisjes së krushqve për në aksion). Dikur ai e udhëhiqte vetë çetën e krushqve, i ati therte kurbanin, si shenjë urimi për ndërmarrjen e krushqve, kurse dasmorët i përcillnin me urimin «Dalshi faqebardhë!» etj.

I tërë kuptimi i këtyre ceremonive zbulohet nga sjellja e krushqve gjatë rrugës dhe në shtëpinë e nuses.

Nëse fshati ku do të merrej nusja ishte larg, atëherë krushqit niseshin një ditë më parë dhe flinin në shtëpi të ndonjë miku ose kishte raste që gdhieshin jashtë, dhe pastaj herët në mëngjes, shkonin për të marrë nusen. Në këtë rast merrnin me vete ushqime: bukë, mish, raki etj. Madje, në disa zona, edhe po të mos ndodheshin larg shtëpisë, sidomos kur hanin drekë te nusja, të gjitha ushqimet i kishin të vetat.

Gjithashtu, gjatë rrugës krushqit nuk duhej të këndonin dhe të qëllonin me armë, por duhet t'i afroheshin shtëpisë së nuses në heshtje dhe me një disiplinë të fortë. Bile në qytetin e Elbasanit, deri pas Luftës së Parë Botërore, pjesa e ish-fesë myslimane e kishte zakon që nuset t'i merrte natën.

Edhe afrimi i krushqve në shtëpinë e nuses shoqërohej me ceremoni të ndryshme. Në shumicën e rasteve ata priteshin nga një përfaqësues i palës së vajzës rreth 500-1 000 metra larg shtëpisë. Ky i udhëhiqte deri në shtëpi ose qëndronte me ta në një shesh derisa vinte koha e marrjes së nuses. Në disa zona, te vendi i caktuar për pritjen e krushqve, dilnin të gjithë dasmorët burra të palës së vajzës dhe aty bëhej ceremonia e dorëzimit të nuses. Sipas zakonit, krushqit uleshin në një anë dhe përballë tyre vendoseshin dasmorët e palës së vajzës.

Ai që priste krushqit nuk u ndahej për asnjë çast atyre dhe u mbante anën në të gjitha rastet. Edhe këtu ka gjurmë nga koha kur gratë grabiteshin dhe njerëzit e djalit kishin në anën kundërshtare ndonjë shok a mik, që i ndihmonte në përmbushjen e ndërmarrjes së tyre.

Afrimi i krushqve në oborr shoqërohej me tri ose më

shumë të shtëna pushke, gjë që tregonte fillimin e «betëjes» ndërmjet dy palëve.

Shpeshherë krushqit e «fshihnin» qëllimin e vizitës së tyre. Ata «paraqiteshin si të huaj në atë fshat, si njerëz të panjohur», që kishin humbur rrugën dhe i «kishte zënë nata», si gjahtarë që, duke ndjekur sorkadhen, i «zuri nata në rrugë» etj. Kur kryekrushku tregonte qëllimin e ardhjes, i zoti i shtëpisë «zemërohej» dhe «rezistonte». Vetëm me ndërhyrjen e të tjerëve (sidomos të dajës së vajzës) ai bindej dhe pranonte ta jepte vajzën.

Përcjellja e nuses

Përcjellja e nuses nga shtëpia e saj shoqërohej me ceremoni të ndryshme. Nusja, e cila deri në kohën e ardhjes së krushqve ishte vendosur në një dhonë të veçuar ose në një kasolle, merrej andej dhe dërgohej në dhomën prej ku do të nisej nuse. Nusja mundohej, gjoja, të rezistonte. Nxjerrja në oborr shoqërohej me britmat dhe të qarat e saj. Ajo u lutej njerëzve që të mos e lëshonin. Në Mirditë atë e kapnin për krahësh një burrë a një grua, ndërsa në Mat vëllezërit dhe të afërmit e tërhiqnin deri përjashta. «Nusja prej shtëpie del gati rrshanas, gërmuq e tue kja me të madhe, e marrun gjithnjë prej njerëzve të shtëpisë e vllaznisë», thuhet në Kanunin e Skënderbeut. Në disa krahina të tjera, si në Përmet dhe në Çamëri, nusen e shpinin në oborr, duke e marrë në duar. Në Çamëri e merrte i vëllai. Këto dukuri, të cilat me ndonjë variant të vogël lokal shfaqeshin në të gjithë shqipëtarët, të kujtojnë zakonin e grabitjes së grave.

Edhe «marrja» ose «fshehja» e ndonjë objekti nga shtëpia e nuses është një traditë tjetër interesante, burimi i së cilës duhet kërkuar te sulmi agresiv i krushqve për plaçkitjen e shtëpisë së nuses. Krushqit, me t'u çuar për të dalë, kërkonin të plaçkitnin ndonjë objekt si: filxhana kafeje ose edhe ndonjë send tjetër. Pra, zakoni i grabitjes së vajzës u thjeshtua në plaçkitjen e ndonjë objekti.

Me rastin e përcjelljes së nuses bëheshin edhe cere-

moni të tjera. Në disa krahina të vendit tonë vajzën nuse, para se ta nxirrte në oborr i vëllai apo ndonjë kushëri i saj (në ndonjë zonë krushkapari), e merrnin për krahu dhe e sillnin tri herë rrotull vatrës së zjarrit ose e ulnin dhe e ngrinin tri herë.

Para se vajza të hypte në kalë, u linte lamtumirën prindërve, të afërmeve dhe të gjithë atyre që kishin ardhur ta përcillnin. Ky ishte momenti më mallëngjyes. Madje, në disa krahina ishte zakon që vajzën ta çonin më parë në të gjitha dhomat, në oborr, në kopsht, në ahur të bagëtive, në shtëpitë e komshinjve etj.

Pasi të mbarohej ceremonia e lamtumirës vajzës i hidhnin një duvak në kokë. Edhe ky lidhet me zakonin e dikurshëm të grabitjes së gruas.

Duvaku ka qenë përdorur nga mbarë shqiptarët. Ai kishte formën e një koni apo të një thesi me fund të gjerë. Duvaku përdorej për t'i mbuluar fytyrën nuses. Në përgjithësi, në kokë i vinin një kësulë, mbi të cilën vendosnin duvakun. Ai vinte i gjatë deri afër belit, por kishte edhe zona që shkante deri në fund të këmbëve.

Në kalë nusen e hipnin njerëzit e saj (i vëllai, xhaxhai ose daja). Kali duhej të ishte i bardhë, parapëlqej edhe i kuq. Kali i nuses dallohej nga të tjerët qoftë nga ngjyra, qoftë edhe nga pajisjet. Sipër shalës i hidhej velenxë, sixhade apo qilim, nganjëherë një shilte. Anës së frerit ose edhe në të dyja anët e kokës, afër veshëve i varnin dy shami me ngjyra të ndezura.

Dorëzimi i nuses bëhej me ceremoni të ndryshme. Në Malësi të Madhe, pasi të arrinin në vendin e ndarjes të dyja palët e krushqve, një përfaqësues i shtëpisë së vajzës thërriste: «O gjever, hajde merre nusen!». Gjeveri i dilte nuses nga ana e djathtë, e zinte nga krahu dhe e tërhiqte dy-tri hapa përpara. Pastaj e lëshonte dhe nusja, e ndihmuar nga dasmoresha (që shkante prapa), duke ecur me hapa të ngadaltë kthehej nga ana e njerëzve të shtëpisë, që kishin ardhur për ta përcjellë, duke ngritur duvakun e duke thirrur: «Oj, oj, oj». Këtë gjë e përsëriste edhe pasi kalonte 50-60 metra. Pastaj e hipnin në kalë dhe niseshin për rrugë. Gjatë kësaj kohe të shtënat nuk

pushonin nga të dyja palët. Kjo të kujtonte një «betejë» të vërtetë, të cilën në fund të fundit e fitonin njerëzit e dhëndrit, sepse, pas hipjes së nuses në kalë, njerëzit e saj nuk kishin të drejtë të qëllonin. Kështu, «të mundur», me kokë të ulur ktheheshin në shtëpi. Një gjë të tillë e gjejmë kudo te populli ynë. Sapo krushqit largoheshin nga shtëpia e nuses apo nga vendi i ndarjes, njerëzit e saj qëllonin në ajër me armë, gjoja kundër tyre, dhe krushqit u përgjigjeshin. Të shtënat vinin duke u rralluar sa më shumë largoheshin të dyja palët, veçse e shtëna e fundit u takonte njerëzve të dhëndrit, si fitimtarë. Madje, në Malësi të Vogël, krushqit dhe dasmorët e vajzës niseshin në një kohë dhe takoheshin në një vend të caktuar. Sapo shiheshin të dyja palët, fillonte zbrazja e pushkëve nga të dyja anët. Kjo përpjekje e kurdisur të kujton grabitjen e grave.

Kudo në Shqipëri, gjatë kthimit, krushqit e ndërrojnë rrugën, qoftë edhe për një pjesë të vogël të saj dhe nuk ktheheshin kurrë nga kishin ardhur. Populli këtë gjë e shpjegon kështu: «Nuk është mirë», «Nuk shkon për mbarë» etj. Në të vërtetë, edhe ky zakon e ka burimin te grabitja e gruas.

Po të ndodhte që rrugës të takoheshin dy palë krushq, zakoni e kërkonte që krushqit më të afërt t'u lironin udhën krushqve më të largët. Por, në të kaluarën, janë bërë edhe përpjekje e luftime, pasi ishte fyerje e madhe dhe tregonte dobësi ajo palë që lironte udhë. Toponime si Varret e Krushqve, që gjenden kudo në Shqipëri, tregojnë si kanë përfunduar këto përpjekje.

Krushqit krenarë, me t'u afruar në shtëpinë e dhëndrit, nisnin përpara një ose dy djem të ri, të cilët çonin sihariqin që ata po ktheheshin fitimtarë nga misioni i tyre aq i rëndësishëm dhe nusen po e sillnin shëndosh e mirë. Ndërsa në ato zona ku dhëndri shkonte së bashku me krushqit për të marrë nusen, ai shkëputej nga vargu i tyre dhe shkonte i pari në shtëpi.

Arritja e nuses në shtëpi të burrit

Me ceremoni të shumta pritej arritja e nuses në shtëpinë e dhëndrit. Shumë nga këto ceremoni kishin në brendinë e tyre nënshtrimin e gruas ndaj burrit dhe prindërve të tij, dëshirën që ajo të lindte djem, të ishte e ëmbël, këmbëmbarë, të sillte bollëk etj. Shumë norma patriarkale që përligjnin nënshtrimin e gruas ndaj burrit ishin të pleksura me fenë. Ato kanë gjetur shprehje në shumë këngë popullore, që këndoheshin kur nusja hynte në shtëpinë e burrit.

Në zonat ku vepronte Kanuni i Skënderbeut, me të arritur krushqit me nusen, dhëndri u dilte përpara dhe qëllonte me armë. Ndërsa në Malësi të Gjakovës krushqit i thërrisnin dhëndrit, i cili u përgjigjej menjëherë me pushkë dhe dilte në oborr për t'i pritur.

Nusja, pa zbritur ende nga kali, përshëndeste tri herë me kokë, ndërsa një nga gratë e shtëpisë (zakonisht vjehrra) merrte një pasqyrë në dorë dhe reflektonte në drejtim të nuses rrezet e diellit. Gjithashtu, ajo e shikonte nusen nëpërmjet një site të mirë. Populli e shpjegon këtë si urim për nusen: «Ardhtë e ndritur!», «Ndrinë si pasqyra!», «I ndritë shtëpia!», «Të njohë shtëpinë nga larg», «Të jetë e mirë si sita» etj. Pasqyra mund të ketë mbetur nga ndonjë shenjë e vjetër marrëveshjeje në mes të krushqve e shtëpisë, kur pushka nuk kishte filluar të përdorej.

Mbarë shqiptarët si kur e përcillnin nusen nga shtëpia e saj, ashtu edhe kur e pritnin në shtëpi të dhëndrit, i hidhnin mbi kokë grurë, oriz, mel, sheqer dhe të holla. Nganjëherë i hidhnin edhe mollë, arra, lajthi, karamelë. Në Labëri, së bashku me grurin etj., i hidhnin nuses edhe një tufë me lesh të palarë. Shqiptarët e Greqisë i hidhnin pambuk.

Gruri, orizi, meli, sheqeri, leshi, pambuku, monedhat etj., sipas besimit të popullit, hidheshin që nusja të lindte sa më shumë fëmijë; sheqeri për të bërë jetën sa më të ëmbël etj.

Ceremoni të shumta bëheshin për të ndikuar lindjen

e djemve. Pa zbritur ende prej kalit, nuses i vinin në prehër një djalë të vogël me nënë e baba (Malësi e Gjakovës, Lumë, Myzeqe). Në disa krahina të tjera djali i vihej nuses në prehër, pasi të zbritet nga kali e të ulej në karrige (Kosovë, Malësi e Vogël, Shkodër, Mirditë, Malësi e Krujës, Himarë). Veç kësaj, një djalë të vogël e sillnin tri herë rreth barkut e shpinës së kalit (Mirditë, Malësi e Krujës, Labëri), kurse në Çamëri një djalë i shkathët (zakonisht, i vëllai i dhëndrit) i hypte kalit dhe ecte me revan.

Pas gjithë këtyre ceremonive, nusen e futnin brenda në dhomë. Janë të njohura në gjithë shqiptarët besimet e ndryshme lidhur me prapun e derës dhe kapërcimin e tij. Kudo pragu duhej kapërcyer me këmbën e djathtë, sepse kjo vështrohej si e mbarë. Bile, në disa krahina nusen e ngrenin peshë dhe e futnin brenda.

Që nusja të ishte «e ëmbël» dhe që jeta e saj me burrin dhe të afërmit e tij të kalonte mirë e në harmoni, te populli ynë bëheshin veprime të ndryshme. Në Malësi të Madhe, sapo të hynte nusja brenda, e priste zonja e shtëpisë me dy enë: njëra kishte brumë buke, tjetra mjalhtë. Nusja zhyste duart në të dyja enët dhe prekte prapun e derës, brenda dhe jashtë, si dhe këmbët e shkallëve. Zakoni i futjes së dorës (gishtërinjve) në brumë praktikohet edhe në krahina të tjera. Në fshatrat e Bendës (Tiranë) fuste gishtërinjtë në brumin e ëmbël nusja e pastaj edhe vjehrra. Në Shëngjergj e Shënmëri (Tiranë) nusen e shpinin në magje dhe ia futnin gishtërinjtë në brumin e përgatitur me shërbet.

Futja e dorës në brumë është një dukuri e lashtë dhe, në një kohë të largët, duhet të ketë qenë praktikuar në mbarë popullin tonë. Më vonë, kjo u zëvendësua me futjen e dorës apo të gishtërinjve në mjalhtë (ka të ngjarë të jenë edhe të një kohe) dhe në kohë më të reja në shërbet apo në sheqer. Lyerja e dorës me mjalhtë apo me shërbet, si simbol i harmonisë dhe i dashurisë, ndeshet në mbarë popullin tonë.

Në Malësi të Madhe, në Malësi të Gjakovës, në Malësi të Krujës, në Elbasan, në Myzeqe, në Berat, në Vlorë, në Përmet, në Skrapar, në Gjirokastrë, në Sarandë, në Kolo-

një nusja lyente me mjaltë parvazin e sipërm të derës. Bile në Kolonjë, sapo të afrohej nusja për në dhomë, vjehrra i jepte asaj një shtëllungë leshi të bardhë të lyer me pak mjaltë, e ajo prekte me të parvazin e derës. Në Mursi edhe dhëndri, së bashku me nusen, merrte pjesë në lyerjen e parvazit të derës. Në qytetin e Shkodrës e të Tiranës në vend të mjaltit përdorej sheqeri, ndërsa në Malësi të Rrogozhinës sherbeti. Edhe në shqiptarët e Greqisë nusja vinte gishtin e vogël të dorës së djathtë në një përzierje mjalti me bajame dhe me të bënte shenjë në pjesën e sipërme të derës. Këtë gjë e kishte bërë më parë dhëndri kur ishte nisur për në shtëpinë e vjehrrit për të marrë nusen.

Në disa krahina të Shqipërisë, që nusja të ishte e ëmbël me të shoqin, me njerëzit e shtëpisë e me të tjerë, bëheshin veprime të ndryshme. Në Skuraj (Krujë), mjaltin nusja e hante me dhëndrin (sipas besimit popullor, kjo bëhej për urim: «Ëmbël ju shkoftë moti e jeta!»), ose gishtërinjtë e nuses, të zhytur në mjaltë, i lëpinte vjehrra (Vlorë), njerëzit e shtëpisë (Myzeqe, Skrapar), gratë (Berat, Përmet). Për të njëjtin urim «Me të ëmbël na shkoftë jeta!», pihej sherbeti nga vjehrra dhe nusja (Opar, Përmet), vetëm nga nusja (Milot), apo nga nusja dhe përcjellësit e saj (Mollagjesh, Elbasan).

Është me interes të shënohet se, në disa krahina, si urim «për jetë të ëmbël» përdornin sheqerin dhe kripën që i hidhnin në gjellë. Në Pukë, me të ardhur nusja në shtëpi të burrit, nxirrte nga takëmi i saj një dorë sheqer dhe ia jepte vjehrrës, e cila hidhte nga pak në gjellët e dasmës. Në Mirditë nusja shkonte te vatra e shtinte pak kripë në një vegsh me mish ose pak sheqer në një vegsh bosh. Edhe në Mat dhe në zonat ku vepronte Kanuni i Skënderbeut në gjellë hidhnin kripë.

Në zonën e Hasit (Kukës) e të Mallakastrës, sapo hynte nusja brenda, vjehrra e puthte tri herë në ballë e tri herë në gjinj, kjo për mbarësi e trashëgim. Këto veprime e kanë origjinën te kulti i të parëve.

Heqja e duvakut. Zbulimi i nuses apo heqja e duvakut përgjithësisht, bëhej që ditën e parë të ardhjes së

nuses. Në shumë krahina të vendit tonë duvakun e hiqte dhëndri. Ky ishte takimi i parë i dhëndrit me nusen. Dhe, sikur ai të mos e kishte njohur në fëmijëri, ishte hera e parë që djali shihte fytyrën e bashkëshortes së tij, me të cilën po lidhej për jetë. Veç kësaj, në një mjedis ku të gjitha shikimet drejtoheshin te çifti, dhëndri nuk guxonte dhe as që kishte mundësi të sodiste me vërejtje fytyrën e gruas së tij.

Sipas zakonit, dhëndri ia hiqte duvakun nuses me majën e një thike apo hanxhari, me kobure, me petës, apo me dorë.

Duvakun mund ta hiqte edhe një person tjetër (i ati i dhëndrit, vëllai, xhaxhai apo ndonjë kushëri i tij, një djalë i ri me prindër gjallë), apo një grua (motra ose kushërira e dhëndrit).

Heqja e duvakut shoqërohej edhe me ndonjë veprim tjetër. Diku dhëndri i shkelte këmbën nuses apo i spërkaste fytyrën me verë, e qëllonte në kokë tri herë me shkop, apo i binte me shuplakë në fytyrë. Të gjitha këto veprime dhe vetë heqja e duvakut me thikë, me hanxhar apo me tytën e pushkës, ndonëse për kohën që po i shqyrtojmë, veçanërisht në disa krahina, janë më shumë ceremoni zbavitëse, dikur kanë pasur domethënie e tyre: nënshtrimin e gruas ndaj burrit.

Arritja e nuses në shtëpinë e dhëndrit dhe ceremonitë e ndryshme që zhvillohen me këtë rast, shoqërohen me këngë të shumta e të larmishme, që përbëjnë një pasuri të madhe të lirikës sonë popullore. Shumë këngë i drejtohen babait të dhëndrit, strumbullarit të familjes (sipas konceptit patriarkal), nënës së tij që e ka rritur djalin me aq mundime, motrës, vëllait, krushqve etj. Po mbi të gjitha u këndohet nuses dhe dhëndrit, ku shprehet gëzimi për martesën, si një akt i domosdoshëm, për të cilën bëheshin shumë urime. Dhe në këto urime kurdoherë shprehej epërsia e djalit mbi vajzën në një shoqëri të tillë si ajo feudoborgjeze.

Një numër i madh këngësh flasin për bukurinë e nuses. Në këto këngë gjenden figura poetike e krahasime nga më të zgjedhurat. Ajo krahasohet me «hanën e ku-

qe», me «manushaqen e prillit në mes të dëborës», me «lulen e frashërit të bardhë», me «trëndafilin», me «gje-raqinën», me «thëllëzën» etj. Ndërsa dhëndri me «limonin e artë», me «pëtritit» etj. Në këto figura, sidomos në ato që flasin për bukurinë e nuses, shihet qartë karakteri romantik në trajtimin e së bukurës. Nusja shikohej në përgjithësi vetëm si qenie e bukur, megjithëse përmbi të do të binte barra e rëndë e jetës patriarkale, që shumë shpejt do t'ia prishte bukurinë. (Në këngë të tjera figura e gruas plotësohet edhe me vlerat morale të saj).

«*Bashkimi martesor*» i çiftit ishte një nga momentet kryesore të dasmës shqiptare, që shoqërohej me ceremoni të ndryshme.

Në dhomë dhëndrin e shoqëronin burra e gra apo vetëm burra. Para se të «mbyllej» në dhomë, dhëndri falej me prindërit e tij dhe me të afërmit e tjerë, kryesisht pleq e plaka, të cilëve, me kokë të ulur nga turpi, u puthte dorën dhe u kërkonte falje për ndarjen nga ata dhe bashkimin me nusen. Sapo dhëndri afrohej për t'u futur brenda, djem të rinj (nganjëherë edhe vajza) e godisnin me pëllëmbë, me grushta dhe diku i hidhnin nëpër këmbë kunguj dhe mollë, apo një kaci me prush e barut.

Në përgjithësi, sipas zakonisht, nuk lejohej që dhëndri të flinte me nusen që natën e parë, dukuri e njohur edhe në popuj të tjerë. Pra, nusja natën e parë dhe, në disa raste, edhe natën e dytë flinte me një person tjetër që mund të ishte grua apo edhe djalë i vogël.

Hyrja e dhëndrit shoqërohej me të shtëna armësh. Përveç kësaj, ishte zakon që natën e parë dhoma e çiftit të ruhej gjatë gjithë natës me kujdes të madh nga shokët e dhëndrit. Besohej se kështu ruhej nga magjithë.

Ceremonia pas dasmës

Darovitja e nuses. Në mbarim të dasmës, para se të shpërndareshin krushqit, nusja u jepte dhuratat njerëzve të shtëpisë dhe miqve (çorape, peshqirë, shamia etj).

Kurse ata që mërrnin dhuratat i falnin nuses, në shumicën e rasteve të holla. Darovitja e nuses ishte sipas dëshirës. Ai që hidhte i pari (zakonisht vjehri, gjeveri, vëllami etj.) jepte një sasi të vogël të hollash, në mënyrë që të mos turpëronte të pranishmit. Shuma deklarohesh me zë të lartë. Paratë që mblihdeshin me këtë rast përdorshin nga nusja si pasuri e saj. Me to mund të blinte bagëti, tokë apo ndonjë gjë tjetër. Ajo ishte një pasuri personale brenda ekonomisë së përbashkët të familjes dhe nuk kishte të drejtë të ndërhynte njeri në të. Nusja me këtë pasuri mund të bënte ç'të donte pa i dhënë llogari askujt.

Dhuratat që sillte nusja në shtëpinë e burrit, qoftë për pjesëtarët e shtëpisë, qoftë edhe për të afërmit dhe miqtë ishin për familjen e saj një barrë e rëndë që, së bashku me shpenzimet e tjera të dasmës, e dobësonin ekonominë shtëpiake.

Vajtja e nuses për ujë. Në ciklin e ceremonive pas dasmës një vend me rëndësi zë edhe dërgimi i nuses për ujë. Ky zakon ka qenë praktikuar te mbarë shqiptarët.

Në Shqipëri nusja shkonte për ujë ditën e tretë pas martesës. Atë e shoqëronte një djalë i vogël (me prindër gjallë) ose dhe gra e vajza, në disa raste edhe dasmorë. Zakonisht nusen e shpinin në burim, në pus apo në lumë. Para se ajo të mbushte enët, hidhte në ujë disa monedha, të cilat i merrte shoqëruesi i saj. Me ujin që mbushte nusja lahej djali që e shoqëronte dhe ajo vetë. Kur kthehej nga burimi u jepte të pinin ujë gjithë njerëzve të shtëpisë. Nganjëherë ujit i hidhnin pak sheqer që nusja të ishte e ëmbël me të gjithë.

Me vajtjen e nuses për ujë, lidhet edhe futja e saj në punë për herë të parë në shtëpinë e burrit apo, sipas shprehjes që përdorej në Malësi të Gjakovës, nusja «hyn ndër rob». Në shumicën e krahinave të vendit tonë, puna e parë që bënte nusja ishte gatimi i kulaçit ose i ndonjë ëmbëlsire. Kjo i jepte fund ciklit të gjatë dhe shumë interesant të ceremonialit të dasmës.

LIDHJET MARTESORE PAS ÇLIRIMIT

Fitorja e Revolucionit Popullor dhe vendosja e marrëdhënieve socialiste në prodhim, shndërrimet e thella ekonomike e shoqërore, transformimet në fushën e ideologjisë dhe të psikologjisë së masave punonjëse, ndikuan përherë e më tepër edhe mbi marrëdhëniet martesore familjare, sollën e po sjellin në gjirin e familjes ndryshime thelbësore. Martesa në shoqërinë tonë socialiste bazohet në Kushtetutën e RPSSH dhe në kodin e familjes.

Ndryshimet në marrëdhëniet martesore pas Çlirimit kanë kaluar një rrugë të gjatë zhvillimi, derisa erdhën në stadin që janë sot. Veç kësaj, zhvillimi i marrëdhënieve martesore është një proces që do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Partia jonë që në krijimin e saj, demaskoi dhe hodhi poshtë shpifjet dhe trillimet e armiqve tanë se gjoja komunistët shqiptarë ishin kundër familjes dhe për prishjen e saj, kritikoi ashpër edhe pikëpamjet anarkiste të disa elementëve të grupeve komuniste, të cilët kishin mendime të gabuara për familjen. Ajo, që në atë kohë luftoi kundër dallimeve fetare dhe zakoneve prapanike si pengesa për lidhjet martesore. Gjithashtu Partia luftoi për barazinë e burrit me gruan, në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë edhe atë të familjes, për dashurinë e pastër e të sinqertë që duhet të karakterizojë marrëdhëniet bashkëshortore.

Kushtet për zhvillimin e mëtejshëm të lidhjeve martesore u krijuan vetëm pas Çlirimit.

Dallohen dy faza kryesore: faza e parë që nis me vitet e para të Çlirimit deri në vitin 1965 dhe faza e dytë që fillon me vitin 1966 e që vazhdon edhe në ditët tona.

Faza e parë karakterizohet nga ndryshime të mëdha ekonomike e shoqërore të bëra në vendin tonë. Partia dhe pushteti popullor qysh në fillim morën një sërë masash në lëmin ekonomik-shoqëror me karakter demokratik dhe socialist. Ato ishin të thella, të shpejta e të vrullshme.

Rëndësi të veçantë kanë zhdukja e pronës private dhe vendosja e pronës shoqërore mbi mjetet e prodhimit dhe krijimi i sistemit socialist të ekonomisë, të cilët sollën me vete zgjerimin dhe forcimin e bazës materiale të pushtetit politik, të demokracisë socialiste dhe të unitetit të popullit me Partinë.

Gjatë kësaj faze u ndërtua baza ekonomike e socializmit, që është fitorja e dytë më e madhe pas vendosjes së pushtetit popullor. Tani vendi ynë hyri në një etapë të re historike, në atë të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Mbi bazën e këtyre ndryshimeve të mëdha dhe në sajë të punës së gjithanshme politiko-edukative të Partisë, u formua edhe figura morale e njeriut tonë, ndërgjégjja dhe botëkuptimi i tij ndaj punës dhe pronës, qëndrimi i tij ndaj shoqërisë, ndaj martesës dhe ndaj familjes. Dhe ky emancipim i shoqërisë sonë nuk përfaqësohej vetëm nga burrat por edhe nga vajzat dhe gratë, të cilat duke marrë pjesë në prodhim krahas djemve dhe burrave, u bënë faktorë bazë për emancipimin e tyre. Në vendin tonë u realizuan thënia e Engelsit se «Mënyra e vendosjes së një barazie të vërtetë shoqërore për të dyja palët (të burrit dhe të gruas - A. D.) do të dalë në dritë të plotë vetëm atëherë, kur bashkëshortët do të kenë të drejta të plota, të barabarta nga pikëpamja juridike. Atëherë do të duket se kushti i parë paraparak i çlirimit të gruas është kthimi i gjithë seksit femëror në prodhimin shoqëror»¹.

Ndërtimi i socializmit si në qytet edhe në fshat kër-

1 F. Engels. Origjina e familjes, f. 105-106.

koi në mënyrë të domosdoshme tërheqjen e gruas në frontet e ndryshme të ndërtimit të vendit. Këtë e kërkonin jo vetëm interesat rrënjësore të ndërtimit socialist, por edhe interesat e çlirimit të plotë të gruas.

Gruaja në vendin tonë është bërë sot një forcë aq e madhe, saqë pa pjesëmarrjen e saj aktive nuk mund të mendohet asnjë aksion i madh politik, ekonomik e shoqëror, dhe se as që mund të ndërtohet socializmi. Nuk ka sektor pune e prodhimi, nuk ka institucion kulturor-arsimor ose shkencor ku të mos jetë derdhur djersa dhe të mos ketë shpërthyer fjala dhe heroizmi masiv i gruas shqiptare.

Në qytet gratë zënë një vend të rëndësishëm në radhët e punëtorëve dhe të punonjësve të tjerë. Karakteristikë është se ritmet e shtimit të radhëve të grave punëtore, veçanërisht gjatë planeve pesëvjeçare, janë më të larta se ritmet e shtimit të fuqisë punëtore në përgjithësi.

Zhvillimi ynë i vrullshëm socialist ka bërë që gratë të marrin pjesë në të gjitha sferat dhe degët e jetës ekonomiko-shoqërore të vendit. Pozitiv është gjithashtu, fakti se, sidomos këta vjetët e fundit, ka ardhur duke u shtuar me shpejtësi numri i grave punëtore edhe në rrethet e vogla, të cilat trashëguan një prapambetje më të madhe nga e kaluara. Vetëm në rrethin e Pukës punojnë sot më shumë gra punëtore sa punonin në Shqipëri para Çlirimit.

Edhe në ndërmarrjet bujqësore gruaja merr pjesë aktive jo vetëm në të gjitha punët e fushës e të blegtorisë, por edhe në sektorët e mekanikës bujqësore. Në sektorët shtetërorë të bujqësisë gratë punëtore zënë 45 për qind të numrit të përgjithshëm të grave punëtore. Kjo tregon për një kthesë rrënjësore në ndërgjegjen e grave, për një kuptim më të thellë politik të pjesëmarrjes së tyre në punë të dobishme shoqërore.

Pa dyshim një kontribut të madh në ndërtimin e shoqërisë socialiste luan gruaja fshatare. Socializmi edhe në fshat i vuri dhe po i vë në lëvizje forcat e ndrydhura në shekuj të gruas. Sot gruaja kooperativiste është bërë një forcë e madhe pune.

Tërheqja e vazhdueshme e gruas në prodhim dhe në jetën politiko-shoqërore të fshatit, shënoi një revolucion të madh me rëndësi historike në zhvillimin e gjithanshëm të tij. Rrritja e vazhdueshme e numrit të punonjësve në fshat ndikoi edhe në zhvillimin e në ndryshimin e strukturës social-klasore të fshatarësisë kooperativiste në drejtim të përbërjes sipas gjinisë. Këto ndryshime në tërësinë e tyre përbëjnë një fenomen shoqëror pozitiv. Ato flasin për emancipimin e gruas fshatare, por edhe për pjesëmarrjen efektive të saj në ndërtimin socialist të fshatit.

Pjesëmarrja e gjerë e gruas në prodhimin shoqëror dhe në gjithë jetën politiko-shoqërore të vendit është një garanci themelore për zhvillimin në baza demokratike të familjes sonë të re socialiste. Pra, futja e gruas në prodhim shoqëror dhe zhdukja e pabarazisë në familje, janë dy kushte bazë për çlirimin e plotë të gruas, dhe si rrjedhim edhe të forcimit të familjes socialiste.

Sot jeta e gruas dhe e fëmijëve nuk është e varur vetëm nga puna e burrit, por nga puna e përbashkët e burrit dhe e gruas. Kjo përmbysje në marrëdhëniet ekonomike brendapërbrenda familjes, që siç u tha, ka ardhur si rezultat i pjesëmarrjes së gruas në prodhim, ka sjellë në mënyrë të domosdoshme edhe përmbysjen e marrëdhënieve të vjetra midis pjesëtarëve të familjes. Në familjet e sotme në qytet e në fshat, u zhdukën dhe u dobësuan në mënyrë të ndjeshme ndikimet e ndryshme materialo-ekonomike të pronës private, të praktikave patriarkalo-fisnore, feudoborgjeze dhe fetare në përpjekjet për zgjedhjen e shoqes dhe të shokut të jetës. Bashkë me pronën private dhe me shfrytëzimin feudoborgjez të njeriut, revolucioni ynë likuidoi edhe bazën ekonomiko-shoqërore të përmbytjes së tipave dhe të formave të vjetra patriarkale, feudalo dhe borgjeze të martesës. Mbi bazën e marrëdhënieve të reja socialiste të prodhimit, të ngritjes së pareshtur të mirëqenies materiale dhe kulturore të masave punonjëse, të kujdesit të gjithanshëm e gjithnjë në rritje të Partisë dhe të shtetit për familjen, lindën e u përhapën martesat e reja socialiste. Ato ishin

më të shpeshta në ish-partizanët, në komunistët, në klasën punëtore dhe në shtresat e intelektualëve përparimtarë. Me forcimin e marrëdhënieve socialiste në prodhim martesat e reja zinin në qytet një përqindje të mirë në krahasim me martesat tradicionale. Por edhe në fshat u vunë re martesat e reja, që i përgjigjeshin zhvillimit socialist të fshatit.

Natyrisht, lufta midis së vjetrës dhe së resë është e ashpër dhe, për të fituar e reja, duhet të kalojë mjaft pengesa. Këto pengesa kushtëzoheshin nga shumë faktorë, objektivë e subjektivë, nga shkalla e zhvillimit ekonomik-shoqëror e kulturor, nga mbeturinat e zakonave të ndryshme dhe besimeve fetare.

Pas Çlirimit në vendin tonë kishte krahina ku ende ekzistonin zakonet e traditat e vjetra dhe në njëfarë mase ruheshin disa nga format e vjetra të lidhjes së martesës. Të tilla ishin zonat e thella. Mjafton të përmendet ndalimi i martesës brenda të ashtuquajturit «fis», i cili ka qenë mjaft i theksuar në këto zona. Vajza dhe djali që do të martoheshin, nuk duhet të ishin nga i njëjti fafis qoftë edhe 20 breza larg njëri-tjetrit. Këtij ndalimi i shtoheshin edhe lidhjet rituale (kumbaritë e ndryshme, vëllamëria etj.) dhe lidhjet territoriale (ndalimi i martesave brenda fshatit). Megjithatë, deri në vitin 1965 ka pasur edhe thyerje të këtyre normave. Martesa brenda fafisit dhe brenda fshatit vihen re në Dukagjin, në Malësi të Madhe, në Mirditë, në Malësi të Gjakovës, në Librazhd, në Labëri etj. Por në përgjithësi, martesat të tilla ishin të rralla.

Sigurisht opinione të tilla të gabuara për martesë pengonin mjaft njohjen e djalit e të vajzës dhe nxitnin shkuesinë. Po japim vetëm një shembull: Në 144 çifte të martuarish pas Çlirimit (deri në vitin 1970) në fshatin Kurjan të rrethit të Fierit, nuset janë marrë nga 71 fshatra të ndryshme të afërta e të largëta.

Këtyre dhe zakoneve të tjera që bëheshin pengesë për lidhjet e reja martesore dhe që binin ndesh me zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë sonë socialiste, Partia u bëri një luftë të ashpër, që sa vinte e shtoej. Kushtet

për një sulm të gjerë kundër të gjitha mbeturinave dhe «njollave» të shoqërisë së vjetër ishin krijuar që në këtë fazë.

U intensifikua puna ideologjike me njerëzit për forcimin e familjes, për të çrrënjosur nga ndërgjegjja e tyre konceptet konservatore, patriarkale e idealiste lidhur me kuptimin e marrëdhënieve martesore, familjare dhe të barazisë së gruas me burrin. Gjithashtu u bë një punë e dendur politike e ideologjike për të njohur më mirë ligjet e shtetit që kanë sanksionuar barazinë e gruas me burrin, si dhe të gjitha liritë demokratike të saj.

Lëvizjet që shpërthyen në të gjithë vendin pas Kongresit V të PPSH dhe sidomos pas Fjalimit programatik të shokut Enver Hoxha më 6 shkurt 1967 për mbrojtjen e të drejtave të grave e të vajzave, synonin jo vetëm zhdukjen e mbeturinave fetare dhe të zakoneve prapanike, por edhe forcimin e lidhjeve të reja martesore, si dhe konsolidimin e mëtejshëm të familjes socialiste. Masat punonjëse, të udhëhequra nga Partia, nëpërmjet veprimeve të tyre aktive dogjën me zjarrin e revolucionit shumë norma e zakone prapanike që pengonin zhvillimin dhe thellimin e demokracisë socialiste në jetën shoqërore dhe në familje.

Në mbledhje e në kuvende të gjera, që u organizuan në të katër anët e vendit, të rinj e të reja, burra e gra, pleq e plaka dënonin me guxim zakonet dhe pikëpamjet konservatore, patriarkale, feudale e borgjeze, besimet fetare e kanunet mesjetare, që kishin shërbyer si mjet për skllavërimin e masave e sidomos të gruas shqiptare. Ato me urrejtje flisnin për zakonet e shëmtuar të fejesave qysh në fëmijëri, të martesave me ndryshim të madh moshe, të trajtimit të gruas si njeriu i fundit në familje etj. Vetëm gjatë kuvendeve të organizuara nga populli në rrethet Tropojë, Kukës, Peshkopi, Shkodër, Lezhë, Mirdi-

të, Krujë, Tiranë, Elbasan, Librazhd, Gramsh, Vlorë, Gjirokastrë etj. u prishën me mijëra fejesa të tilla të bëra në moshë të mitur.

Të gjitha këto veprime revolucionare janë kalime cilësore që e hodhën njeriun nga një botëkuptim i vjetër, i ndrydhur, i kalbur, në një botëkuptim të ri socialist, ku njeriu e ndjen veten zot të shoqërisë, qenie të lirë aktive, që vepron me ndërgjegje për ndërtimin e jetës së re dhe të lumtur në vendin tonë.

Është krejt e natyrshme që lufta për zgjerimin dhe thellimin e demokracisë socialiste në jetën tonë shoqërore të depërtojë edhe në kuptimin e drejtë të lidhjeve martesore. Socializmi krijon mundësi që njerëzit të vendosin lirisht për veten e vet dhe të kenë të drejta të barabarta midis tyre, prandaj në socializëm, liria e plotë e martesave mund të bëhet një realizim i përgjithshëm, sepse aty janë zhdukur të gjitha arsyet ekonomike që, siç u përmend, luanin një rol shumë të rëndësishëm në zgjedhjen e bashkëshortit.

Një nga pasojat më të rëndësishme të shndërrimit socialist të shoqërisë sonë për fatet e familjes, është përhapja e martesës socialiste, që mbështetet në dashurinë e lirë reciproke të burrit dhe të gruas.

Martesa në shoqërinë tonë është një bashkim i lirë, i vullnetshëm dhe i qëndrueshëm i një burri dhe i një gruaje, që bazohet në barazinë e plotë të të drejtave, në dashurinë, në ndihmën dhe në respektin reciprok të bashkëshortëve. «Partia, ka thënë shoku Enver, e ka përcaktuar vijën marksiste-leniniste të një martese me të vërtetë të shëndoshë, të qëndrueshme, në bazë të njohjes, të pëlqimit të lirë e të hapët të çiftit, të sinqeritetit dhe të një dashurie të pastër e të zjarrtë proletare në mes të të riut dhe të së resë»¹.

Duke vënë në jetë orientimet e Partisë dhe mësimet shumë të vlefshme të shokut Enver Hoxha për lidhjen e martesave mbi baza të reja socialiste, tani bien në sy fenomenë të reja që po lindin, zhvillohen e forcohen në

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime (1969-1970), f. 143.

krijimin e familjes së re. Vajzat dhe djemtë tanë mësojnë së bashku, punojnë së bashku, marrin pjesë në aktivitetet e ndryshme politike, kulturore e artistike, në aksione lokale e kombëtare, kanë mundësi të njohin më mirë njëri-tjetrin, të bisedojnë, të miqësohen, të dashurohen dhe të martohen. Njohja, dashuria e pastër dhe e singërtë midis të rinjve, përbën bazën e krijimit të familjes së re në shoqërinë tonë.

Tek ne po vërtetohet më së miri parashikimi i Engelsit që thoshte se vetëm në shoqërinë socialiste lind një brez burrash që nuk do të kenë kurrë rast në jetën e tyre të blejnë gruan me para ose me mjete të tjera të pushtetit shoqëror, dhe një brez grash që nuk do të kenë kurrë rast t'i jepen një burri për arsye të tjera përveçse nga dashuria e vërtetë.

Dashuria, si bazë e martesës, po kthehet gjithnjë e më shumë në një kriter sundues të opinionit shoqëror, si në popullsinë qytetare edhe në atë fshatare.

Duke vlerësuar lart rolin e martesës së re socialiste, shoku Enver Hoxha thotë: «Në rrugën e Partisë ne duhet të kuptojmë ç'është dashuria proletare. Kur një djalë i ri o një vajzë simpatizohen e më vonë dashurohen, sigurisht shkojnë drejt martesës, prandaj gjatë kësaj kohe, ata duhet të njohin mirë njëri-tjetrin, po për çimentimin e dashurisë së tyre me ndjenjat e pasionet duhet të gërshetohet edhe arsyeja. Prandaj shokun e jetës, njeriu duhet ta vlerësojë nga shumë pikëpamje, të ketë ndjenja të pastra dashurie për të, ta vlerësojë nga pikëpamja e ndershmërisë, e dashurisë ndaj atdheut, popullit dhe Partisë. Po të gjejnë te njëri-tjetri këto cilësira, vajza dhe djali le të duhen pastaj në mes tyre me zjarr dhe pasion në rrugën e drejtë proletare»¹).

Të dhëna të ndryshme tregojnë se kudo në Shqipëri, martesat me dashuri zë vend të rëndësishëm. Kjo dukuri është më e theksuar në qytetet dhe, në këtë drejtim, tonin e jep klasa punëtore, e cila ka krijuar një qartësi më të plotë dhe një mendim më revolucionar për sa i përket

1 Enver Hoxha. Raporte e fjalime (1969-1970), f. 171.

lidhjes së martesës. Kjo tregon se në klasën e re punëto-re është forcuar opinioni shoqëror, i cili tani më shumë se më parë, i dënon konceptet e shfaqjet negative dhe përkrah fenomenet e reja edhe në lidhjet martesore.

Numri i lidhjeve martesore mbi bazën e njohjes dhe të dashurisë së vërtetë ka ardhur vazhdimisht duke u rritur. Duke e kuptuar martesën si një bashkim të vullnetshëm të një burri e të një gruaje, si një çështje që i takon të vendosë në radhë të parë djali dhe vajza, të rinjtë tanë ngrejne familjet e reja duke u mbështetur në vullnetin e lirë të tyre.

Është krijuar një botëkuptim më i gjerë mbi familjen si pjesë e pandarë e shoqërisë, që frymëzohet dhe udhëhiqet nga idealet e revolucionit. Lumturinë bashkëshortore çifti i ri po e gjen në punën edhe në luftën e përbashkët për lumturinë e përgjithshme. Po bëhen gjithnjë e më të shpeshta martesat pa pajë e stoli, të zhveshura nga nënshtrimet e pronës private dhe të psikologjisë së saj, nga egoizmi, nga llogaria dhe nga çdo lloj përfitimi material ose moral. Në luftë kundër liberalizmit, «dashurisë së lirë» dhe mendjelehtësisë është krijuar e po konsolidohet koncepti revolucionar mbi domosdoshmërinë e lidhjeve të forta serioze dhe të qëndrueshme martesore.

Sigurisht veçoria e martesës në vendin tonë, si një bashkim i lirë i një burri dhe i një gruaje, si dhe kushtet e tjera që kërkohen me rastin e lidhjes së martesës nuk zbatohen kudo njëjloj. Ato ndryshojnë nga një qytet në tjetrin, nga njëra krahinë në tjetrën, ato ndryshojnë gjithashtu në klasën punëtore, në fshatarësinë punonjëse dhe në shtresa të tjera të shoqërisë. Madje edhe brenda tyre ka ndryshime, nganjëherë edhe të ndjeshme.

Për të parë më konkretisht këtë çështje, po bëjmë karakterizimin e martesave të sotme.

Si u tha, shumë nga të rinjtë punëtorë, lidhur me këtë ngjarje të rëndësishme të jetës, shprehin vullnetin e tyre të lirë. Kështu që në mjaft qendra pune e prodhimi, martesat me njohje direkte të bashkëshortëve, zënë vend të rëndësishëm.

Por shfaqja e vullnetit të lirë nuk është krejt e zhve-

shur nga ndikimet e personave të tjerë dhe sidomos të prindërve dhe të rrethit familjar. Në këtë rast, këshillat e prindërve dhe të afërmeve të tjerë, ndihma e rrethit shoqëror, përkrahja e tyre, janë të nevojshme. Duke pasur përvojën e jetës prindërit synojnë që djali dhe vajza të marrin një bashkëshort sa më të mirë dhe përpiqen të japin kontributin e tyre në këtë çështje jetike e të rëndësishme për fëmijët e tyre.

Por me gjithë të përgjithshmen pozitive, që është ti-pike, ka ende shfaqje e veprime konservatore që ndrydhin dëshirat e të rinjve, veçanërisht të vajzave, për të zgjedhur vetë shokun e jetës. Këto shfaqje janë më të theksuara në kategorinë e punëtorëve me prejardhje nga fshati dhe që banojnë në fshat, në familjet e punëtorëve të ndërmarrjeve bujqësore etj. Në këto familje, fuqia e «sundimit» patriarkal të «zotit» të shtëpisë ndaj fëmijëve dhe sidomos koncepti prapanik i së drejtës së prindërve që të çmojnë e të vendosin vetë mbi martesën e fëmijëve të tyre, është ende i dukshëm.

Fëmijët e këtyre prindërve, veçanërisht vajzat e reja, i ndrydhin ndjenjat, e mbajnë të fshehur dashurinë dhe nuk guxojnë t'ua tregojnë prindërve. Kjo, në ndonjë rast, i shtyn të bëjnë edhe veprime të nxituara e të papjekura. Dhe këto veprime janë pasojë që rrjedhin nga mospranimi i dashurisë prej disa prindërve. Pranimi i dashurisë i shpëton të rinjtë nga gënjeshttrat, i bën ata të çiltër e të sigurtë, ballëhapur e të guximshëm për ta thënë me kohë atë çfarë ndiejnë. Frika prej dashurisë i shtyn disa të reja që kur ndonjë i ri u shfaq ndjenja të tilla, ato t'i drejtojnë te prindërit.

Fuqia e «sundimit» patriarkal të prindërve ndaj fëmijëve shfaqet edhe në shtresat e tjera të banorëve të qytetit. Ka prindër që u imponojnë fëmijëve të zgjedhurin e tyre për bashkëshort nga «frika» se djali e veçanërisht vajza, mund të gabojnë në jetë. Shoku Enver Hoxha thotë se prindërit nuk duhet t'i bëhen pengesë djalit apo vajzës për zgjedhjen e bashkëshortit të vet. «Konservatori që mundohet shumë nga pikëpamjet e vjetra, nuk ka besim te vajza, ai ka frikë se burri që marto-

het me bijën e tij me dashuri, më vonë do ta braktisë dhe pastaj mbi familjen do të rëndojë «barra e turpit për bijën e kthyer». Ndërsa për djalin është fakt se konservatorët kanë konsideratë, ai mund të ndajë disa gra dhe kjo gjë mund të harrohet, sepse opinioni shoqëror akoma i paformuar mirë nuk ka kërkesa morale të barabarta si për djalin edhe për vajzën»¹.

Prandaj Partia dhe shoku Enver vzhdimisht kanë ngritur çështjen që në çdo familje të punohet politikisht, që prindi ta trajtojë të bijën jo si një krijesë të bindur ndaj rreptësisë së pushtetit atëror, por si shoqe, duke u futur së bashku me të në diskutimin e problemeve politiko-ideologjike, kulturore, morale etj., e atëherë vajza do të jetë e zonja ta zgjedhë vetë shokun besnik të jetës.

Në këtë drejtim është bërë dhe po bëhet një punë e madhe edukative me prindërit dhe sidomos me të rinjtë, që këta të fundit të mos pajtohen me asgjë konservatore dhe reaksionare që prek vullnetin e tyre të lirë në zgjidhjen e një çështjeje kaq të rëndësishme për jetën e tyre. Kjo nuk do të thotë që të rinjtë nuk duhet të marrin mendimin e prindërve, përkundrazi, ata duhet të këshillohen me ta dhe pastaj të vendosin për t'u fejuar. **Ka pasur raste që djali ose vajza, pa u njohur mirë, i jepnin fjalën njëri-tjetrit se do të fejojeshin pa u këshilluar me prindërit.**

Në këto raste, në zgjedhjen e shokut ose të shoqes së jetës, nisen nga cektësia e ndjenjave, tërhiqen pas bukurisë së jashtme etj. Ky motiv qëndron shumë larg motiveve të dashurisë së vërtetë. Pasioni, vinte në dukje Engelsi, është forma e lartë e prirjeve seksuale, por nuk përfaqëson ende dashurinë bashkëshortore. Kjo cektësi ndjenjash është e mbarsur edhe me rrezikun e shkeljes së besnikërisë bashkëshortore. Prandaj shfaqjeve të tilla u duhet bërë një barrikadë e fortë derisa të mos ndodhin dukuri të kësaj natyre.

¹ Enver Hoxha. Raporte e fjalime (1972-1973), f. 129.

* * *

Numri i lidhjeve martesore i bërë mbi bazën e njohjes dhe të dashurisë ka ardhur duke u rritur edhe në fshatarësinë kooperativiste. Dhe kjo jo vetëm në zonat e atyre rretheve që kanë pasur një zhvillim ekonomik, shoqëror dhe kulturor-arsimor më të lartë si në ato të Korçës, të Kolonjës, të Gjirokastrës (zona e Zagorisë, e Lunxhërisë, e Dropullit), të Vlorës, (Bregdeti i Himarës), të Sarandës (Bregdeti i Sarandës, zona «Partizani»), të Fierit (zona e Semanit) dhe fshatra të tjera të veçanta, por edhe në ato krahina ku mbeturinat e zakoneve prapanike kanë qenë më të theksuara. Kështu, p.sh., në Zadrinë gati 40% e martesave të bëra gjatë viteve 1969-1973, janë lidhur duke pasur si pikënisje miqësinë dhe simpatinë e djalit dhe të vajzës. Po gjatë këtyre viteve në 5 fshatra të Tepelenës, një e katërta e lidhjeve martesore janë bërë mbi bazën e dashurisë. Në 8 fshatra të rrethit të Durrësit nga 148 martesat të lidhura gjatë vitit 1975, 48 prej tyre janë bërë me dashuri, ndërsa nga 85 martesat në 7 fshatra të rrethit të Tepelenës të lidhura po në këtë vit, 30 prej tyre janë bërë me dashuri. Në Kooperativën e Bashkuar të Krutjes (Lushnjë) nga 240 martesat të bëra gjatë pesëvjeçarit të gjashtë (1976-1980), 140 prej tyre janë lidhur me dashuri. Edhe në Martanesh (Mat), ku në të kaluarën zakonet prapanike kanë qenë më të theksuara, nga 164 martesat, po gjatë kësaj periudhe, 139 janë lidhur me njohjen direkte të të rinjve. Shembuj të tillë ka me qindra të tjerë nga gjithë zonat fshatare të vendit tonë. Natyrisht, ata që kanë çarë më tepër në këtë drejtim janë të rinjtë e të rejtat që kanë marrë pjesë në aksione, aktivistët më të dalluar të organizatës së rinisë, inteligjencia e fshatit etj.

Përvëç martesave që lidhen me njohjen direkte të të rinjve, vend të rëndësishëm zënë edhe martesat me ndërmjetësi. Kjo është një fazë kalimtare nga shkuesia në njohjen direkte të atyre që martohen. Në këto raste, ndërmjetës bëhet një i afërt i djalit apo i vajzës, shoku ose

miku i tyre, që ndërhyjnë për njohjen e dy të rinjve.

Zakonisht ndërmjetësi, që merr përsipër një punë të tillë, u krijon mundësi dy të rinjve që të njihen me njëri-tjetrin, të bisedojnë dhe të vendosin për fejesë. Kjo rrugë sigurisht është një hap përpara, veçanërisht kur rekomandimi përdoret me të vërtetë për njohjen e të rinjve, por jo gjithmonë i hap rrugën martesës me dashuri. Në disa raste, ndërmjetësi caktohet nga prindërit e djalit. Madje ka shembuj kur prindërit, në ndonjë fshat, pasi e kanë përfunduar fejesën, vënë në dijeni djalin dhe vajzën dhe pastaj organizojnë takimin në klub ose në ndonjë vend tjetër. Në pamje të jashtme kjo fejesë duket diçka e përparuar, por, në të vërtetë, është e prapambetur; ajo nuk ndryshon thelbin e zakonit të vjetër, sepse kjo njohje nuk është veç njohje nga «kashta». Në fakt ky është njëfarë lëshimi që i është bërë zakonit të vjetër, një kompromis me forcat patriarkale konservatore të fshatit.

Por pavarësisht nga rastet negative që vihen re, është fakt i pamohueshëm se në vendin tonë martesë e lidhur me iniciativën e të rinjve, me njohje direkte të tyre, martesë me dashuri, është tipike.

Edhe martesë që lidhet me ndërhyrjen e prindërve dhe me pëlqimin e të rinjve, zë një vend të rëndësishëm në numrin e përgjithshëm të lidhjeve martesore. Por duhet thënë se ndërsa forma e parë, ajo e martesës me dashuri, vjen duke u shtuar, martesë me iniciativën e prindërve po pakësohet nga viti në vit.

* * *

Në lidhjet e sotme martesore, pozitiv është fakti se është thyer në masë ekzogamia. Kjo gjë vihet re edhe në ato rrethe ku këto ndalesa ishin mjaft të theksuara, si: Shkodër, Lezhë, Mirditë, Mat, Pukë, Librazhd, Tepele e etj.

Të shumta janë gjithashtu edhe martesat që bëhen brenda kooperativës e fshatit, që edhe këto në të kaluarën në disa krahina kanë qenë të kufizuara.

Duke iu referuar të dhënave shihet se kudo ka arritje pozitive. Në rrethin e Librazhdit 90 për qind e martesave që janë bërë vitet e fundit janë lidhur brenda fshatit dhe kooperativës së bashkuar. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për rrethet e Pogradecit, të Tiranës, të Durrësit etj. Megjithatë ka ende rrethe, veçanërisht në Veri, ku martesat brenda fshatit janë akoma të kufizuara.

Në kushtet e ndërtimit me sukses të shoqërisë socialiste, ku zhvillohet industria dhe bujqësia moderne, ku është përhapur kudo arsimi dhe kultura socialiste etj., ka edhe një zhvillim dhe një lëvizje të harmonishme të popullsisë. Me mijëra fshatarë kanë zbritur dhe janë bërë punëtorë në uzinat, në kombinatet dhe në minierat tona, shumë punëtorë dhe punonjës të tjerë kanë lëvizur nga një qytet në një tjetër, atje ku e kërkojnë interesat e atdheut. Por një rol të madh pozitiv në futjen e së resë përparimtare në jetën e fshatarësisë sonë luan edhe lëvizja për të shkuar për banim të përhershëm nga qyteti në fshat. Kjo jo vetëm ngushton dallimin midis fshatit dhe qytetit, po ka rëndësi të madhe edhe për rrënjosjen e zakoneve të reja në jetën e fshatit tonë. Si rezultat i këtyre lëvizjeve është thyer koncepti që vajza dhe djali duhet të martohen brenda krahinës apo qytetit të tyre dhe me një kategori të caktuar njerëzish. Tani njerëzit tanë të rinj shikojnë më larg fshatit, krahinës apo qytetit të lindjes. Shqipëria socialiste, si për shumë probleme të tjera të jetës, është bërë e të gjithëve, edhe në kuptimin e martesave jashtë rrethit dhe jashtë normave tradicionale të mëparshme.

Në aksionet e rinisë, si në atë të Bregdetit të Sarandës dhe në fshatrat e banuara me të rinj të ardhur nga qyteti si në Radovë (Kolonjë), në Lipivan (Përmet), në Povelçë dhe në Hoxharë (Fier), etj. ka shumë martesat e reja, që kanë thyer të gjitha pengesat tradicionale.

Në kohën tonë të shumta janë martesat që bëhen midis njerëzve të shtresave e të kategorive të ndryshme. Në Zejmen, p.sh., 25 për qind e martesave gjatë viteve 1963-1973, janë lidhur midis kooperativistëve, intelektualëve e punëtorëve. Në Shkodër 20 për qind e këtyre mar-

tesave po gjatë këtyre viteve janë bërë midis punëtorëve e intelektualëve, ndërsa 24 për qind midis qytetarëve e fshatarëve. Vetëm në zonën e Bushatit (Shkodër) gjatë vitit 1975 u martuan 15 vajza nga qyteti me djem kooperativistë. Në kombinatin e tekstileve «Stalin» martesat midis punëtorëve, intelektualëve dhe fshatarësisë gjatë tre vjetëve (1970-1972) përbënin 50 për qind të numrit të përgjithshëm të martesave.

Hapa të mëdhenj pozitivë janë bërë edhe në drejtim të luftës kundër dallimeve fetare në lidhjet martesore. Nën ndikimin e faktorëve ideologjikë, politikë, ekonomikë, shoqërorë zhvillohet në mënyrë ritmike fenomeni i martesave midis personash nga ish-fe të ndryshme. Martesa të tilla bëhen në të gjitha rrethet e Shqipërisë, në të gjitha krahinat etnografike të veçanta, pavarësisht nga fakti se diku duken në numër më të madh e diku tjetër në numër më të vogël.

Martesa të tilla nga viti në vit vijjnë duke u rritur. Edhe në këtë drejtim rolin pararojë e ka luajtur klasa punëtore ku në numrin e përgjithshëm të lidhjeve martesore ndërmjet personave me ish-fe të ndryshme përqindja më e madhe u takon punëtorëve.

Zhvillimi i fenomenit që ka të bëjë me martesat e përziera ka lidhje të ngushtë me martesën me dashuri. Nga të dhëna të ndryshme, rezulton se në përgjithësi martesa të tilla janë bërë me dashuri me njohje direkte të çiftit. Kështu, në rrethin e Tropojës nga 856 martesa që janë lidhur gjatë viteve 1969-1973, 207 prej tyre janë bërë në mes personash me ish-besime të ndryshme dhe të gjitha janë lidhur me njohjen direkte të të rinjve. Po kështu mund të përmendim Kukësin, Pukën, Librazhdin, Lezhën etj.

Në vazhdim të traditës, para se të lidhet martesa bëhet fejesa.

Në përgjithësi, fejesa, lidhet në një moshë të caktuar.

Në të kaluarën, para Çlirimit, moshë e fejesës ndryshonte nga njëra krahinë në tjetrën, madje nuk mungonin edhe fejesat në vegjëli. Raste të tilla në kohën tonë janë të rralla bile edhe në ato zona ku fejesat, sipas traditës, bëheshin në moshë të vogël.

Tani fejesat bëhen në një moshë të arsyeshme. Dhe kjo jo vetëm në qytet por edhe në fshatrat më të largëta. Duke iu referuar të dhënave të vitit 1979 shihet se pjesa më e madhe e djemve, 42 për qind në qytet, martohen në moshën 25-29 vjeç, kurse në fshat 20-24 vjeç. Ndërsa përqindjen më të madhe të martesës së vajzave (56.7 për qind) e zë moshë 20-24 vjeç dhe 29.3 për qind moshë deri në 19 vjeç.

Nga studimet e bëra del se në vendin tonë shumica e martesave në kohën e tanishme lidhen në moshën midis viteve 20-30 për të dyja sekset. Ndryshime të ndjeshme vihen re edhe në rrethe të tilla, ku vite më parë moshë e martesës ka qenë shumë e re, sidomos ajo e vajzave. Kështu në rrethin e Lezhës, në vitet 1969, 1970, 1971, moshë mesatare e martesës për vajzat ka qenë 20 vjeç, ndërsa në vitet 1972, 1973 u ngrit në 21. Në Librazhd, në Dibër e në Shkodër, në këto dy vjet, moshë mesatare ishte 20 vjeç dhe në Tepelenë 30 për qind e vajzave që lidhën martesë ishin mbi moshën 20 vjeç.

Kjo është një tendencë pozitive, sepse përgjithësisht koha më e përshtatshme e martesës është midis viteve 20-30 për të dyja sekset, moshë në të cilën është fituar pjekuria e nevojshme për të ndërtuar familjen e re mbi baza të shëndosha.

Një shprehje tjetër e përparimit të lidhjeve të martesave është edhe synimi drejt zvogëlimit të diferencës së moshës midis burrit dhe gruas, duke iu referuar një mesatareje më normale, karakteristike për familjen sociale.

Arritje pozitive vihen re edhe në drejtim të shkëmbimit të nishaneve dhe të pajës. Tani, gjithnjë e më shumë, cilësitë e vajzave e të djemve, nuk maten nga sasia e plaçkave që bëjnë, nga paja, por nga qëndrimi i tyre moral-politik, nga devotshmëria e tyre në luftë

për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Por me gjithë përparimet që janë shënuar në disa raste, shenja dhe paja zënë vend në karakterin e lidhjeve martesore.

Nuk është e thënë, p.sh., që djali të jetë «i detyruar» t'i blejë vajzës medoemos orë dore, ose rroba të tjera të shtrenjta, kur këmbehen nishanet, ose të çojë edhe dhurata për të afërmit e saj. Po kështu as vajza nuk është mirë t'i blejë djalit në këtë rast një numër të caktuar plaçkash dhe dhuratash për njerëzit e tij. Aq më keq që në disa fejesa përdoret ende unaza, një mbeturinë kjo e së kaluarës.

Kështu mund të themi edhe për pajën. Ka raste si në qytete apo në fshatra që nusja duhet të vijë patjetër me pajë, pa marrë parasysh se sot në pushtetin popullor janë krijuar kushte të tjera ekonomike dhe djali e vajza, duke qenë në marrëdhënie pune, kanë mundësi të krijojnë familjen e tyre të re mbi baza reciproke.

«Të luftosh idenë e pajës për vajzën, siç kuptohej e praktikohet në të kaluarën, thotë shoku Enver Hoxha, kjo është shumë e drejtë dhe duhet të vazhdohet kjo luftë, por që ta ndalosh prindin t'i bëjë asaj dy palë rroba, një krevat e diçka tjetër, kjo s'është e drejtë. Por, në këtë rastin e fundit, kur këto reklamohen me bujë dhe nxitin ndjenjat e çdo vajze që të sjellë pajë te burri, se ndryshe ai nuk e merr... , kjo duhet luftuar»¹.

Është e nevojshme që vetë të rinjtë e të rejat, duke u udhëhequr nga mësimet e Partisë e të shokut Enver Hoxha, të luftojnë për të krijuar familje sa më të shëndosha, me mundin dhe kontributin e tyre të përbashkët, duke luftuar çdo tendencë të tepruar për pajë.

¹ Enver Hoxha, Raporte e fjalime (1965-1966), f. 153.

CEREMONIALI I DASMËS PAS ÇLIRIMIT

Ndryshimi i motiveve të lidhjeve martesore pas Çlirimit ka ndikuar në mënyrë të ndjeshme edhe në ceremonialin e dasmës, duke ia nënshtuar këtë një procesi të thellë shndërrimi. Janë kristalizuar ceremoni të reja, ndonëse disa prej tyre ende nuk kanë marrë formën e plotë e nuk janë përhapur kudo.

Dasma, si një institucion shoqëror e familjar, do të vazhdojë të ekzistojë. Krahas trashëgimit pozitiv të së kaluarës, ajo do të pasurohet edhe me elemente të reja që do t'i përgjigjen zhvillimit të shoqërisë sonë. «...dasma — thotë shoku Enver Hoxha — nuk është një zakon i keq, përkundrazi, është një gëzim i madh për çiftin që martohet, për të gjithë njerëzit e shtëpisë, për miqtë dhe shokët e tyre»¹).

Dhe sot, në realitetin tonë socialist, organizohen dasma të reja që i përgjigjen zhvillimit të shoqërisë sonë dhe shprehin marrëdhëniet e barabarta ndërmjet burrit e gruas.

Në dasmat e sotme vihen re ndryshime thelbësore, që i dallojnë ato në mënyrë cilësore nga dasmat tradicionale. Ato kanë si prirje të përgjithshme thjeshtimin e strukturës së organizimit dhe heqjen dorë nga ceremonitë për ditët e veçanta të dasmës, mospërdorimin e shumë ceremonive që kanë lidhje me nusen dhe dhëndrin

¹ Enver Hoxha. Mbi problemin e gruas, Tiranë, 1973, f. 286.

etj. Gjithashtu, përgatitjet për dasëm janë thjeshtuar mjaft.

Dasmat e reja bëhen në kohë të ndryshme të vitit, veçanërisht në periudhën e verës, kur çifti i ri e kalon lejen e zakonshme në shtëpitë e pushimit të punëtorëve e të nëpunësve ose në hotelet turistike. Kjo prirje është më e theksuar për qytetet. Në fshat, në vazhdim të traditës, shumica e dasmave bëhen në vjeshtë, pas përfundimit të punëve kryesore bujqësore.

Atmosfera festive e dasmës fillon disa ditë përpara. Gjatë kësaj kohe bëhen vizita nga të afërmit, miqtë, shokët dhe shoqet e nuses dhe të dhëndrit. Sot gëzimi dhe hareja ndihen si në shtëpinë e djalit, ashtu edhe në shtëpinë e vajzës. Shoqet e nuses mbledhen pas pune, ndihmojnë atë dhe familjen në përgatitjet e fundit.

Në dasmë marrin pjesë anëtarët e familjes, farefisi, miqësia dhe në disa raste edhe kolektivi i qendrës së punës, anëtarët e brigadës së vajzës apo të djalit, shokët e shoqet e tyre. Ky është një zakon i ri, me përmbajtje ideologjike e shoqërore të shëndoshë, që e ka nxjerrë dasmën nga kuadri i ngushtë familjar dhe e ka vendosur në një kuadër më të gjerë shoqëror.

Në qendër të ceremonialit të dasmës janë nusja e dhëndri, të cilët, ndryshe nga e kaluara, marrin pjesë aktive në këtë ngjarje të rëndësishme të jetës së tyre. Madje, dhëndri, që deri vonë në zonat me elementë të ish-besimit mysliman (Golaj, Bicaj, Trebisht, Xibër, Zhej, Shëngjergj, Hasdushk, Kurjan, Bolenë, Lekdush, Tunjë, Belsh, Bërzeshtë, Konispol etj.) dhe në disa zona të ish-besimit katolik (Theth, Vrith, Kthellë, Kallmet etj.) nuk shkonte në shtëpinë e vjehrrit, sot shkon për të marrë nusen, së bashku me të afërmit e tij, me shokët e shoqet.

Por, padyshim, problemi kryesor në ceremonialin e dasmës së sotme është vendi që zë nusja në të.

Tani nusja nuk shkon në shtëpinë e burrit me duvak, por fytyrzbulluar, e veshur thjesht e bukur. Madje, në ato krahina ku ruhen kostumet popullore, ajo vishet me to, duke ruajtur kështu traditat pozitive të popullit tonë. Duke folur për këtë problem, shoku Enver



Të porsa fejuar (Myzeqe)

Veshje nuseje mirditore



Arritja e nuses — Gurëz (Krujë)



ka thënë: «Po çfarë na prish ne dëshira e një vajze, që kur të martohet, do të veshë një kostum të bukur popullor...? Kjo nuk na prish punë, përkundrazi, na ndreq, se na ruan traditat. Ne s'kemi turp nga kostumet tona kombëtare, përkundrazi, mburremi me to, ato janë të bukura»¹.

Nusja tani ka pozitë të barabarta me burrin. Ajo ulet në krye të tryezës bashkë me dhëndrin. Në vendet e nderuara në tryezë dhe kudo në dasmë, vihen njerëzit e respektuar nga shoqëria, si: kuadro partie e pushteti, veteranë të luftës e të punës, bujq, punëtorë e intelektualë të dalluar etj. dhe nuk ndiqet zakoni i «shtëpisë së parë».

Ndryshime cilësore kanë pësuar edhe urimet e martesës, të cilat të zhveshura nga petku fetar e patriarkal, bëhen në pajtim me moralin tonë socialist. Dollia e parë tani ngrihet për Partinë dhe shokun Enver, për çiftin, për prindërit dhe për të ftuarit e tjerë.

Atmosferën festive të dasmave të reja e ngre edhe repertori i këngëve dhe i valleve popullore. Krahas këngëve tradicionale, vihen re elemente folklorike me brendi të fuqishme socialiste dhe një përdorim i gjerë i këngëve të bukura të muzikës sonë të lehtë. Kjo gjen shprehjen në një anë, në braktisjen e këngëve dhe të melodive sentimentale e vajtuese dhe, nga ana tjetër në zëvendësimin e tyre me këngë e valle optimiste e dinamike, që kanë tekste të zjarrta e plot lirizëm për shndërrimet socialiste, për jetën e re, për Partinë e për shokun Enver Hoxha. Këngët që shprehin marrëdhëniet e reja martesore zënë një vend të rëndësishëm në dasmat:

*«Le të dridhet vallja,
Dridhe, moj, shaminë,
Se në vend të shkesit,
Vumë dashurinë».*
«Këndona, moj nuse,

1 Enver Hoxha, Raporte e fjalime (1965-1966), f. 152.

Nuse moj këndona,
Se u zhduk e vjetra,
Nga gëzimet tona».

Me vargje të goditura i këndohet vendit të punës,
ku djali dhe vajza, duke punuar së bashku, dashurohen
dhe vendosin të martohen:

«Atje në brigadë,
Unë u miqësova.
Dhe një belhollë
Unë e dashurova.
Djali e ka njohur,
Në punë e ka zgjedhë,
Lumturinë e tyre,
Vetë e kanë mbjellë».

Një numër i madh këngësh i kushtohet nuses së re,
«brigadierës së arave», që i ka rënë «nuri i fushave», ose
«punëtores së rendimenteve të larta», që është «e shpejtë
si flutur».

«Ç'ra kjo ditë e bardhë,
Si mijëra të tjera,
Dielli pa dalë,
Ti dole te dera.
U mblodh gjithë fshati,
Kush për ty s'këndon,
Me këngë të stolisin,
Brigadierja jonë.
Ç'nur sot të ka rënë
Nuri i fushave
Ndaj ka hije dasma,
Ndaj gëzojmë ne.
Lum si ti, moj lule,
Që të zgjodha unë,
E para në shoqe,
Flutur je në punë».

Ndryshe nga e kaluara, këngët dhe vallet këndohen e kërcen tok, në një mjedis të përbashkët e jo të ndara gratë nga burrat.

Ndryshime jo të pakta janë bërë edhe në ceremonitë e shumta që bëheshin pas dasmës, të cilat sot janë kufizuar në mënyrë të ndjeshme. Tani po përhapet një dukuri e re. Nusja fshatare pas pak ditësh del në punë. Kjo e gjen shprehjen edhe në krijimtarinë e re popullore: «Të shtunën në punë,/ të dielë u martove,/ të hënë në mëngjes/prapë në punë shkove./ Hej, moj nuse re,/ sa e bukur je».

Këto dukuri të përgjithshme që, me ndryshime të vogla, shfaqen kudo në vendin tonë, përbëjnë përmbajtjen e re të dasmës shqiptare, që nga viti në vit vjen duke u konsoliduar dhe duke u pasuruar me elemente të reja. Por kjo nuk do të thotë se në disa dasma nuk shfaqen akoma elemente prapanike të së kaluarës. Nuk është e nevojshme, p.sh., që të bëhen dasma me shpenzime të shumta dhe të ftohen qindra njerëz, siç ndodh shpesh në qytet e në fshatra.

Fshatari ynë «...kur bën dasmë, ther tri qe, thotë shoku Enver Hoxha, duke shkatërruar kështu ekonominë... E përse të therësh 5 dele? Jepu miqve një karamele, llokume ose pastë, apo ndonjë gotë raki sa të të urojnë, të këndojnë, të hedhin valle dhe të gëzojnë të gjithë së bashku. Edhe darkë do të bëjë ai që martohet, se kjo është një ngjarje me rëndësi në jetën e njeriut, por të ftojë vetëm njerëzit më të afërt»¹.

Në dasmat e sotme, krahas ceremonive të reja, mund të përdoren edhe ato ceremoni tradicionale pozitive, që janë krijime të masave të gjera popullore dhe që, për kohën tonë, duke u dhënë një përmbajtje të re, do t'i përgjigjen realitetit socialist e do t'i japin dasmës atmosferë akoma më festive.

Duke u zhveshur ceremoniali i dasmës nga ato rite e ceremoni, që janë ndikime të huaja dhe që janë futur nga klasa shfrytëzuese dhe nga feja, në të ruhen eleme-

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 18, f. 347-348.

nte popullore që përfaqësojnë vlera të mirëfillta të kulturës së popullit tonë dhe që janë përbërëse të fizionomisë kombëtare. Të tilla janë, p.sh., ceremonitë që kanë të bëjnë me pjellorinë, me begatinë, me lumturinë e çiftit të ri, me lojërat e ndryshme, me humorin popullor etj. Futja në dasëm e muzikës dhe e këngëve me përmbajtje jo të mirë e shëmton ceremonialin e dasmës. Po kështu edhe vallet që luhen në dasma të jenë të bukura e të larmishme, të pasqyrojnë botën e brendshme e të dëlirë të popullit tonë.

Zhvillimi i marrëdhënieve martesore është një proces i përhershëm. Ky zhvillim karakterizohet nga ekzistenca e një lufte të ashpër klasore që përfshin të gjitha fushat e jetës. Me gjithë sukseset e mëdha në këtë drejtim, jemi akoma në një fazë kalimtare, kur s'ka përfunduar ende procesi i krijimit të martesës dhe të familjes socialiste në të gjithë shoqërinë. Lufta për forcimin e mëtejshëm të përmbajtjes dhe të formës socialiste të martesës është një detyrë e përhershme dhe e vazhdueshme.

KËNGË DHE VALLE RITUALE TË DASMËS

Zënia e vajzës

U ruaj mos dil te porta

*U ruaj, mos dil te porta,
O moj moll'e bukurë,
moll' e pakëputurë.
Se shkon N. N. atje,
Pa të sheh e s'të pëlqen,
O moj moll' e bukurë,
moll' e pakëputurë.
Dhe s'të merr në Dh. N. trimnë,
O moj mollë' e bukurë,
moll' e pakëputurë.*

Do të marr, vllastar i gjatë

*Do të marr, vllastar i gjatë,
Do të të marr.*

Do të të marr të dielën ndajnatë,
Do të të marr.
Pa bënem yll, e hynj ndë retë,
E s'më merr dot.
Un' bënem hënë vinj e të ndjek,
Do të të marr.
Do të të marr, o yll i dritës
Të dielënë nga mes' i ditës.

N. N. mor ogiç

— N. N. mor ogiç,
Si u ndave me ato miq?
— Un u ndava si qe adeti,
Lezet kishte muhabeti,
U pi kafja e sherbeti.

Bie vdora resha - resha

Bie vdora resha-resha,
Mirserdhët, moj mikeshal
Moj fëllanx' e malit-o,
zgjodhe bashn' e djalit-o;
Djalin që e deshnje vetë,
Trandafil në këtë jetë.
Or pëllumb i fushës-o,
zgjodhe bashn' e cucës-o;
cucën që e zgjodhe vetë,
Trandafil në këtë jetë!

Sheg' e ambël, sheg' e butë

Sheg' e ambël, sheg' e butë,
Më shkoi vera pa t'këputë.

Shegë e ambël ku je rritë?
Se me ty do t'shkoj të ritë.
Shegë e ambël ku je shegë,
Se me ty unë due me ndejë.
Shegë e ambël ku je pjekë,
Se me ty unë due me dekë!
Shegë e ambël, shegë Tivarit
Nuk të ndrroj për syt' e ballit.
Shegë e ambël, ku si sheqeri
Hajde rrijmë, ku rri skyfteri,
Rrin skyfteri m'ato rranxa,
Hajde rrijmë, ku rrin fëllanxa!

Ç'ke vash-o që lan e qan

— Ç'ke, vash-o, që lan e qan?
— Laj e qaj se më martun-e,
Më martune, më dhanë një plak-e,
Ç'i rash ngjat e gdhina larg-e,
Vinte era, moj, si sqap-e.

Ardhshë e të gjeta, lala, vetëm obobo!
Jo vetëm, po me nanën, obobo!
Tue shartue, moj, thanën-o

Ç'ke vash-o që lan e qesh-e?
Laj e qesh se më martun-e,
Më martune, më dhanë një djal-e;
Ç'i rash larg' e gdhina ngjat
Vinte era, moj, si zambak.

Ardhshë e të gjeta, lala, vetëm, obobo!
Jo vetëm, po me babën, obobo;
Tue shartue moj manin-o.

Nisja e dasmës

Këndo zogu i verës

Këndo zogu i verës,
Ndo këndo, ndo mos këndo,
Se ne dasmën e nismë,
Ndo këndo, ndo mos këndo.
Ftuam gjithë far' e fisnë,
Ndo këndo, ndo mos këndo.
Ftuam gjithë krushqit tanë,
Ndo këndo, ndo mos këndo...

Ububu, ndër ato male

Ububu, ndër ato male,
Ububu, qenke një valle.
Ububu, lojtke një djalë,
Një djalë pëllumb i bardhë.
Ububu, ç'paske dyfeknë,
Gjithë folla ngjeshur mesnë.
Dyfeknë gjithë sedefe,
Kur e shoh, më ngjethin ethe,
Sahatnë gjithë zinxhirë
Kur e shoh, më prish figirë.

Bërja e druve

Pa shi, shi seç sillet-o

Pa shih, shih seç sillet-o,
Er' e karafiles-o,
Drutë që po nxirren-o
Gjithë këto që bëhen-o
Për ty e për nusen-o.

Po na vjen një kalë me dru

Tarnana, e ububu,
Po na vjen një kalë me dru
Dil, moj nuse, me i shkarkue.
Jam tue nxhie, jam tue shkrue,
Jam tue hipë atit me shkue.

Kur zënë brumin

Sonte zëmë brumët

Sonte zëmë brumët,
Me mjalt' e me qumësht.
Të vijë nusja me uratë
E ka vjerrën gojëmjaltë.

Jançe, Jançe brumët

Jançe, Jançe brumët,
Me mjalt' e me qumësht,
Që nga goj' e dhëndrit-o
Në gojë të nuses-o.

Të kam një rixha

Hanko pasha qiqër,
Të kam një rixha,
Të më vish nesër,
Nesër me sabah,
Do të bëjmë bukë me qiqëra.
Do t'martojmë Dh. N. benë,
T'i japim nuse lulenë.

Moj nuse, luleja jonë,
Ne d'arrovë s'të kërkujmë,
Nga një rizë dorë më dorë.

Të rruajturit e dhëndrit

Me ngadalë briskun-o

O berber, të keqen-o,
Me ngadalë briskun-o,
Mos i preç mustaqen-o,
Se i shëmton faqen-o.

M'u plake, djal-o, m'u plake

M'u plake, djal-o, m'u plake,
Që kur hoqe brisk në faqe;
Kush më tha që më je plakur
Ti më qënke trëndafil i pahapur.

Zhvish rrobat e djalërisë

Zhvish rrobat e djalërisë,
trim more,
Vish ato të dhëndërisë,
trim more,
Djalë më s'të thonë kurrë,
trim more,
Se të gjejnë djemat mb' udhë,
trim more,

Edhe të zënë me gurë
trim more,
Me ta nuk Uafosesh kurrë,
trim more,
Të kesh mall për djalëri,
trim more,
Se djalë më s'bënesh ti,
trim more.

Nisja e krushqve për të marrë nusen

Hajde moj lule me ne

Hajde, moj lule, me ne,
Haj, të vemi në fshat tonë.
Fshati ynë është i nxehtë,
Arrihen rrushtë shpejt,
Arrihen rrushtë e bardhë,
Të lulëzonjësh si dardhë.

Gjithë krushqit janë

Gjithë krushqit janë,
Moj nuse, moj lule,
Të gjithë me fermele,
Moj nuse, moj lule,
Të gjithë kuajt me fre,
Moj nuse, moj lule,
Gjithë kuajt të parë,
Moj nuse, moj lule,
Gjithë kushërinj të parë,
Moj nuse, moj lule.

Pritja e krushqve në shtëpinë e nuses

Ç'u mbush mali plot me dushk

Ç'u mbush mali plot me dushk,
plot me dushk,

Thotë nëneja: «Vijnë krushq,
vijnë krushq.»

«Në janë krushq të dalin,
të dalin,

Syzezën ta marrin,
ta marrin!»

Po syzeza qan me lot,
qan me lot.

Ka babanë e s'e le dot,
s'e le dot.

*Le babanë mbi shilte,

mbi shilte,

Eja, syzezë, me ne,
me ne!»

Ç'u mbush mali plot me mollë,
plot me mollë,

Thotë nëneja: «Vijnë dasmorë,
vijnë dasmorë!»

«Në janë dasmorë, të dalin,
të dalin,

Syzezën ta marrin,
ta marrin.»

Po syzeza qan me lot,
qan me lot,

Ka nënën e s'e le dot,
s'e le dot.

Le nënenë mbi shilte,
mbi shilte,

Eja, syzezë, me ne,
me ne.»

Ç'u mbush mali plot me dardhë,
plot me dardhë.

Thotë nëneja: «Vijnë, beqarë,
vijnë beqarë!»

«Në janë beqarë të dalin,
të dalin,

Syzezën ta marrin,
ta marrin».

Po syzeza qan me lot,
qan me lot.

Ka vëllezërit e s'i lë dot,
s'i lë dot,

«Le vëllezërit mbi shilte,
mbi shilte,

Eja, syzezë, me ne,
me ne!»

Bëj konak, moj gjeraqinë

Bëj konak, moj gjeraqinë,
Bëj konak,

Bëj konak, se po të vijnë,
Bëj konak,

Ne nuk jemi shumë vetë,
Bëj konak,

Po njëqind e pesëdhjetë
Bëj konak,

Nuk hamë bukë shumë,
Bëj konak,

Po njëqind e dyzet furrë,
Bëj konak,

Shtrona verën dhe rakinë
Bëj konak,

Shtrona odën me qilimë
Bëj konak!

Përcjellja e nuses

Gjithë rrotull jemi

Gjithë rrotull jemi,
Moj unazë,
Gjithë far' e fis të kemi,
Moj unazë,
Gjithë fisi t'u gëzua,
Moj unazë,
Veç babai t'u zemërua,
Moj unazë.
«Përse s'ndenje, bijë me mua?»
Moj unazë,
Se shtëpia m'u shëntua,
Moj unazë,
Dhe mëma t'u hidhërua
Moj unazë,
Thotë: «Pse s'ndenje me mua
Moj unazë?»

Vjen bajamja lumit-o

Vjen bajamja lumit-o, lumit-o!
«Kush të paska nisur-o, nisur-o?»
«Babai me të lutur-o, lutur-o,
Me zemër këputur-o, këputur-o»
Vjen bajamja lumit-o, lumit-o!
«Kush të paska nisur-o, nisur-o?»
«Nëna me të lutur-o, lutur-o,
Me zemër këputur-o, këputur-o».

Moll e kuqe, sheg' e ëmbël

«Moll' e kuqe, sheg' e ëmbël,
Del se po të thrresin».

«Nuk kam vënë ato ergjende,
Thojini të më presin;
S'kam veshur fustan' e bardhë,
Thojini të më presin!»

Atje poshtë në mëhallë

Atje poshtë në mëhallë,
Martohet një vashë e bardhë,
Shkojin krushqit me e marrë:
«Nisu, nuse, dalëkadalë!»
«E nisun jam, të dalë s'po kam,
Harrova mëhyrin-o,
Shih në gishtin e tem vëllai».
«Nisu, nuse, motra jonë,
Se myhyrin na ta çojmë».
«E nisun jam, të dalë s'po kam
Harrova gjerdanin-o,
Shih në qafë të motrës time».
«Nisu, nuse, motra jonë,
Se gjerdanin na ta çojmë»
«Nisu, nuse, dalëkadalë;»
«E nisun jam, të dalë s'po kam:
Po la male e, le shtëpia,
Po la nanë e po la babë,
Po la motër e vëlla,
Po la gjak e ilaka,
Po la shpi, po la kojshi,
Po la gjak, po la gjini,
Po la fushë e po la mal».
«Nisu, nuse, motra jonë,
Për në kjoshe e vetë e mirë
Gjen nanë e gjen babë,
Gjen motër e vëlla,
Gjen gjak e ilaka,
Gjen shpi e gjen kojshi,
Gjen gjak e gjen gjini,
Gjen fushë e gjen mal».

Vuna kambën n'uzegi

Vuna kambën n'uzegi,
Lamtëmir, oj fëmi.
Vuna kambën në shkallë,
Lamtëmir, or xhaxhallarë;
Se vi herët, se vi vonë,
Jam e dame përgjithmonë.

Kadal, nuse, mo ngut atin

«Kadal, nuse, mo ngut atin,
Se po shkel kambt' e kunatit!»
«Do ta shkeli, ta bëj drrasë,
Se mu zemrën ma ka plasë;
Ma ka plasë e ma ka ça,
M'u prej nane më ka da.»

Arritja e nuses në shtëpinë e dhëndrit

Bam bëri dyfeku

Bam bëri dyfeku,
Prapa atij bregu;
Dil, nënë, te porta,
Dil të bëç sehir,
Se ç'të bije djali
Dh. N. kanakari,
Thëllëzën e malit,
zogën e beharit.

Nuseja në rrugë

Nuseja në rrugë,
Karajfil në tubë.



Veshje nuseje e dhëndëri (Myzeqe)

Veshje nuseje (Berat)



Moment dasme kolonjare



Nuseja në derë,
Karajfil me erë,
Nuseja n'oborr,
Karajfil shatorr.
Nuseja në shkallë,
Karajfil në ballë,
Nuseja n'çardak,
Qafën si zambak,
Hyni nusja n'odë,
Mos na i lësho lotë!

Ç'e po shndrite rruga mbarë

Ç'e po shndrite rruga mbarë!
Po vjen dhandri me kumbarë.
Hajde, nuse, ardhsh e bardhë!
Ardhsh me baft e me nafakë,
E na paç jetën e gjatë.

Kur u hodh nusja rreth avllisë

Kur u hodh nusja rreth avllisë,
tjetër nur i ra shtëpisë,
Kur u hodh nusja rreth sinurit
Tjetër nur i ra katundit.
Kur u hodh nusja rreth sokakut,
Tjetër nur i ra oxhakut.
Nana e nuses qan te guri
Lulja asht tuj mrrij te burri.

Më rrëmbeu beqar i malit

Më rrëmbeu beqar i malit,
moj nëne, më rrëmbeu,
E më hodhi në vithe të kalit,
moj nëne, më rrëmbeu,

Më mori florin' e ballit,
moj nëne, më rrëmbeu,
«Lerma se e kam të djalit!»
Moj nëne, më rrëmbeu.
Më rrëmbeu beqar' i fushës,
moj nëne, më rrëmbeu,
E më hodhi në vithe të mushkës,
moj nëne, më rrëmbeu,
Më mori florin' e gushës,
moj nëne, më rrëmbeu,
«Lerma se e kam të çupës!»
Moj nëne, më rrëmbeu.

Lyej derënë me mjaltë

Lyej derënë me mjaltë,
Ta ëmbëlsosh brenda e jashtë,
Nuse moj, u trashëgojsh,
Djem dhe çupa na mblojsh.

Nuse ku kalle këmbët,
Të rënçinë dhëmbët,
Dhëmbët e dhëmballët,
Eshtrat e kokallat.

Atje përposh te dërrasa

«Atje përposh te dërrasa,
O djalosh, o bukurosh,
Hiqma dëvakun se plasa,
O djalosh, o bukurosh!»
«Hiq vetë, o turfanda,
Moj nuse, moj lule
Ndaj të mora me sevda,
Moj nuse, moj lule!»

Nusja jonë arbërore

Nusja jonë arbërore,
Arbërore,
E bardhë si qumështore,
Arbërore,
Mes' i saj posi kalore,
Arbërore,
Gush' e saj posi top bore,
Arbërore,
Faqetë si koqe molle,
Arbërore,
Lum kush ta marrë gjitone,
Arbërore,
Lum kush e merr në shtëpi,
Arbërore,
Do të shkoj' jetë e zoi,
Arbërore.

Derdhur leshrat prapa

Derdhur leshrat prapa,
Moj vetullkurore,
Ç'faj të pati djali,
Që s'i flet me gojë?
Hiq duvakn' e bardhë
vere në peronë,
Ç'faj të pati djali,
Që s'i flet me gojë?
Dorënë bylyr
Dhe gishtin të hollë,
Ç'faj të pati djali,
Që s'i flet me gojë?
Të ngrita duvaknë,
Të pashë stolinë,
Më dogje në zemër
Erë trëndelinë.

Thëllëzë e malit Filate

Thëllëz' e malit Filate,
Del, moj, në divan se plase,
Helbete se po ksehase,
Syt' e tu posi dy zarfe,
Porsi dy zarfe t'ergjëndë
Nusja jonë zog me pëndë,
Lot e qesh në shtëpi tënë,
Veshur me takëm të rëndë.

KËNGË DASME TË REJA

Moj e Mira Sylajthi

Moj e mira sylajthi,
bardhë e kuq porsì qershi,
kurmin bardhë si bora e bjeshkës,
buzën kuq si flaka e eshkës.
Djemtë e fshatit na i ke tutë,
sepse shkurt na i ke pre drutë.
Unë po due me të pa një herë,
veç në vdeksha, moj e mjerë,
po s'të bana me xan mend,
n'brigadën time do t'bjaj vend,
të dy bashkë, o të punojmë,
zemrat tona t'i afrojmë.
Të punojmë kudo me sulm,
t'jemi të parët në katund.

Korre grurin korre

Korre grurin korre
më të lumtë dora,
vajz' e fshatit tonë
seç ja bëre fora.
Luajnë duart me grurin,
sa bukur punon!
Sokolesh e malit,
vajzë e fshatit tonë.

Me shoqet e tua
je vënë në garë,
Ja, në krahun tënd
punon dhe një djalë.
Më të lumtë dora
sa bukur punove,
shoqeve dhe djalit
garën ua fitove.
Djali të shikon
dhe buzëqesh ngadalë,
garën ja fitove
zemrën ta ka marrë.

Hapi fletët mor zambak

Ditë për ditë, kur shkoj në punë,
tuj mbjellë misër e tuj korrë grunë,
kur për shkollë mbramjes kaloj,
një zambak përherë takoj.
Pranë zambakut për nën dardhë,
shkon e vjen syzeza e bardhë.
Hapi fletët, mor zambak,
mbushja rrugën, ndale pak,
sa t'i them nj'a dy-tri fjalë
për dashninë zambak të bardhë!
— Mbylli fletët, mor zambak,
mos ma zen rrugën aspak,
shkundi lulet ti, moj dardhë,
mos ma len djalin me ardhë!
— Të kam njoftë, mo cucë, n'aksion,
kanga n'buzë ty të lulzon,
kur punojmë ne bashkë në fushë,
bahesh flutur e s'të zen kush,
kur e ven yllin mbi ballë,
s'ta kalon as cucë as djalë!
Te kjo dardhë, te ky zambak,
dikur pushka rridhte gjak,
sot lulzon zemra e malsorit,

se i asht këputë gishti gjeksorit.
Hapi fletët mor zambak,
mbushja rrugën, ndale pak,
buzë e dorë lagur me vesë
t'i jap cucës fjalë e besë!

Çoban seç më mori malli

Çoban seç më mori malli,
që të vi të rri te stani,
që të më kënaqet xhani,
bjeri culës, mor ta marça
se do gdhihemi përjashta.
Të dy ç'na gëzoi zemra,
ç'na ndriçoi kasollen brenda,
merrja se na shkoka kënga.

Trëndelinë, moj

Trëndelinë, moj,
ç'të kam thënë, moj?
Bëj përpjetë malit
se të kërkon djali,
se të kërkon djali,
e ka marrë malli.

Trëndelinë, moj,
ç'të kam thënë, moj?
Hajde në brezarët,
ku janë vullnetarët,
ku punon rinia
e vlon lumturia!

Në kooperativë po kërcet çanga

Në kooperativë po kërcet çanga:
— Çohu Bardhok, he, të pastë nana!
Çohet çika si sorkadhe,

e merr rrugën ndër livadhe.
Ndal Valbona e po shikon,
nis Shkëlzeni e po pleqnon,
nis çobani n'at' shpat këndon:
— Mori e mira, bystekt' e zes,
mirë po duken pa mafes,
llana bardhë si bora n'bjeshkë,
faqja e kuqe, sikur pjeshkë;
hie të ka çikë, vesha e re,
fistan lulesh, bukur pre,
bash si flutur m'dukesh n'arë,
kah prashitë në rreshta t'parë,
nuk ka djalë para me t'dalë,
nuk ka djalë me të kalue,
tash ma fort un' ty po t'due.

Moj e bardhë e bukur-o!

— O, moj vashë që m'sheh ndër sy,
nuk kam çarje pa t'marrë ty!

Moj e bardhë e bukur-o

nuk të laj pa t'marrun-o!

— Bahem shegë e rri në degë;

për të gjallë s'ke me m'gjetë

o bilbil i malit-o!

zemërbardhë e i bukur-o!

— N'u bafsh shegë me ndej në degë,

unë e kam një vrap të letë

e t'kërkoj unë me gjithë shokë

e s'të laj pa të zbritë në tokë,

moj e bardhë e bukur-o

nuk kam çarje pa t'marrun-o!

— Bahem fllanxë e dal në mal,

s'ke me më zanë për të gjallë,

o bilbil i malit-o,

zemërbardhë e i bukur-o!

— N'u bafsh fllanxë me dalë në mal,

vetë gjahtar i mirë un' jam

e të kërkoj un' mal më mal,
e s'të la pa të nxjerrë në fushë,
tak-tak-tuk të gjuej me pushkë,
moj e bardhë e bukur-o,
nuk të laj pa të marrun-o!
— Asnjë vend ti nuk ma le,
o bilbili i malit-o,
mal më mal ti nuk mu ndave,
hajt ta lidhim besën-o!

Si sorkadhe shkon në bjeshkë

Në brigadë, kur del te ara,
moj e mira e malit,
ndër gjithë shoqet je e para,
zemrën ç'ja ndeze djalit,
Belhollë e lule-pranverë,
cucë moj brigadiere.
Si sorkadhe shkon në bjeshkë,
ku derdh gurra ujë kristali,
djalit zemrën ia çon peshë,
moj thëllanzë e bukur mali.
Lule malësore je,
syzezë, moj, lule beharit,
shoqen kund, moj, nuk e ke,
moj bujkeshë e malit.
Syni yt bukur shënon,
në shenjë përmbi dhjetë,
moj ushtarë syshqiponjë,
trimëreshë me fletë.
Lule malësore je,
fishekët mes gjerdanit,
synin pishë, turrin rrufe,
moj bujkeshë e malit.

Në brigadën tonë

Në brigadën tonë n'arë, more djalë,
Çupa jonë mbjell panxhar, more djalë.
Mbjell panxhar e vjel panxhar, more djalë,
do ta hajë sheqer të bardhë, more djalë,
do ta hajë me beqarë, more djalë,
me atë që ka fejuar, more djalë.
Në kooperativën tonë, moj belhollë,
djali ynë po mbjell mollë, moj belhollë,
po mbjell mollë e po vjel mollë, moj belhollë,
do ta haj' me ty moj zogë, moj belhollë.

Nëno dëgjohet një këngë

Nëno, dëgjohet një këngë,
pa dil moj, dëgjo moj;
gjitoni nuse ka zënë
zuri një vajzë thëllëzë,
porsi hëna që jep dritë,
të dy punojnë në fabrikë.
Lum të rejat dhe të rinjtë,
që arritën këtë ditë,
e njohin mirë sho-shojnë,
familje të re krijojnë.

O moj vogëlushe e fshatit

- O moj vogëlushe e fshatit,
pse s'më flet?
- Baba do të më fejojë
në qytet.
- Si kërkon, moj, të lesh fshatin
plot stoli?
- Sdua unë, po duan prindërit,
djalë i ri.

— Fshati ynë edhe natën
llamburit,

plot me radio, buçet kënga,
kudo ndrit.

— Djalë i dashur, unë s'iki,
jo, këtej,

vetëm këtu lumturinë
do ta gjej,

— Ne këtu, moj vajzë e dashur,
po gëzojmë,

jet' të lumtur, të begatë,
po ndërtojmë.

— Djalë i ri, po ta jap fjalën
me guxim,

se zakonet do t'i thyej
si një trim.

Një qershi, qershi me gjethe

— Një qershi, qershi me gjethe,
sa bukur ka çelë,

porsi hana në pranverë,
ti moj goce del.

— Jam si drita e si hana,
unë, mor, djalë i ri,

por kam frikë se m'shikon nana,
me ty s'mund të rri.

— Burrin plak që ty ta dhanë
mblesët n'fëmini,

nuk e lamë me t'marrë,
ai s'asht për ty.

— Jemi njohur në brigadë,
zemrën ma ke marrë,

bashkë në shkollë e në aksione,
bashkë punojmë në arë.

Lidhe dashurinë, jetën e vërtetë

Moj thëllëzë e malit, vetullakurorë,
e njohe bandillin atje në të korrë,
e njohe çapkënin në t'dal' të beharit
kur punonit bashkë, moj thëllëzë e malit,
E njohe në punë, e njohe në jetë,
lidhe dashurinë, jetën e vërtetë.
Ç'të duhej krushqia edhe mblesëritë,
dashuri e pastër lind sot në të rinjtë,
dashuri e pastër e lidhur në punë,
që godet zakonet, bën copë kanunë.

Mu në breg të zallit

Mu në breg të zallit,
i ra malli djalit
për cucën belhollë
me faqet si mollë.
Bashkë e lidhën besën,
shpejt ta bëjnë fejesën;
u martuan pas aksionit,
shqelm i dhanë zakonit.
U çudit katundi,
bërtiti kanuni
rinia në dasmë,
vallen shumë e tundi.

Në punë u njohëm

Jeta jonë e lumtur qesh e lulëzon,
çifti ynë i ri, lidhur në aksion,
hiqe vallen bukur, vallen më te re,
dasma jonë e madhe është dasmë e re,
pajë dhe peshqeshe, trapezë e dolli,
është jeta jonë, vetë çifti i ri.

Mirë se erdhet, o ju krushka

- Jemi nisur, po të vijmë,
shtroje dhomën me qilim!
— Mirë se erdhët, o ju krushka!
— Mirë se u gjetëm, moj krushka!
— Është e rëndë kjo çupa jonë,
valle e duvak s'pranon.
— Mos e mbaj kokën këputur,
o moj nuse e bukur.
— Udhë të mbarë o ju krushka,
të na trashëgohet çupa!
— Me lumturi e gëzime,
të na rrojë Partia trime!

Ini-ini, mirë se vini

Ini-ini, mirsevini!
Moj rini e fshatit tonë,
po martojmë ma t'mirën-o,
po i japim djalë punëtor,
njani-tjetrin zgjodhën vetë,
s'bashku t'gëzojnë për jetë.
Rrofsh sa malet, moj Parti,
që na solle lumturi!

Çel i bardhë sot ky mëngjes

Çel i bardhë sot ky mëngjes,
alpet po dëgjojnë,
gëzim e dritë ka gjithë kantieri,
shokun tonë martojmë.
O ç'hare e lumturi,
kapur dorë për dorë,
hej, për çiftin ngrenë dolli
krushqit minatorë.
Ç'po gjëmon daullja

plot gaz e hare,
shokun më punëtor
sot martojmë ne.
Dasëm sonte kemi ne,
dritë e kangë kudo
për familjen më te re,
zemër ti këndo.

Sitet mielli në magje të re

Sitet mielli n'magje t're,
— Zoti i shpisë për hajr kjo e re!
— Për hajr paçi, o shok't e mi,
djali m'pru nusen në shpi.
Djali nusen e ka zgjedhë vetë,
çikë punëtore për lezet.
Sitet mielli n'magje t'kuqe,
— Për hajr t'kjoftë, dhandër, kjo nuse!
Zoja e shpis' pse ke lidh kryet,
Apo t'dhimet mielli i gryjt?
— Nuk po m'dhimet, por më gëzon,
se vjen nusja e m'ndihmon.
Sitet mielli për merak.
— Na qit pitet me kajmak!
— Po jua qes e nuk kam dert,
se kam nuse për lezet.

Nusja jonë lëshraverdha

Kush na vjen si vjen pranvera?
Nusja jonë lëshraverdha!
E ka zgjedhur vetë djali,
Syri që s'luan nishanin.

Hidhe nuse vallen e së resë,
Merre dhëndër lulen e bahçesë,
Ngrijeni, more shokë dollinë.
Çifti shtoftë Shqipërinë.

Gjithë dasmorët ven e vinë,
Plot gëzim mbushin shtëpinë,
Nusja pranverë Shqipërie,
Dhëndri lule djalërie.

Hidhe nuse vallen e së resë,
Merre dhëndër lulen e bahçesë,
Ngrijeni, more shokë dollinë
Çifti i shtoftë Shqipërinë.

Dollia e parë, dolli e nderit,
e Partisë, shëndeti i Enverit.
Kjo familja jonë e re,
Bëftë trima për atdhe.

Hidhe nuse vallen e së resë,
Merre dhëndër lulen e bahçesë,
Ngrihjeni, more shokë dollinë,
Çifti shtoftë Shqipërinë.

Dasmë e re në vatrat tona

Fytyra jote moj belhollë,
si rreze mëngjesi,
dasma e re në vatrat tona
zemrat shumë na i ndezi.
Nusja e re, moj sa krenare,
flutur përmbi fletë,
përkrah djalit që e do
kërceu lehtë lehtë.
N'gjokset tona buçet kënga,
më shumë se përherë
dhe nga zemra del urimi:
— Rroftë shoku Enver!

Ç'ra kjo ditë e bardhë

Ç'ra kjo ditë e bardhë
si mijëra të tjera,
dielli pa dalë,
ti dole te dera.
U mblodh gjithë fshati,
kush për ty s'këndon
me këng' të stolisim,
brigadierja jonë.
Ç'nur sot të ka rënë,
nuri i fushave,
Ndaj ka hije dasma,
ndaj gëzojmë ne.
Le të dridhet vallja,
dridhe, moj, shaminë,
se në vend të shkesit
vumë dashurinë,
se në këngët tona
rrjedh gëzimi ynë,
s'kanë mort gëzimet,
se kemi Partinë.

Ra dielli në livadhe

Ra dielli në livadhe,
në oda po hedhin valle,
një luan e një sorkadhe;
hidhet vallja radhë-radhë,
dridh, nuse, shaminë e bardhë.
Ju urojmë, o çift i ri,
plot gëzim e lumturi.
Vlon kënga edhe hareja
dasmë e re, shtëpi të reja,
në punë gjithmonë sulmuese
si ti dhëndër, dhe ti, nuse.

Shih si dridhet valleja

*Me se luhet valleja,
Fët me sup, e fët me krah,
me fustan të bukur-o,
fët me sy me vetull-o,
Shih si dridhet valleja,
shpejt e lehtë si flutur-o
për jetën e lumtur-o.
Derdhet kënga sallës-o,
për grurin e arës-o,
mbushen plot hambarët-o.
Vallja luhet fushës-o
për Partinë e Punës-o
trime mes furtunës-o.*

Lumja ti moj nusja jonë

<i>Lumja ti moj nusja jonë,</i>	<i>lumja ti,</i>
<i>t'u mbush dasma gjith' drit' ti!</i>	» »
<i>Drit' mbi supe çiftit t'ri,</i>	» »
<i>dritë e gaz në çdo shtëpi.</i>	» »
<i>Erdhi drita e Partisë,</i>	» »
<i>dasm' e gjithë Shqipërisë.</i>	
<i>Dasma jonë, dasm' e re,</i>	» »
<i>gjithë këngë dhe hare,</i>	» »
<i>Hajde, nuse, në valle!</i>	» »